



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Administrimit publik dhe Shkencave politike

Studime Postdiplomike-Studime për diplomaci

Punimë magjistrature në temë

Roli i partive politike në informimin dhe edukimin e votuesve në Republikën e Maqedonisë

Mentor :

Prof. Dr.Etem Aziri

Kandidatja:

Selvete Shabani

Tetovë 2017

Deklarata e ndreshemërise

Unë Selvete Shabani, studente ne studimet postdiplomike në Fakultetin e Administrates publike dhe Shkencave politike pranë Universitetit te Evropes Juglindore ne Tetovë, nën përgjegjësi te plote morale dhe ligjore deklaroj qe ky punim magistrature është rezultat i punës time hulumtuese dhe asnjë pjesë e tij nuk është marr nga autor tjerë, ne përjashtim te pjesëve qe janë te regjistruara me referencat përkatëse.

Selvete Shabani

Mentor

Prof.dr.Etem Aziri

Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë

Komisioni

Prof.dr Etem Aziri

Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë

Doc.dr.Agron Rustemi

Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë

Doc.dr.Memet Memeti

Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë

Abstrakt

Partitë politike si grupe shoqërore të organizuara janë të pranishme në të gjitha shoqëritë bashkëkohore, pa dyshim se marëdhëniet e tyre politike me shoqërinë(votuesit)arrinë ti realizojnë, duke i tarajnuar me leksione informative dhe edukative e sidomos gjatë proceseve zgjedhore.

Informimi zgjedhor i referohet përgjithsisht informacionit mbi datën, orën dhe vendin e zgjedhjeve, si dhe mbi procedurat e votimit. Edukimi zgjedhor i shpalos votuesve perspektivën dhe kontekstin e mbajtjes së zgjedhjeve, si pjesë e procesit të përgjithëshëm demokratik, të drejtat dhe detyrimet e votuesve.

Hulumtimi i opinionit publik është karkteristikë e përbashkët për pjesën dërmuese të zgjedhjeve në lidhje me informimin dhe edukimin zgjedhor. Prandaj synimi parësorë i disertacionit të magjistraturës është të ofrohet një analizë e mirëfilltë e rolit të partive politike në informimin dhe edukimin e votuesve shikuar nga këndvështrimi i qytetarëve, se sa partitë politike në Republikën e Maqedonisë kryej funksion informativ dhe edukativ me qytetarët-votuesit gjatë proceseve zgjedhore. Roli emancipues i partive politike, drejtë zhvillimit dhe kultivimit të vlerave demokratike, intresimi (mosinteresimi) i partive politike që ta informon, edukon qytetarin, votuesin gjatë proceseve zgjedhore, e deri te roli edukativ i tyre në krijimin e iluzionit tek votuesit se dhe ato janë pjesë e proceseve politike nga i cili nvaret niveli i demokratizimit të shoqërisë, mobilizimi të shoqërisë si dhe konsolidimit të kulturës politike tek votuesit dhe antarsia e gjërë si vlerë demokratike.

Fjalë kyç: Roli i partive politike në informimin dhe edukimin e votuesve në Republikën e Maqedonisë

Abstract

The political parties as organized social are present in every aspect of the modern society. Without a doubt, their political relations with the society (the voters) are achieved through informative and educative discussion especially during the election. The voter informing guide refers to the overall information about date, time and place of the election, as well as the voting procedure. The voter education and awareness program displays the perspective and the context of holding the election, as a part of the democratic process, the rights and obligations of the voters.

The survey of public opinion is a common characteristic for every election regarding the voter education and awareness of the election. Thus, this master thesis's goal is to present an authentic analysis about the role of the political parties in informing and educating the voters from the voter's point of view to see from the voter's perspective whether the political parties in the Republic of Macedonia perform the process of informing and educating the citizens-voters throughout the election process. The role of political parties towards the development and cultivation of democratic values, the commitment (the neglect) of the political parties to inform, educate the citizen the voter during the election, up to their educative role in creating an illusion that voters are a part of the election process from which lies the level of democracy in the society, the mobilization, of the society as well as the consolidation of the political culture in the voters and the wide membership as a democratic value.

Key word: The role of the political parties in informing and educating the voters in the Republic of Macedonia.

Përmbajtje e shkurtë

Kapitulli i I: Ne përgjithësi mbi partitë politike

Kapitulli II: Roli emancipues i partive politike në R. Maqedonise

Kapitulli III: Shpalosje e rezultatëve të një hulumtimi kuantitativ me qytetarët e komunes së Kumanovës

Përmbajtja

Abstrakt

1.Lënda e hulumtimit	8
2.Qëllimet e hulumtimit.....	9
3.Hipotezat.....	9
4.Metodologjia e hulumtimit.....	10
5.Rëndësia e punimit.....	10

Kapitulli I:Në përgjithësi mbi partitë politike

1.Paraqitja e partive politike.....	11
2.Roli shoqëror i partive politike ne fazën e hershme te zhvillimit te shoqërive kapitaliste	15
3.Roli shoqërore i partive politike dhe zhvillimi i demokratik ne shoqëritë bashkëkohore	17

Kapitulli II:Roli emancipues i partive politike në R.Maqedoni

1.Paraqitja e partive politike në R e .Maqedonisë.....	22
2.Roli shoqëror i partive politike në R e .Maqedonisë shikuar nga këndvështrimi i tyre	31
3.Interesimi (mosinteresimi)i elitave partiake për informimin sa më të drejtë të qytetareve dhe antarsisë së gjere mbi proceset e politikëbërjes.....	38
4.Angazhimi i partive politike ne R.M per ndërtimin e kulturave politike tek qytetarët dhe antarsia e gjere partiake.....	46

Kapitulli III:Shpalosja e rezultateve te nje hulumtimi kuantitativ me qytëtarët e komunes se Lipkovës

PERFUNDIME DHE REKOMANDIME	74
Bibliografia.....	75

1. Lënda e hulumtimit

Ka disa lloje ose klasifikime të edukimit të votuesve: mbi procedurat e votimit dhe informacionit të rëndësishëm mbi të drejtën e votimit; mbi zgjedhjet e mundshme të kandidatëve dhe platformave të tyre, në dispozicion të qytetarëve; mbi rritjen e edukimit dhe motivimit të elektoratit; dhe çështje të tjera. Në këtë punim dotë vihet theksi në tematikat që kanë qenë tradicionalisht subjekt i programeve të edukimit të votuesve në Maqedoni. Shumë nga këto tematika duhet parë si pjesë të planeve për edukimin e votuesve për zgjedhje.

Nga gjetjet, pritet të rezultojë një nivel i qëndrueshëm i të kuptuarit dhe ndërgjegjësimit bazë të votuesve në Maqedoni. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në grupet e fokusuara duhet të jenë të informuar mbi llojin, qëllimin dhe datën e zgjedhjeve që do të zhvillohen. Pjesëmarrësit, në mënyrë të njëtrajtshme, duhet të dinë se duhet të votojnë.

Lidhur me zgjedhjet/alternativat politike në dispozicion të elektoratit, situata shpesh bëhet e paqartë, sidoemos në shtetet me demokraci të brishtë ku bën pjesë edhe Republika e Maqedonisë.. Pjesëmarrësit, në grupet e fokusuara duhet të shihet se a kanë pak ose aspak informacion mbi kandidatët/et përkatës/e që garojnë në zgjedhje. Qytetarët do të donin të njihnin kandidatët/et përpara ditës së zgjedhjeve, në mënyrë që të bëjnë vlerësimin e tyre bazuar në eksperiencën, kontributin në shoqëri dhe komunitet, dhe në programet e propozuara. Listat e votuesve, saktësia e listave të votuesve ka qenë historikisht problem në vendet në tranzicion dhe iniciativa të konsiderueshme janë ndërmarrë për të përmirësuar si listat e votuesve ashtu edhe ndërgjegjësimin për të drejtën dhe përgjegjësinë qytetare për të verifikuar saktësinë e informacionit të së drejtës për të votuar në periudhën përpara zgjedhjeve. Shkurt thënë është fjala për një hulumtim i cili duhet ti ndryçon tendencat demokratike dhe tendencat oligarkiko-lidereske në veprimin e partive politike në RM. Gjetja e “rugës së mesme” nënkupton zhvillim të qëndrueshëm demokratik për çdo shoqëri konkrete, në çrast Maqedonia nuk paraqet kurfar përjashtimi.

2. Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi kryesor i këtij punimi është ta ndihmoj zhvillimin pluralist dhe demokratik të Republikës së Maqedonisë duke ofruar modele të veçanta pjesëmarrëse për partitë politike që kërkojnë të përqafojnë praktika më përfshirëse. Kjo do të ishte pamundur pa një informim më të madh dhe gjithëpërfshirës të votuesve. Për tu aritur e gjithë kjo, do të bëhet një analizë e shkurtër e veprimit të partive politike në Maqedoni deri më sot, duke u veçuar praktikatat e mira nga ata të dëmshmet. Në këtë punim termit si: politikëbërja pjesëmarrëse, konsultative dhe përfshirëse përdoren si të ndërthurura, si mjet për të përshkruar proceset e politikëbërjes të cilat diskutohen, apo shprehin opinionet e anëtarëve, mbështetësve të partive politike, organizatave të shoqërisë civile etj.

3. Hipotezat

Punimi do të bazohet në një hipotezë kryesore dhe dy hipoteza ndihmëse. Hipoteza kryesore:

1. Partitë politike në Republikën e Maqedonisë gjatë kësaj faze të zhvillimit pluralist nuk kanë mbajtur një llogari të duhur për emancipimin e përgjithshëm të trupit votues.

Hipotezat ndihmëse:

1. Mosedukimi dhe mosinformimi i elektoratit dhe antarsisë së gjërë është bërë me paramendim nga elitat udhëheqëse.

2. Mosedukimi dhe mosinformimi i elektoratit nga ana e partive politike në RM, ka ndikuar dukshëm në mosndërtimin e kapaciteteve demokratike dhe stagnimin e demokracisë në përgjithësi.

4. Metodat dhe teknikat e hulumtimit

Gjatë shkruarjes së kësaj teze magjistrature do ti përdorim metodat dhe teknikat standard me qëllim të vertetimit sa më bindës të hipotezës kryesore dhe hipotezave ndihmëse. Në këtë kuptim jemi percaktuar për metodet në vijim:

1. Analiza dhe sinteza,
2. Metoda historike,
3. Metoda statistikore dhe
4. Anketimi.

5. Rëndësia e punimit

Partitë politike sot paraqesin një të “keqe të madhe” të demokracisë. Pa ata demokracia gatise është e pamundëshme. Në demokracitë e avansuara roli emancipues i partive politike është i pakontestueshëm.

Duke u nisur nga ajo që u tha sa më lartë, mendojmë se ky punim do të paraqet një kontribut modest për zhvillimin e demokracisë pluraliste në Republikën e Maqedonisë. Punimi do të ketë në të njëjtën kohë rëndësi teoriko-shkencore dhe praktike. Rëndësia praktike e punimit konsiston me faktin se punimi si i atillë do tju shërben elitave politikbërëse si një doracak që do të ndihmonte mjaft në ndërtimin sa më të qëndrueshëm të politikave partiake në vend.

1. Paraqitja e partive politike

Partitë politike si grupe shoqërore të organizuara, janë të pranishme në të gjitha shoqëritë bashkëkohore, ato veprojnë pothuajse në të gjitha shtetet, pa marrë parasysh rregullimin e brendshëm shoqëror politik të tyre. Sot partië politike paraqesin një fenomen politike universal. Partitë politike janë objekt interesimit i shumë disiplinave shkencore e në radhë të parë politologjisë dhe sociologjisë politike. Shkenctarët që merren me studimin e partive politike para se gjithash e hulumtojnë strukturën, formën e organizimit dhe veprimet të partive politike, raportet e partive politike me grupet tjera shoqërore, e kështu me radhë. Padyshim, interes të veçantë tek studiuesit ka zgjuara edhe çështja e origjinës së partive politike, si dhe periudha kohore kur u paraqitën për herë të parë partitë, partitë politike në formën e tyre embrionale, ose grupet politike, prej të cilave do të paraqiten në një fazë të mëvonshme partitë politike në formën e sotme. Pikëpamjet dhe qëndrimet e shkencëtarve në lidhje me paraqitjen e partive politike janë të ndara. Pjesa më e madhe e tyre lindjen e partive politike e ndërlidhin me demokracinë qytetare të shekullit XIX, periudhë në të cilën u krijuan parakushtet e nevojshme që i mundësoi zhvillimi e demokracisë parlamentare dhe përhapja e të drejtës së përgjithshme të votës, si një e arritur epokale dhe historike në rrafshin e të drejtave individuale dhe kolektive të qytetarëve.¹ Megjithatë ka edhe të tillë që lindjen e partive politike e kërkojnë shumë më herët, se partitë politike së paku në formën embrionale janë paraqitur me ndarjen e shoqërisë në klasa. Edhe pse partitë politike janë grupe shoqërore dinamike që lindën dhe u zhvilluan në kushte dhe rrethana të caktuara shoqërore ekonomike dhe historike të shoqërisë njerëzore, janë të paqëndrueshëm medimet e individëve që flasin për një lloj kontinuiteti apo lidhshmërie të drejtpërdrejtë ndërmjet organizatave politike në të kaluarën e largët dhe partive politike bashkëkohore. Organizatat politike që kanë ekzistuar para lindjes së partive politike bashkëkohore, nuk mund llogariten si paraardhëse të partive politike nga të cilat në shekullin XIX lindën partitë politike moderne. Kjo assesi nuk do të thotë se organizatat politike që kanë ekzistuar në fazat e hershme të zhvillimit të shoqërisë, në vete nuk kanë pasur elemente të caktuara që i karakterizojnë partitë politike sot. Në grupin e autorëve që pohojnë se origjina e partive politike është e lidhur me lindjen e klasave dhe shoqërinë klasore, janë edhe sociologu i njohur Ante Fiamengo dhe profesor Ali Dida. Origjina e partive politike është e lidhur me origjinën e shoqërsë klasore. Partitë politike prejardhjen e tyre e kanë qysh² në kohët më lashta të antikës së vjetër. Ante Fiamengo gjithashtu thotë se: partitë politike për herë të parë në histori shfaqen në sistemin

¹ Etem Aziri Sociologjia e partive politike Tetovë 2004;12

² Ali Dida Fillet e sociologjisë Tetovë 1997;332

skllavopronar³.I ndikuara nga disa autor perendimorë,ai përmend luftarat e klasave në Greqinë antike, të udhëhequra nga shoqëritë e fshehta –heteret, në të vërtetë partitë politike siç ishin: Lidhja Pitagores në Greqinë e Madhe d.m.th.në Italinë Jugore dhe partia Maqedone kundruall Partisë në Athinën në kohën e depërtimit të Filipit dhe Lekës së Madh në truallin grek, megjithatë Fiamengo konstaton se këto organizata politike kanë dallime thelbësore nga partitë moderne politike, si për nga struktura organizative ashtu edhe për nga qëllimet dhe programe, këta autor konstatojnë se organizatat politike dallonin qartazi nga partitë politike bashkëkohore.Jean Blondel mendon se partitë politike janë shfaqur për herë të parë në Romë, ndërsa vëllezrit Grah sipas tij ndoshta kanë qenë liderët e parë me përkrahjen e vërtetë të popullit, me shkatërrimin e Republikës,partitë gjojase zhduken, që përsëri të paraqiten në Itali në kohën e Renesancës. Marcel Prelot thekson se vetëm romakët e kanë kultivuar idenë partive, që përputhet me konceptin e partive bashkëkohore, gjithashtu në grupin e autorve që mendojnë se partitë politike janë paraqitur në Romën e vjetër e bënë pjesë edhe Max Weberi. Partitët politike në Mesjetë- nuk njihen si organizata të formuara, por vetëm si grupacione që me merrnin frymë kohë pas kohe, me qëllim realizimin e objektivave të caktuara politike, bëhet fjalë për organizata politike pa antars, pa program dhe platformë të caktuar, formë të cilat i hasim tek partitë politike bashkëkohore. Edhe në shoqërinë feudale nuk janë të njohura partitë politike si organizata të formuara, por vetëm disa grupacione të kohëpaskoshme, të cilat pretendonin të realizojnë qëllime të caktuara, por jo si grupacione në kuptimin e partive politike, me antarësi, të bazuara në program dhe platformë të caktuar.Në Mesjetë janë të njohura lëvizjet para vendosjes së sistemit parlamentar në disa shtete të Evropës Perendimore. Këtu para se gjithash është fjala për luftën politike ndërmjet adhuruesve të monarkut dhe sistemit monarkist nga njëra anë, dhe simpatizuesve parlamentar nga ana tjetër. Në këtë kontekst mund të merren si shembuj grupimet politike në Angli në momentin e fundit të sundimit të Çarlsit të Dytë,pastaj klubet politike në Francë para ngadhnjimit të Revolucionit Borgjez dhe bashkimi i fshatarëve në Gjermani etj. Termi parti politike është mjaft i konsumuar si në literaturën shkencore ashtu edhe në jetën e përditëshme. Kjo është e logjikëshme në qoftë se nisemi nga fakti se partitë politike në ditët e sotme janë bartëse dhe organizatore kryesore të jetës politike pothuajse në çdo vend të botës. Andaj nuk është e rastit që hulumtuesit e partive politike angazhohen me një seriozitet jashtëzakonisht të madh në sqarimin e prejardhjes së nocionit “parti politike”definimin sa më përmbajtësor të tij si dhe ofrimin e të dhënave sa më të sakta për formën dhe mënyrën e parqitjes së partive politike në zhvillimin e shoqërisë njerzore. Megjithatë duhet theksuar se ekzistojnë dallime të vogla në aspektin e përdorimit shkencor dhe praktikopolitik të këti nocioni. Shprehja parti rrjedh nga fjala

³ Ante Fiamengo Bazat e sociologjisë së përgjithëshme Prishtinë1984 ;318

latine “pars-partis” që do të thotë pjesë e ndarë nga ndonjë tërsi. Radosh Smiljković konstaton se nocioni “parti” ka domethënie të dyfishtë. E para sipas tij, me parti duhet kuptuar pjesë të ndonjë tërësie dhe e dyta, ato (mendohet për partitë politike, E.A) nuk parqesin çfardo pjese që mund të ndahet, por atë pjesë që mund të ndahet në aspektin organizativ dhe ideopolitik, ndërsa edhe më tutje lidhëshmëria qenësore me tërsinë ose me pjesën më të madhe të saj të mbetet.⁴ Z Neumann thekson se termi parti do të thotë identifikim me një grup, bashkëpunim (partnership) në një organizim të veçantë. Në fund, vetë termi parti ka domethënie e inkuadrimit të organizatave të veçanta në tërsinë më të gjërë. Vlladimir Goati duke shprehur rezervë ndaj qëndrimit të Nojmanit, konstaton se autori në fjalë termi parti e ndërlidh me fjalë termin parti e ndërlidh me fjalën angleze “partnership” (bashkëpunim), megjithatë i njeti term mund të ndërlidhet me fjalën “partaking” që gjithashtu do të ndarje (të ndahet)⁵. Rodoamir Lukiq është i mendimit se termi parti politike nuk provokon mosmarrëveshje terminologjike më të mëdha. Kjo vjen nga ajo se në aspektin terminologjik pjesa më e madhe pajtohen se edhe në të folurit e rëndomtë edhe në të folurit shkencorë, me parti politik e kuptojmë po të njetën dukuri shoqërore ose ato organizata politike që zakonisht ashtu e quajnë vetvetën.⁶ Stein Rokkan, sociolog dhe politikolog norvegjez, shpjegon se shprehja parti rrjedh nga frengjishtja e vjetër, më saktë nga folja “partir” që do të thotë ndaj në pjesë, veçoj ndaj. Disa të tjerë duke u mbështetur tek historianët dhe qëndrimet e Max Weber, origjinën e fjalës “parti” që do të thotë “pjesë”.⁷

Mënyra e formimit të partive politike –partitë politike u krijuan në rrethana dhe kushte të caktuara historike, shikuar në përgjithësi, ashtu si u cek edhe më lartë partitë politike janë rezultat i zhvillimit të demokracisë qytetare të shekullit XIX, sistemi parlamentar dhe e drejta e përgjithëshme e votës ishin katalizatorët kryesor. Demokracia borgjeze me dy postulatet kryesore të saj parlamentarizmin dhe të drejtën e përgjithëshme të votës, s’ka dyshim se luajti rolin vendimtar në formimin e partive politike, gjë që vërteton numri i madh i hulumtuesve. Të dhënat historike dhe praktike e deritanishme na japin të drejtën të konstatojmë se partitë politike u formuan në dy mënyra. Mënyra e parë është ndarja e deputeteve në parlament dhe grupimi i tyre në bazë të interesave të caktuar, me ç’rast erdhi deri te formimi i grupeve parlamentare. Qëllimi i formimit të këtyre grupeve veç tjerash ishte edhe rizgjedhja eventuale në parlament. Në të njetën kohë grupet politike që vepronin jashtë parlamentit, bënë trysni të përhershme mbi parlamentarët duke ua mohuar legjitimitetin. Kjo i detyroi grupet e formuara

⁴ Radosh Smiljković; Stranke i politika Beograd 1976;11

⁵ Vlladimir Goati Savremene političke partie Beograd 1984;22

⁶ Radomir Lukiq Političke stranke Beograd 1981;19

⁷ Daniel Louis Seiler Partitë politike Tiranë 2000;12

parlamentare që rreth personaliteteve të shquara që gëzonin autoritet në masat e gjëra popullore të formojnë komitete zgjedhore nga qytetarët që tanimë kishin fituar të drejtën e votës. Qëllimi i formimit të komiteteve zgjedhore ishte që ithtarët e grupeve parlamentare t'i afirmojnë idetë e grupit parlamentar brenda masës që kishte të drejtën e votës, zgjerimi i të drejtës së votës lindi raporte varshëmërie dhe interesi të ndërsjellt ndërmjet grupeve parlamentare dhe trupit votues, gjegjësisht qytetarëve me të drejtë vote. Edrejta e votës ishte një arritur historike, vlerë e veçantë në zhvillimin e demokracisë qytetare që trupit votues në një farë mënyre i mundësoi sadopak të ndikojë në marrjen e vendimeve në parlament. Mënyra e dytë e formimit të partive politike është jashtë parlamentit. Tani më janë të njohura rastet kur grupet të ndryshme të interesit, shoqata profesionale, organizata të ndryshme, struktura kishtarë ndikojnë dukshëm në formimin e partive politike. Në shumicën e rasteve roli i tyre është vendimtarë. Shembull më konkret janë partitë demokristiane që formohen nën ndikimin e drejtëpërdrejt të Kishes Katolike, Partia Laburiste e Britanisë së Madhe që u formua nga Lidhja e sindikatve, trejtunionet etj. Moris Diverzhe thotë se partitë politike në kuptimin e plotë të fjalës formohen atëherë kur grupi parlamentar lidhet me organizatat e bashkëmendimtarëve jashtë parlamentit. Në ruajtjen dhe kultivimin e këtyre lidhjeve rol të rëndësishëm luajtën klubet politike që i themeluan partitë e atëhershme në Londër. Kështu në vitin 1831 “konservatorët” e formuan klubin e tyre të quajtur “Karlton” ndërsa pak më vonë, në vitin 1836 liberalët e formuan “Klubin Refermues”. Në këto klube përveç deputeteve ishin të antarsuar edhe mjaft personalitete të dalluara të organizatave jashtë parlamentit.⁸ Njëri nga njohësit më të mirë të historisë së formimit të partive politike në Britaninë e Madhe dhe SHBA M.Ostrogorski, në veçanti e theksoi rolin e klubeve si formë e organizimit politik në vigjilje të Revolucionit amerikan nga fundi ishekullit XVIII. Klubet që lulëzonin sidom në Boston u shëndrrua në qendra të debateve politike, nga të cilët së shpejti lindi një rezistencë e hapur ndaj akteve arbitrare të parlamentit anglez.⁹ Faza përfundimtare në formimin e partive politike në SHBA është parqitja e “konventave” partiake në të cilat bëhej verifikimi i listave të kandidatëve të mundshëm për funksione publike. Moris Diverzhe gjatë studimit të partive politike erdhi në përfundim se mënyra e formimit të partive politike lë gjurmë që shumë lehtë vërehen edhe disa dhjetëvjeçarë pas themelimit të tyre. Kështu partitë që formohen jashtë parlamentit nën ndikimin e grupeve të ndryshme të interesit, në krahasim me partitë që formohen nëpërmjet grupimit të deputetëve në parlament janë më të disiplinuar, më të centralizuara, idologjikisht më kohorente dhe brebda tyre është më e vogël ndikimi i grupeve parlamentar.

⁸ Radomir Llukiq Političke stranke Beograd 1981;11

⁹ Mojsije Ostrogorski Demokratija i političke partie Beograd 1921;77

2.Roli shoqëror i partive politike në fazat më të hershme të zhvillimit të shoqërive kapitaliste

Partitë politike si organizatë e formuar me vetë program të caktuar në feudalizëm nuk janë të njohura. Kanë ekzistuar vetëm grupacione të kohëpaskohshme, por jo si grupacione në kuptimin e partive politike, me anëtarësi në bazë të programit të caktuar. Për partitë politike, të asaj kohe mund të flitet deri diku vetëm në mënyrë të kondicionuar, pasi gjatë kësaj kohe nuk ekzistonin akoma organizata politike të formuara si ato që u krijuan pas fitores dhe vendosjes së kapitalizmit në vendet kryesore të Evropës. Partitë me statut dhe program të shkruar janë të datës së vonshme (me shfaqjen e rendit shoqëror kapitalist). Në fazë më të hershme kur e drejta aktive e votës ishte e kufizuar, roli i partive politike pothuajse nuk vërehet fare, këtë e dëshmon më së miri jeta politike e atëhershme në Angli. Zakonisht përpara zgjedhjeve, gjatë takimeve të pronarëve të mëdhej të tokave caktoheshin emrat e kandidatëve për në parlament, pronarët e tjerë i pranonin këto emra të bindur se ishin propozuar më të mirët. Edhe jeta politike brenda parlamentit zhvillohej pa debate edhe kundërshtime të mëdha, me vetëfaktin se të zgjedhurit i takonin aristokracisë, ndërsa ata vetë kishin lidhje farefisnore dhe miqësore ndërmjet tyre, ku vinte në shprehje parimi **“Do të votoni këta zotërinj, ashtu siç voton familja juaj dhe nuk mund ta shprehni bindjen tuaj”**¹⁰ meqenëse djepi parqitjes së partive politike konsiderohet Anglia në këtë fazë të hershme dallojmë dy parti politike; Partia e pronarëve të mëdhej (Torievet), dhe partia e shtresave të mesme (Vigotët), prej së cilës më vonë zë fill Partia Konservatore (1824) dhe Partia Liberale (1832), në Angli, Partia Liberale në Angli ishte parti klasike e borgjezisë industriale angleze, pastaj në Angli ekzistonin si parti edhe Partia Laburiste parti e cila mbronte interesat e punëtorëve, paraqitja e partive politike në Angli ishte e lidhur me demokratizimin e shoqërisë angleze, sidomos me reformat zgjedhore dhe përhapjen e të drejtës së votës.¹¹ Paraqitja e partisë Konservatore dhe partisë Liberale në Angli, është drejtpërdrejtë e lidhur me demokratizimin e shoqërisë angleze, e sidomos me reformat zgjedhore dhe përhapjen e të drejtës së votës në masat e gjëra popullore.¹² Nënkuptohej se të drejtën e votës masat e gjëra popullore nuk e fituan përnjëherë, por gradualisht, ashtu si krijoheshin kushtet. Vetëm të rikujtojmë se në fillim të shek. XIX në Britaninë e Madhe statusin e zgjedhësve e kishin vetëm 5-7% e qytetarëve të moshës madhore. Ndryshimet që ndodhën në jetën shoqërore politike të Anglisë

¹⁰ Ostrogorski, Mojsije: Demokratija i političke partije, Beograd, 1921; 21

¹¹ Etem Aziri Sociologjia Partitë politike Tetovë 2007; 7

¹² Iniciator të reformave e sidomos reformave zgjedhore ishin Vigotët. Ata në vitet e njëzeta dhe vitet e tridhjeta me qëllim të përhapjes së votës kërkonin mëshkëmbim nga shtresat e mesme, borgjezia e imët dhe punëtorët. Vigotëve në fakt u takojnë meritat për reforma zgjedhore

së atëherëshme, para së gjithash duhet të kuptohen si rezultat i zhvillimit ekonomik dhe industrial të vendit dhe ideve parlamentare të Revolucionit Borgjez Francez dhe lëvizjeve tjera politike në Evropë.¹³

Partia Konservatore vazhdon ti prezentojnë dhe ti mbrojnë interesat e pronarëve të mëdhenj të tokës, kishës dhe traditave angleze, ndërsa Partia Liberale interesat e kapitalit industrial që ishte në ekspansion e sipër, liritë religjioze dhe gjithë atë që nënkuptonin idetë të asaj kohe. Partia liberale kjo parti nënkuptonte përparimin e lirive dhe barazive individuale e grupe, që ishin si rezultat i kundërthënive dhe përçarjeve shoqërore ndërmjet fisnikërisë, aristokrate dhe shtresës qytetare, pra ideve konservatore dhe përparimtare. Partitë konservatore në këtë fazë të hershme të zhvillimit i karakterizon mbrojtja e privilegjeve të shtresave të vjetra, ulja e nivelt dhe mospajtueshmëria ndërmjet konservatorizmit dhe liberalizmit në sferen e ndërtimit të konceptit të shtete kombeve, e deri te konservatorizmi qytetar kombëtar modern që zgjati prej 1918-1933 në rrafshin politik ishte i përfaqësuar nga partitë “elitiste” dhe elitave shoqërore konservatore të cilët rikthehen qëndrimeve joliberalë dhe jodemokratike, gjithashtu me përtrirje shpirtërore e konservatizmit dhe partive konservatore. Në Francë, si vend ku nodhën mjaft lëvizje dhe traziar si rezultata i kundërthënive shoqërore, idetë për krijimin e partive politike i hasim të iluministët e shekullit XVIII. Poashtu në kohën e Revolucionit demokratik francez shfaqjen e partive Zhirondiste dhe Jakobiane, koncept që parashihte kalimin gradual, evolutiv prej kapitalizmit në socializëm, nëpërmes reformave të një pas njëshme. Në këtë fazë të hershme të kapitalizmit, dallojmë edhe dy grupacione politike në SHBA Federalistët të cilët angazhoheshin në mbrojtjen e interesave industrialistëve, kapitalit tregtar dhe financiar, dhe Kundërfederalistët i mbrojnë interesat e pronarëve të vegjël dhe të mesëm të tokave dhe shtresave të tjera të mesme. Sistemi kapitalist ka shkaktuar formimin gradualisht ndarjen, pastaj formimin organizativ dhe politik psikologjik të shtresave shoqërore. Partitë politike të cilat janë shfaqur në shekullin e kaluar në suaza të parlamentarizmit në një kuptim janë realizim i orvatjeve shoqërore – politike mbi barzinë juridike të qytetarëve dhe të drejtave të tyre që të afirmojnë vullnetin e tyre dhe kërkesat e veta politike dhe ekonomike me rrugën e parlamentarizmit, si e vetmja rrugë shoqërore, prandaj mund të themi se partitë politike në fazë më të hershme të zhvillimit kapitalist kishin një fizionomi ideore të veprimit politik ku dominonte ideologjia konservatore dhe ajo liberale, partitë e mëvonshme dallojnë në shumëllojshmëri nga partitë e më hershme.

¹³ Etem Aziri Sistemet politike Tetovë 2012;120;121

3.Roli shoqëror i partive politike dhe zhvillimi demokratik në shoqëritë bashkëkohore

Partitë politike në kuptimin e sotëm të fjalës në Evropë u paraqitën për herë të parë nga fillimi i shekullit XIX, në Britani të Madhe dhe Francë, më vonë, nga mesi i po të njetit shekull dhe në vendet tjera; Gjermani, Itali, Belgjikë dhe shtetet e Evropës Lindore. Partitë politike janë fryt i formacionit shoqëror-ekonomik kapitalist, formacion në të cilin u paraqitën dallimet më të shprehura shoqërore, ekonomike, politike dhe ideore. Në qendër të diferencimit qëndronin interesat e përbashkëta dhe të kundërta të grupeve të veçanta shoqërore, që ndikuan si katalizator në paraqitjen dhe zhvillimin e partive politike. Partitë politike të cilat u shfaqën në shekullin e XIX në suazat e zhvillimit të parlamentarizmit, në një kuptim janë realizim i përpjekjeve shoqërore-politike mbi barazinë juridike të qytetarëve dhe të drejtave të tyre që t'i afirmojnë vullnetin e vet dhe kërkesat e veta politike dhe ekonomike nëpërmes rrugës parlamentare si alternativë e vetme.¹⁴

Sistemi kapitalist i cili dallohet për shumëçka nga sistemet e mëparshme, ndryshimet e hovëshme ekonomike që ishin rezultat i drejtëprdrejt i zhvillimit shkencor/teknike e teknologjike, nuk mund të mos ndikonin në sferën politike. Domethënë, ndryshimet ekonomike nxitën edhe zhvillimin përkatës politik, kulturor dhe ideor, para se gjithash në rrafshin e lirive politike, qofshin ato a individuale apo kolektive. Partitë politike zënë një vend të rëndësishëm në shoqëritë bashkëkohore, ato janë kthyer në faktor të domosdoshëm, pa të cilët nuk mund të ketë zhvillim shoqërore. Në shoqëritë bashkëkohore roli i partive politike është i dyfishtë; Nga njëra anë, aktiviteti i tyre është i varur drejtëpërsëdrejti nga niveli i demokratizimit të shoqërisë, nga ana tjetër, mobilizojnë shoqërinë me qëllim të konsolidimit të mëtejshëm të vlerave demokratike, të cilat janë pjesë e një procesi të pakufizuar.¹⁵ Demokracia si formë e qeverisjes u riaktualizua pas shkatrrimit të rendit feudal dhe paraqitjes së kapitalizmit si rend shoqërore, i cili si në kuptimin e institucioneve, ashtu dhe në kuptimin e politikave publike dallonte nga formacionet e mëparshme shoqërore-politike. Si rezultat i zhvillimit të jetës shoqërore dhe politike në kapitalizëm, në rradhë të parë në sferën e respektimit të të drejtave dhe lirive individuale e kolektive, ku veçohet përhapja graduale e të drejtës votës tek masat e gjëra popullore, u shfaqën edhe partitë politike që luanin rolin e subjekteve ndërmjetësuese mes qytetarëve dhe shtetit në proceset e politikbërjes. Partitë politike u vunë në shërbim të shoqëris në momentet kur masat e gjëra popullore fituan të drejtën e votës, si një arritje shumë e vlefshme e demokracisë bashkëkohore. Që prej këtij momenti, partitë politike u shëndrruan dalëngadal në mjete për realizimin dhe funksionimin e

¹⁴ Etem Aziri Sociologjia Tetovë 2007;340

¹⁵ Etem Aziri Sociologjia Tetovë 2007;354

demokracisë, shumë shpejt ato u transformuan në pjesëmarrëse aktive në të gjitha proceset politike dhe demokratike. Aktiviteti i partive politike në zhvillimin e mendimit politik është sa i rëndësishëm aq i dobishëm, në demokracit moderne-bashkëkohore vullneti popullit duhet të shprehet domodoshëmish nëpërmjet partive politike, partitë politike shfaqen para se gjithash si promotorë kryesorë në procesin e krijimit të vullnetit politik të popullit.¹⁶ Partitë politike bashkëkohore janë shfaqur me shumë anëtarë të vetë, me organizata masovike si forcë politike në shoqëri të caktuar. Ato janë rritur në organizata gjiganteske, të cilat disponojnë me një taktikë dhe strategji të caktuar, me ideologjinë e vetë, metodat e veprimit, për përvetsimin e pushtetit politik në mënyrë demokratike, kështu partitë politike në shoqërit bashkëkohore janë faktor i rëndësishëm politik. Partitë politike në ngjarjet e shumta dhe dinamike të shoqërisë bashkëkohore kanë kristalizuar fizionominë e tyre, kanë gjetur vendin në strukturën e shoqërisë bashkëkohore dhe ndikojnë mjaft në juridiksionin shtetëror. Nga kjo që u tha mund të konstatojmë se në kushtet të reja të shoqëris moderne, partitë politike janë rritur në organizata të mëdha të cilat me rrjetën e organeve të tyre përfshijën shtetin dhe me aktivitetin e vet mbështeten në mjete të mëdha financiare dhe në aparatin e madh profesional. Partitë politike dhe demokracia moderne zhvillohen në një varshmëri të ndërsjellë, ato e afirmojnë, kushtëzojnë dhe avancojnë njëra tjetrën. Partitë politike e ndihmojnë demokracinë moderne-bashkëkohore në dy segmente; Segmenti i parë ka të bëjë me zgjedhje të lira demokratike, ndërsa segmenti i dytë e nëkupton angazhimin e partive në drejtim të krijimit të opinionit publik. Partitë politike luajnë rol të veçantë në mobilizimin e opinionit publik, që kanë për detyrë t'i mobilizojnë masat popullore rreth disa opinioneve të rrumbullakuara, që kanë të bëjnë me përditshmërin e tyre, por edhe me zhvillimin e shoqëris në përgjithësi. Partitë politike edhe pse luajnë rol qendror në krijimin e vullnetit politik, nuk janë të vetmet dhe pa konkurrencë. Në shoqërit me tradita pluralo-politike në po të njetën sfer angazhohen edhe mekanizma tjerë shoqëror, siç janë; shoqatat e ndryshme, masmediat, institucionet fetare, qytetarët e rëndomtë etj. Duhet të theksojm se partitë u pozicionuan në shoqëritë bashkëkohore përmes një rruge të lodhshme, sfiduese dhe se partitë politike në zhvillimet demokratike në shoqëritë bashkëkohore angazhohen që ushtrimi i pushtetit shtetëror të kalojë nëpërmjet popullit dhe të legjitimohet nga vota e popullit.¹⁷

Demokracia u mundëson qytetarëve të mbrojnë interesat e tyre, qytetarët në vendet demokratike jetojnë në sistem ku janë në fuqi ligjet, të cilat i përcaktojnë përfaqësuesit e atyre qytetarëve. Një pjesë e funksioneve burojnë nga detyrimi ligjorë dhe kushtetues, të tjerat nga pozitë në shoqëri dhe një

¹⁶ Etem Aziri Sociologjia Tetovë 2007;358

¹⁷ Zaganjori Zhezairi Demokracia dhe shteti i së drejtës Tiranë 2002;187

pjesa më konkrete nga roli i partive në sistemin politik. Duke pasur një funksion të madh, rolin e ndërmjetësit midis qytetarëve dhe organeve kushtetuese, ato e përmbushin këtë përgjegjësi në disa aspekte të ndryshme të këtyre marrdhënieve.¹⁸

Funksioni programor-funksion i cili përbën thelbin e identifikimit të partive politike, programet partiake të partive kryejnë para se gjithash dy funksione kryesore. Në njërën anë ato duhet të artikulojnë interesat e qytetarëve (partitë politike si “zgjedhëse” të popullit), ndërsa në anën tjetër është detyrë e programeve partiake ndikimi i formimit të vullnetit politik të qytetarëve (partitë politike si “formuese” të vullnetit të popullit). Partitë kanë programe, me të cilat prezentohen përpara elektoratit dhe përpiqen të fitojnë numër sa më të madh votash. Programet e tyre janë hartuar në mënyrë që të përfaqsojnë sa më mirë të gjitha shtresat e popullsisë, të paraqesin oferta bindëse, të këto nota realiste dhe pas zgjedhjeve, në qeveri ose opozitë, të ketë mundësi në reale për t’u ballafaquar para elektoratit me arritjet dhe mosrealizimet e programit. Të gjitha partitë kanë metodat të debatimit të çështjeve dhe të formulimit të politikave të cilat prezentohen në elektorat gjatë fushatave dhe në tërësi përbëjnë bazën e një kontrate sociale midis partive dhe zgjedhësve.

Artikulimi i interesave –më ndihmën e partive politike dhe programeve të tyre elektorale, qytetarët i kanalizojnë idetë dhe kërkesat e tyre në rrugë legale në sistemin politik. Kjo mënyrë e artikullimit të interesave i jep shansin çdo shtetëse dhe grupimi social, sado i vogël dhe periferik të jetë ai, të bëhet faktor, të ndjehet i vlerësuar dhe i përfaqësuar, të marrë pjesë indirekt në hartimin e politikave dhe në një fazë të dytë edhe në vendimë marrje.¹⁹

Funksioni legjitimues-përmbushja e funksionit bazë, ndërmjetimit midis qytetarit dhe sistemit politik, u jep mundësi partive të krijojnë një urë lidhëse besim dhe marrëdhënieve reciproke midis qytetarëve dhe sistemit, dhe rendit kushtetues. Partitë i edukojnë zgjedhësit me kulturën e njohjes dhe zbatimit të ligjit, të rregullave demokratike, të konkurrencës së vlerave dhe respektit për institucionet shtetërore e kushtetuese.

Funksioni pjesëmarrës-partitë, me strukturat, programet, anëtarësinë, fushatën dhe angazhimin saj elektorale, u mundësojnë qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit të marrin pjesë në politikë dhe vendimë marrje, është një nga synimet permanente të partive thirrja e individëve dhe grupeve shoqërore në votime, rritja e pjesëmarrjes në votime dhe në debatet publike rreth politikave elektorale

¹⁸ Veton Latifi Konceptet e demokracisë Tetovë 2008;85

¹⁹ Afrim Krasniqi partitë politike dhe sistemi politik Tiranë 2008;47

dhe programeve të partive duke mundësuar kështu edhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin politik.

Rekrutimi i personelit-partitë janë zyra punsimi, por ato kanë mundësinë, privilegjin dhe përgjegjësinë të promovojnë figura politike, të parqesin kandidatët për zgjedhjet parlamentare dhe lokale, të zgjedhin kandidatë për postet politike në ekzekutiv dhe postet e tjera të larta politike dhe në këtë mënyrë, të sigurojnë rotacionë demokratik dhe cilësor të pushtetit sa herë që votuesit e kërkojnë këtë. Partitë promovojnë kandidatë me mbështetje, para dhe infrastrukturë, duke e bërë më lehtë për votuesit të identifikojnë kandidatin dhe programin e tij politik.

Partitë janë shkolla të demokracisë – ato janë një formë me të cilën njerzit me interesa të njëta mbledhen, organizohen dhe marrin pjesë në zgjedhje dhe zhvillojnë fushata elektorale. Partitë mbledhin së bashku njerëz që kanë ide dhe filozofi politike të njëta, mund të ndodh që këta njerëz të mos jenë dakord me njeri -tjetrin, por në thelbin e ideve politike mendojnë njësoj. Dallimet shfaqen në forma të ndryshme, siç janë fraksonet dhe tendencat e shprehjes së parimeve politike por në momentet e fundit vendimet merren mbi bazën e rregullave demokratike. Partitë përfaqsojnë shtresa dhe sektorë të ndryshëm të shoqërisë në përmbushjen e funksionit të tyre të përfaqsimi. Partitë janë shumë të lidhura me elktoratin me opinionin publik, marrin vendime në varësi nga sondazhet dhe opinioni, kryerjenë konsultime të vazhdueshme me elktoratin dhe grupet e interesit shoqëri, në hartimin e ligjeve merr parasysh një sërë subjektsh konsultuese, japin llogari për vendimet e tyre si dhe veprojnë gjithnjë përballë presionit për mbajtjen e premtimeve të dhëna nga kandidati dhe partia në zgjedhjet e fundit elektorale .²⁰

Partitë funksionojnë si shkolla politike-ato janë institucione që kanë mjetet, mundësitë dhe interesin të promovojnë të rinjtë në politikë, ata kanë dhe zhvillojnë struktura rinore ,në mënyrë që politikanët e rinj më të spikatur të promovohen. Dalja vazhdimisht në zgjedhje me një listë kandidatësh ku përfshihen edhe politikanë të rinj,me nevojën për energji të reja politike në strukturat politike si dhe për garantimin e vazhdimësisë politike. Përmes botimeve, kurseve akademike, fondacioneve, por edhe aktivitetit politikë në qeveri dhe parlament, ato ndikojnë në përgaditjen e politikanëve të rinj, në ruajtjen dhe pasurimin e traditave politike, sigurojnë vazhdimësinë e tyre etj.

Funksioni ndërmjësues – ky funksion lidhet me dy funksionet e mëparshme, atë programor dhe artikulimit të interesave. Partitë përfaqsojnë qytetarët, grupet shoqërore, votuesit dhe interesat e tyre

²⁰ Afrim Krasniqi Historia roli organizimi,modelet dhe tiparet e partive dhe sistemeve politike Tiranë 2008;49

duke krijuar një program politik tolerant dhe mundësisht gjithëpërfshirës. Partitë duhet të jenë të gatshme që për interesa të mëdha, ato që kanë të bëjnë me interesat jetike të qytetarëve, prioritetet e politikës kombëtare dhe interesat e caktuara kombëtare, të heqin dorë nga përcaktimet dhe dallime programore dhe të kërkojnë modifikimi të qëndrimeve, çfarë do të thotë se ato vendosin qytetarin dhe interesat e tij mbi të gjitha interesat e tjara elektorale e programore.²¹

Integrimi i interesave-me përmbushjen e këtij funksioni lidhet edhe përgjegjësia e partive politike për të integruar në program, në parti, në struktura dhe sidomos në politikat e saj konkrete në qeveri apo parlament, interesat e grupeve të ndryshme në shoqëri. Ky funksion integruet për t'u bërë katalizatorë socialë dhe politikë. Këtë funksion e përmbushin edhe shoqatat dhe elementët e tjerë të ndërmjësimit qytetar-sistem, por asnjë prej tyre nuk mund ta bëjë rrugën më të shkurtër dhe më konkrete sesa partitë, të cilat zotërojnë vende në parlament dhe në qeveri.²²

Funksioni i mobilizimit elektoral – mobilizojnë dhe rekrutojnë që do të thotë organizojnë fushata për të gjetur zgjedhës dhe anëtarë për partinë, ky funksion bazohet në idenë se kandidatët mund të dalin vetë si të tillë por ata kanë nevojë për mbështetjen e një partie për mobilizimin e elektoratit. Elektorati përgjithsisht voton për partinë, jo për kandidatët individualë. Ndërkohë, për përzgjedhjen e kandidatëve partitë bëjnë brenda tyre një proces seleksionimi paraprak, zgjedhja përfundimtare bëhet nga votuesit, të cilët zgjedhin listën e ofruar nga partitë politike. Ky funksion është shumë i rëndësishëm sidomos në ato zona elektorale ku partia ka siguri të plotë për fitore.²³

Funksionet e tjera – që kanë të bëjnë me nxitjen e paqes, dialogut, bashkëpunimit, janë funksione universale, por që për shkak të rrethanave të caktuara marrin vlera dhe rëndësi të veçantë, një premtim i një partie gjermane dhe shqiptare për paqen nuk e ka domethënien e njëjtë me angazhimin e një partie politike në vende me konflikte politike, si p.sh në Irlandën e Veriut, Spanjën Veriore, Kosovë, Maqedoni apo vendet e tjera europiane. Partitë promovonë shtetin dhe ligjin sepse ato besojnë se këto dy institucione i kanë të gjitha mjetet dhe garancitë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin midis qytetarëve dhe grupeve të interesit, gjë që i afron qytetarët akoma më shumë me sistemin dhe rrit besimin e tyre të ndërsjellë.

²¹ Afrim Krasniqi Partitë politike dhe sistemet politike Tiranë 2008;50

²² Afrim Krasniqi Partitë politike dhe sistemet politike Tiranë 2008;51

²³ Kaval Mellenye Tranoy Politika dhe Demokracia ;47

1. Paraqitja e partive politike në Republikën e Maqedonisë

Pas legjitimitetit të pluralizmit politik në Maqedoni, edhe pse me vonesë në krahasim me mjediset e tjera të ish Federatës jugosllave, formimi i partive politike u shfaq nevojë e kohës edhe për Maqedoninë. Numëri i partive politike i tejkalonte që në fillim nevojat reale të tregut politik të Maqedonisë. Kjo dukuri deri diku ishte e zakonshme për vendet në tranzicion, vendete me kundërthënie të shprehura ndëretnike, kulturore dhe konfesionale, si dhe vende që kalonin në rrafshin ekonomik e social. Në Republikën e Maqedonisë brenda një periudhe të shkurtër kohore u shfaq një numër relativisht i madh i partive politike, që përfaqsonin shtresat të ndryshme shoqërore në proceset zgjedhore, etnitete, bashkësi kulturore konfesionale të ndryshme. Shumë parti të posaçëformuara kishin programe dhe platforma identike, që do të thotë se në rrafshin politik bëhej një luftë e ashpër për marrjen e legjitimitetit.²⁴ Me kalimin e kohës filloi procesi i profilizimit të partive politike dhe vetë, atë edhe rënien e intensitetit të shfaqjes së partive të reja, por sot numri i partive politike të regjistruar në Maqedoni është afro 80, pjesa më e madhe e partive politike nuk i kanë arritur qëllimin të fitojë legjitimitetin nga zgjedhësit, veprimet e të cilve ju ngjajn më shumë grupeve të interesit sesa veprimet të partive politike. Në përgjithësi një numër i konsiderueshëm i partive nuk kandidojnë antarët e tyre në zgjedhje dhe tentojnë të mbetën në skenën politike duke mbështetur kandidatët e partive të tjera, ose duke mbajtur kohë pas kohe ndonjë konferencë shtypi, apo duke dhënë deklarata për opinionin e gjërë. Pavarësisht kësaj, afro një e treta e partive politike të regjistruara marrin pjesë në zgjedhjet, edhe pse suksesi i tyre është mjaft i dobët karshi partive të cilat kanë ndërtuar një identitet të vetin. Nga të gjitha partitë politike të regjistruara që veprojnë aktualisht në Maqedoni, numëri më i madh i takon bllokut maqedonas.

Partia e parë politike që u formua për t'i bërë opozencë Lidhjes Komuniste të Maqedonisë, ishte Lëvizja për Aksion Mbarëmaqedonas(MAAK), kjo parti u formua në vitin 1990, kjo parti hapi dyert e pluralizmit në Maqedoni, parti e cila trajtonte çështjen kombëtare maqedonase si të pa zgjidhur deri më sot, parti e cila mori përsipër të vihet në mbrojtjen e interesave të maqedonasve dhe jashtë kufijëve të Maqedonisë. Megjithatë zgjidhjen e përfundimtare të çështjes maqedonase nuk e shihte nëpërmjet dhunës dhe opsionit luftarak, por bashkëpunim të popujve të Ballkanit, ishte parti e parë që u angazhua për Maqedoninë si shtet i pavarur dhe sovran. Partia (MAAK) në kongresin e dytë të mbajtur në maj u shëndrrua në parti konservatore, që erdhi si rezultat i angazhimit të pjesës më të madhe të strukturave partiake për gjetjen e një hapësire më të sigurtë monavruese. MAAK-u që në fillimet e aktivitetit të saj

²⁴ Etem Aziri Partitë politike dhe demokracia Logos Shkup;2004;43

u përcaktua si parti atdhetare dhe me profilizimin të ngjashëm më atë të partive të bllokut maqedonas, ndërsa mendonte se hapsira e “rezervuar” për partitë konzervatore.

Trysnia e rethanave të krijuara dhe depërtimi i pluralizmit në Maqedoni, ndikoi në transformimin e Lidhjes Komuniste të Maqedonisë në Parti e Reformave Demokratike (LKM), kjo parti u formua në qershor të vitit 1990, në prill të vitit 1991 antarsia vendosi që LKM-Partia e Reformave Demokratike të ndryshojë emrin e saj dhe të veprojë në të ardhmen si Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë-LSDM.²⁵ LSDM ja – u përcaktua si parti që pranonte parimet bashkëkohore të social demokracisë, të bazuar në efikasitetin shoqëror dhe ekonomik dhe në parimet bazë etike të humanizmit evropian, të drejtës shoqërore dhe dinjitetit të njeriut. Lidhja socialiste e Popullit Punonjës të Maqedonisë u transformua në Parti Socialiste të Maqedonisë, u përcaktua si organizatë e pavarur politike me orientim socialist demokratik, parti e cila në një kongres të mbajtur më vonë do të caktohet si parti politike demokratike me orientim të qart socialist e cila synonte t’i bashkonte të gjithë qytetarët që ndanin ide të njëjta. Partia Socialiste nuk e konsideronte veten si parti elitë, por si parti që përfaqëonte interesat e masave të, parti që përfaqëonte interesat e masave të gjëra të shoqërisë, parti e cila e vlersonte veten si parti përfaqësuese e shtresave të mesme dhe të varfra të punëtorëve, bujqve dhe intelektualëve. Transformimi i mëtejshëm i kësaj partie ndikoi më shumë në drejtim të forcimit të elementit kombëtar se atij qytetarë. Kjo parti në pamundësi për të qenë konkurente e LSDM-së në skenën politike, si parti me orientim majtist, në kërkim të prespektivës së shmang në shumë drejtime të parimeve të proklamuar. Kështu, në platformën politike të kongresit të tretë ajo u përcaktua si parti “parti e përcaktim të forta e të qarta politike dhe jo e alternativave në aspektin e interesave kombëtare maqedonas”.

Një nga dy partitë më me shumë influencë në bllokun politik maqedonas është Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar Maqedonas (VMRO), parti e cila u shfaq në qershor të vitit 1990, dokumentet e hershme tregojnë se qëllimi i formimit të VMRO-DPMNE-së ishte “kthimi i dinjitetit dhe krenarisë së maqedonasit si njeri, popullit maqedonas dhe shtetit maqedonas, si dhe “bashkimi i tërësishëm shpirtëror, politik ekonomik dhe etnik ishtetit dhe popullit maqedonas të copëtuar, në Ballkani e ardhëshëm të bashkuar dhe Evropën e bashkuar”.²⁶ Kjo parti vetën e konsideronte si parti politike moderne e popullit maqedonas, qëllimet kryesor të VMRO-DPMNE-së janë angazhimi për shtet sovran maqedonas në planin ekonomik e politik dhe zhvillimi i shpejtë i saj në kushtet e ekonomisë së tregut

²⁵ Etem Aziri Partitë politike, zgjedhjet dhe sistemi zgjedhor Tetovë 2015;137

²⁶ Etem Aziri Partitë politike, zgjedhjet dhe sistemi zgjedhor Tetovë 2015;137;138

dhe pronës private. Sipas statutit të miratuar në kongresinë e mbajtur në Strumicë ndër qëllimet kryesore të partisë ishin edhe “zhvillimi prosperiteti i Republikës së pavarur dhe sovranë të Maqedonisë”, ngritje dinjitetit dhe vlerave shpirtërore të popullit maqedonas, qytetarëve të Maqedonisë dhe shtetit maqedonas”, konsolidimin e shtetit të shtetit të së drejtës, pavarësi të sistemit gjyqësor. Kjo parti në këtë fazë të hershme kishte përgjegjësi për shtabilizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të shtetit, mirpo partia VMRO DPMNE si parti në pushtet nuk afirmoj ndonjë politik favorizuese që t’iu paraprinte disa proceseve të domosdoshme në rrafshin e mardhënieve ndëretnike, si parti politike nuk mund ti shmanget asnjherë përgjegjësisë së saj për popullatën e pafajshme shqiptare në disa pjesë të vendit.²⁷ Në tetor të vitit 1990 u formua edhe Lidhja e Forcave Reformiste, që ishte pjesë e Lidhjes së vetme të Forcave Reformiste të Jugosllavisë, qëllimet kryesore të kësaj partie ishin ndërtimi i një ekonomie efikase, shoqërie demokratike, zbatim të drejtësisë shoqërore dhe të hapur ndaj botës, angazhoheshin “për qytetarë të lirë në shoqëri të lirë”.

Në kuvendin e mbajtur në fund të qershorit të vitit 1991, u mor vendimi që kjo parti të bashkohet me Partinë e Re Demokratike Progresive të Maqedonisë, duke u emëruar si Forcat Reformiste të Maqedonisë-Partia Liberale, këto parti kishin qëllime gati se të përbashkëta dhe për atë u bë bashkimi i dy partive, bashkimi ndodhi me qëllim të “realizimit sa më të shpejtë të qëllimeve të parshtruara”. Ndarja dhe bashkimi i partive u bënë gjë e rëndomtë në gjysmën e viteve nëntëdhjeta, në korrik të vitit 1993 u formua Partia Liberale parti e cila u profiluzua si parti e cila nuk tentonte për pushtet ose për pushtet të interesave ngusht partiak, por për pushtet në realizimin të reformave strukturore dhe transformimit të shoqërisë maqedonase. Kjo ishte vazhdimi i Forcave Reformiste, angazhohej për afrimin e Republikës së Maqedonisë si shtet sovran, të pavarur demokratik e social dhe një ndër pikë synimet e saj ishte “formimi i shoqërisë qytetare”, gjithashtu iden e zhvillimit shoqëror të Maqedonisë, në paqë dhe bashkëjetesë të popullit maqedonas dhe nacionaliteteve, decentralizimi dhe zhvillimi i qeverisjes vendore për liberalet kishte një rëndësi të veçantë. Edhe kjo parti vendosi të bashkohej me Partinë Demokratike kongresi i bashkimit u mbajt më 19 prill 1997 në Shkup, ndërsa vetë kjo parti u formua në shtator të vitit 1993.²⁸ Programi i Partisë Demokratike parqiste një kombinim të programeve dhe ideve të partive të bashkuara, në planin e jashtëm Partia Liberale- Demokratike përcaktohej për integrimin evropian dhe euro-atlantik dhenë drejtim të përmbushjes së disa kushteve të domosdoshme siç ishin; ndërtimi i shtetve ligjor, kultivimi i vlerave të demokracisë liberale sipas standarteve evropiane, angazhimi për të drejtat dhe liritë individuale të qytetarit, ndërtimi i

²⁷ Etem Aziri Partitë politike zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore Tetovë 2015;139

²⁸ Etem Aziri Partitë politike, zgjedhjet dhe sistemi zgjedhore Tetovë 2015;139

marrdhënieve të mira ndërfaqinësore, përmisimi dhe përparimi i marrdhënieve të mira ndëretnike ishte një ndër synimet kryesore të kësaj partie. Në mars të vitit 1998 u formua partia Alternativa Demokratike interes të madh kjo parti kishte në përparimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, zgjerimi dhe mbrojtja e lirive politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, në qendër të vëmendjes ishte njeriu si individ. Rëndësi të veçantë i kushtonte sistemit të arsimit, sipas të cilës ngritja e nivelt dhe cilsisë së arsimit, është kusht për përparimin të mirëfilltë në shekullin XXI, ku dhe u potenconte në dokumentet e saj. Në përgjithësi, dhjetëvjeçari i kaluar ishte dhjetëvjeçar në të cilin filloi procesi i profilizimit të partive politike të bllokut maqedonas, proces varet prej dias faktorëve, e në radhë të parë nga gjendja e përgjithëshme materiale dhe standardi jetësor i popullatës, niveli i kulturës, e sidomos kulturës politike të qytetarëve, demokratizimi i shoqërisë në përgjithësi, funksionimi i shtetit të së drejtës etj.²⁹

Paraqitja e partive politike shqiptare në Maqedoni, qoftë atyre që u shfaqen në fillim të vitetve nëntëdhjeta apo të periudhave të mëvonshme, nuk mund të trajtohet thjesht si rezultat i ndryshimeve në ish- Federatën Jugosllave. Shqiptaret e Maqedonisë e kuptuan organizimin politik e partiak të tyre si luftë të ideve dhe programeve, që nga ana tjetër ngrinte si domosdoshmëri trajtimin e çështjeve të veçanta në dobi të së përgjithshmës, shqiptaret po përballeshin me pasoja të konservatorizmit maqedonas, si shtet dhe komb. Momenti historik dhe gjendja politike impononin organizimin paralel politik të “shumicës së vogël” dhe “pakicës së madhe”³⁰ në ato momente mbi shqiptaret e rëndomt përgjegjësi politiko historike, me vetë faktin se ato ishin “çelsi” që hapte dyert e pluralizmit në Maqedoni. Dy partitë e para politike që artikullan interesat e popullatës shqiptare në Maqedoni në fillim të pluralizmit ishin: Partia për Prosperitet Demokratik dhe Partia Demokratike Popullore .

Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) u formua më 15 prill të vitit 1990, parti e cila depërtoi në të gjitha poret e shoqërisë shqiptare në Maqedoni dhe diasporë. Kjo parti rekrutoi në radhët e veta brenda një kohe të shkurtër një pjese të madhe të shqiptarëve të interesuar për lëvizjet politike në vend. Fillimisht për shqiptarët të kuptonin se partitë politike që nga momenti i prezentimit të kandidatëve për zgjedhjet aktuale me qëllim marrjen dhe ushtrimin e pushtetit shtetëror, gradualisht veçoheshin nga masa (antarsia) dhe vireshin në shërbim më të vogël që artikulonin përveç interesit të përgjithëshëm që proklamonte partia, edhe shumë interesa të tjera që shpeshherë superonin mbi interesin e përgjithëshëm. Në fillim të jetës pluraliste mendohej se një parti politike ishte e mjaftueshme

²⁹ Etem Aziri Partitë politike, zgjedhjet dhe sistemi zgjedhor Tetovë 2015;141

³⁰ Etem Aziri Organizimi politik i shqiptarve në Maqedoni Shkup 2004 ;82

për artikulumin e interesave të shqiptarëve në Maqedoni.³¹Krahas degëve dhe nëndegëve që nuk përbënin ndonjë problem të veçantë, u formuan edhe oligarkitë lokale, rajonale e qendrore, të cilat në mënyrë të pakuptueshme burokratizoheshin dhe mbyllishin në vetvete. Krahas tendencave tepër të sinqerta të popullit për një bashkim dhe mobilizim të mirëfilltë, brenda strukturave partiake të cilat tashmë kishin nuhatur “luksin e kolltukëve”zhvillohet një luftë e qetë, por mjaft e ashpër për pozicione drejtuese.³²Nga ana tjetër, ishte shumë e vështirë që në të njetën kohë shqiptarët të mbështesnin pluralizmin partiak brenda shtetit, ndërsa të vepronin kundër pluralizmit partiak brenda vetvetes, kështu që dy muaj pas formimit të PPD-së, në skenën politike të Maqedonisë u shfaq edhe një subjekt tjetër politik shqiptar, Partia Demokratike Popullore(PDP). Partia Demokratike Popullore- u themelua më 23 qershor të vitit 1990, me formimin e kësaj partie filloi jetësim i pluralizmit politik edhe ndër shqiptarët në Republikën e Maqedonisë. Pas formimit të PPD-së dhe PDP-së të cilat lirisht mund t’i quajmë dallëndyshet e pluralizmit shqiptar në Maqedoni, u shfaqën edhe disa parti të vogla të cilat nuk arriten të legjitimohen përpara zgjedhësve shqiptar, për periudhen para ripozicionimit të forcave politike shqiptare në Maqedoni do të përmendim vetëm Partinë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve në Maqedoni e cila la gjurmë të thella në organizimin politik dhe kaet zhvillimore të politikës efektive të shqiptarëve, parti e cila e cila ofroi politikë të re dhe për një kohë të shkurt rekrutoi në radhët e saj një numër të madh të anëtarve dhe simpatizuesve që ishin një garanci e fuqishme për ardhmëri e kësaj partie, kulmin e saj e arriti në zgjedhje lokale –vendore ku dhe nxorri nga loja partin politike Partinë Demokratike Popullore me të cilën më vonë do të bashkohet.³³Në fillim të mijëvjeçarit të tretë u formuan edhe dy parti politike me qëllim të artikulumit të interesave të popullatës shqipëtare në Maqedoni, Partia Demokratike Kombëtare dhe Bashkimi Demokratik për Integrim. Në fillim ishte shumë e vështirë të jepshin vlersime kompetente për arsyeshmërinë shoqërore dhe politike të formimit të PDK-së dhe BDI-së. Megjithatë me kalimin e kohës çdo gjë u kthjellua dhe BDI arsyetoi në tërësi themelimin dhe funksionimin e saj në ambientin pluralist të Republikës së Maqedonisë.

Partia Demokratike Kombëtare (PDK)-u formua në mars të vitit 2001 nga një grup aktivistësh të PPD-së dhe PDSH-së, iniciativa për themelimin e kësaj partie lindi nga një grup qytetarësh shqipëtar, të paknaqur me statusin juridiko politik të shqiptarëve këtu në Maqedoni, ku nuk ka barzi të plotë në shumë fushatë jetës. Bashkim Demokratik për Integrim(BDI)-ishte partia më e re e shqipëtareve në Maqedoni në fillim të mileniumit të ri, por jo edhe partia e fundit, BDI-ja u themelua si nevojë imediate

³¹ Eteme Aziri Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni Shkup 2004;83

³² Etem Aziri Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni Shkup 2004;84

³³ Etem Aziri Partitë politike zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore Tetovë 2015;144

pas zhvillimeve të vitit 2001, të cilat kishin qëllim ndryshimin e Kushtetutës së Maqedonisë, hapjen e rrugëve për kryerjen e reformave të brendshme shoqërore politike, pas kërkesave intensive të popullatës për nevojën e integritit të aktorëve kyç të këtyre ngjarjeve në jetën politike në vend, si dhe të ofronin garanci të plotë për realizimin e obligimeve të parashikuara në Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, si garanci për stabilizimin e plotë të gjendjes së pasluftës.³⁴ Ambiciet e kësaj partie ishin më të mëdha, vetë elita udhëheqese e partisë bëri disa herë publikime se BDI-ja do të formojë së shpejti struktura partiake në të gjithë territorin e Maqedonisë. Në Qershor vitin 2003 ndodhi procesi i bashkimit, ose thënë më saktë, shkrirjes së PDK-së në BDI, kjo shkrirje nuk ndodhi aty për aty dhe menjherë. Procesi i bisedimeve midis dy partive nuk ishte aq i lehtë përshkak të mospajtimeve programore. Pëderisa PDK-ja në mënyrë taksative angazhohej për federalizimin e Maqedonisë, BDI-ja qëndronte fuqishëm në pozicionin e implementimit të plotë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit ishte një kontakt që parandalonte fërkimet e mëtejme ndëretnike që do të shërbente edhe si rregullator për përmisimin e statusit politik, shoqëror dhe institucional të shqiptarve, në kuadër të shtetit multi-etnik, "si një garanci e sigurt për ardhmërinë e shqiptarve në Maqedoni".³⁵ Struktura e PDK-së bashkimit apo shkrirjen në BDI e arsyetonin në këtë mënyrë: Duke u nisur nga gjendja aktuale e PDK-së dhe dëshira e strukturave të kësaj partie që ndihmonin partinë shqiptare në pushtet, u arrit shkrirja e PDK-së në BDI, pa ndonjë kushtëzim të natyrës thelbësore.³⁶ Më qershor të viti 2003, liderë e të dy partive partive nënshkruan aktin solemn të shkrirjes së PDK-së në një subjekt të përbashkët BDI-në, me nënshkrimin e aktit solemn u bë e qartë se "në të ardhmen këto dy parti do të vepronin si një subjekt politik me statutin, platformën politike dhe simbolet e BDI-së. Ndërkohë lindën edhe dy parti shqiptare, por nuk arritën ndonjë sukses më të madh në jetën politike të vendit, duket se për një kohë të gjatë në hapsirën monavruese shqiptare në Maqedoni do të garojnë dy të parti të cilat krijuan pozita dominante, BDI dhe PDSH. Partitë që lindën në ndërkohë nuk patën një koncept të qartë si ti eliminojnë nga skena politike partitë politike tanimë dominante.

Pavarësisht se roli dhe rëndësia e partive politike në shoqëri është më se i qartë, përsëri parashtrohen shumë dilema? A është i saktë konstatimi se partitë politike janë çdoherë në shërbim të shoqërisë në R.Maqedoni?³⁷

³⁴ BDI Programi zgjedhor për zgjedhjet 2002

³⁵ Ylber Lili Maqedonia në darën e krizave Tetovë 2009;75

³⁶ Shkrirja e PDK-së në BDI e kundërshtoi dhe kontestoi i vetëmi deputet i kësaj Xhezair Shaqiri, për të cilin PDK-ja vazhdon të ekzistojë edhe më tutje.

³⁷ Etem Aziri Partitë politike zgjedhjet dhe sistemi zgjedhor ;183

Partitë politike shqipëtare në Maqedoni u formuan në kushte dhe rrethana specifike, prandaj dhe pikësynimet e tyre duhet analizuar në kontekstin e kushteve dhe rrethanave në të cilat ato vepronin dhe veprojnë. Këtu duhet të merret parasysh niveli i kulturës politike, demokratizimi i shoqërisë, funksionimi i shtetit ligjor, tendenca e përhershme e mosrespektimit të gjendjes aktuale në Maqedoni, në kontekst të imponimit të vullnetit politik të shumicës së vogël ndaj pakicës së madhe, tendenca për ndërtimin e një shtetit të ri mbi themelet dhe parimet e shtetit të vjetër etj. Dallimi ndërmjet partive shqipëtare të periudhave të më hershme ka më tepër taktik-strategjik duhet theksuar se çdoherë në pozita më të favorshme gjendeshin partitë opozitare shqipëtare që nuk ishin pjesë e qeverisë, duke ruajtur pozicionet e veta programore. Partitë shqipëtare që ishin pjesë e qeverisë, ishin të detyruar që më shumë ose më pak të pranonin konceptin qeveritar të zhvillimit të shtetit ,gjë që shpeshherë ishte në kundërshtim të drejtëpërdrejt me programin, platformën politike dhe dokumentet e tjera të saj. Një tjetër moment që vlen të potencohet është se, partitë politike shqipëtare do të ndiqnin rrugën parlamentare dhe metodat demokratike për realizimin e pikësynimeve të veta. Duke marrë parasysh nivelin e demokratizimit të vetë shoqërisë maqedonase dhe partive politike të bllokut maqedonas, rruga parlamentare dhe metodat demokratike ishin të barbara me votimin e përhershëm edhe për çështje më banale, duke mos folur më tej për çështjet e një rëndësie të veçantë. Mekanizmat e vetëm që kishin në disponim partitë politike shqipëtare një dhjetëvjeçar të tërë ishin: mosvotimi i ligjeve në parlament, braktisja e seancave parlamentare dhe shprehja e paknaqësisë nëpërmjet protestave në rrugë. Nga ana tjetër duhet shtuar edhe mosveprimi më efikas i partive politike shqiptare, sidomos në qoftë se marrim parasysh faktin se ato nuk ishin të gatëshëm të ndërmarrin hapa më radikalë, p.sh. të braktisin qeverinë dhe institucionet tjera të sistemit. Andaj lirisht mund të themi se partitë shqiptar nuk arritën kurrë t'i imponojnë qeverisë së Maqedonisë një pjesë minimale të programit të tyre, edhe në fazën e më hershme asnjë parti shqipëtare pjesëmarrës nuk ia arriti qëllimit të imponojë ndryshime të karkterit fundamental siç janë për shembull: ndryshimi kushtetues, parlamenti dydhomësh, demokraci konsensuale. Arritjet dhe rezultatet e partive politike shqiptare, pjesëmarrëse në Qeverinë e Maqedonisë, qëndronin pothuajse çdoherë në dimensionin e qytetarës dhe jo të kombëtares. Ndryshe diskutimi mund të shtrihet edhe mbi këto shembull, cila parti dhe me sa ministra, zëvendësministra, drejtorë e zëvendësdrejtorë mori pjesë në qeveri, sa punsime bëri dhe sa ndryshoi strukturën kombëtare në ministritë e ndryshme cila parti ia arriti qëllimit që me partnerët e kualicionit qeveritar të ndërmerr një projektligj mbi amnistinë etj.

Pa shfaqur tendenca nënçmimit arritjet, duhet të themi se brenda një dhjetëvjeçari nuk arrit të siguroheshin mekanizmat e domosdoshëm, me ndihmën e të cilave do të realizohej përparimi i

mirëfilltë i statusit të shqipëtarve në Maqedoni, me vetë këtë edhe jetsimi i tendencave të partive politike, të parashikuara në aktete e tyre normative. Ska dyshim se fajtor kryesor për një gjendje të tillë ishte vetë shteti Maqedonas dhe Kushtetuta e Maqedonisë, e cila u sollë në jetë dhe u miratua pa vullnetin e popullit shqiptar në Maqedoni. Megjithatë, nuk duhet harruar faktin se ka munguar, me ose pa qëllim, sensi dhe strategjia e partive politike shqiptare nuk kanë qenë të gatshme për çështjet me rëndësi të veçant kombëtare. Partia e cila bëhej pjesë e qevrisë, harronte shumë shpejt se me cilat vota ka fituar zgjedhjet dhe në shërbim të kujt duhej të jetë. Për fat të keq kjo praktikë nuk ka ndryshuar bindëshëm edhe sot.³⁸ Partitë politike që kohëve të fundit po përjetojnë një krizë për shkak të aftësive gjithnjë e më të vogla të strukurimit të interesave nga ana e partive, në mënyrë të tërthorët ndihmojnë në ndërtimin e një pushtetit të përgjeshëm dhe legjitim, koheve të fundit është gjithnjë e më e pranishme tendenca e deprofilizimit ideologjik të partive politike, me qëllim që ato të shëndrrohen në grupe shoqërore, siç janë:³⁹ p.sh problemet infrastrukturore, mbrojtja interesave të kategorive apo shtresave të caktuara shoqërore.

Në përgjithësi partitë politike shqiptare në Maqedoni në fillimet e veta u vën në shërbim të ideologjisë së formimit të një shteti të përbashkët të maqedonasve dhe shqiptarëve, edhe pse ishin të vetëdijshëm se nuk i dispononin mekanizmat e duhur për realizimin e kësaj ideologjike. Partitë politike dëshmuar, duke besuar më shumë sesa duhet në vlerat e demokracisë dhe duke harruar se politikisht duhet të luftonin me struktura politike me aftësi manipuluse, që arrijnë ta prezentojnë “të bardhën si të zezë dhe të zezën si të bardhë”. Partia për Prosperitet Demokratik, ajo pranoi integritetin teritorial të Maqedonisë, duke e trajtuar si shtet të maqedonasve, shqipëtarve, për PPD-në demokratizimin i jetës dhe marrdhënieve shoqërore –ekonomike kishte rëndësi të madhe, sepse vetëm njeriu i lirë mund t’i shfaqte aftësit krijuese, vlerat e tija materiale dhe shpirtërore, kjo parti vuri në qendër të vëmendjes së saj “qytetarin “si subjekt themelor të sistemit dhe angazhohej që çdo zgjidhje kushtetuese apo ligjore të mbronte së paku interesat jetësor të ti. Kjo parti në objektivat e programit të saj, pavarësisht se këto objektiva evoluuan në fazat e mëvonshme, angazhohej për arsimimin e qytetarve në gjuhën e tyre amtare në nivelin fillor dhe të mesëm, duke krijuar kushte edhe për arsimin të lartë.⁴⁰ Kjo parti e llogarite vete në grupin e partive qytetare: mjedisi shëndosh jetësor, emancipimi i femrës shqiptare, kthimi në vendlindje i të punësuarve jashtë vendit etj. Ajo çka e dallonte PDP-në si parti e dytë pas PPD-së ishte angazhimi i saj për realizimin e të drejtës për vetëvendosje të popullit shqiptar në hapsirën

³⁸ Etem Aziri Partitë politike zgjedhjet dhe sistemet zgjedhor Tetovë 2015;151

³⁹ Etem Aziri Partitë politike zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore Tetovë 2015;151

⁴⁰ PPD Programi zgjedhor, Tetor 1990

e ish Jugosllavisësi, si e drejtë e patjetërsueshme natyrore që i takon popullit. Gjithashtu PPD-ja Maqedonin e shihte si shtet demokratik dhe sovran të qytetarëve dhe popujve të barabartë. Partia për Prosperitet Demokratik Shqiptarëve në Maqedoni e konsideronte vetën në grupi e partive qytetare të qendrës dhe angazhohej për formimin e shtetit ligjor të Maqedonisë, me mekanizma përkatës që kontrollojnë pushtetin. Kjo parti angazhohej gjithashtu që në R.M “të aplikohet koncepti i demokracisë konsensuale me sistem parlamentar dy dhomësh”. Partia Demokratike Shqiptare- popullin shqipëtar e shihte si shtetformues, ndërsa përfaqsimi proporcional të kolektivitetve nacionale dhe decentralizimit e pushtetit, si proces që përputheshin me realitetin multi-etnik, multikulturor dhe multikonfesional të vendit. Në platformën e saj politike kjo parti thekson se shqipëtarve u garantohej të drejtat qytetare teknike si gjithkund në botë. Partia Demokratike Kombëtare arsyetoi themelimin e saj me pjesëmarrjen në jetën politike dhe ekonomike-shoqërore të vendit, me qëllim të përfaqësimit të interesave dhe mbrojtjes së të drejtave të shqipëtarve dhe qytetarëve tjerë, kjo parti angazhohej nëpërmjet Kushtetutës, që R.Maqedonisë të përcaktohet si shtet demokratik dhe multi-etnik i qytetarëve të barabartë. Gjithashtu kjo parti angazhoheshte për vullnetin politik të shqipëtarve, kishte si prioritet zyrtarizimin e UT-së, Partia Demokratike Kombëtare deri në momentin e shkrirjes së saj në BDI u qëndroi besnike qëdrimeve të saj të proklamuar në dokumentet partiake . Vlen të ceket se e vetmja parti politike shqipëtare e cila injoroi plotësisht që në fillim Marveshjen e Ohrit, duke deklaruar publikisht se kjo “Marveshje” asgjë të re në cilësi nuk do t’u ofronte shqipëtarve që përsëri do të mbeteshin të diskriminuar. Bashkimi Demokratik për Integrim me angazhimin e saj që në fillimet e veta energjin dhe potencialin moral e intelektual, në drejtim të implementimit të kësaj marveshje, synonte integrimin e plotë të shqiptarëve në të gjitha sferat e jetës shoqërore politike në Maqedoni. Veprimtaria e saj përqëndrohet në parandalimin e” paralelizmit dhe pengesave në baza etnike dhe territoriale “Në qeverisje me shtetin pikësynimin i BDI-së ishte afirmimi i idesë së partneritetit,”si parim politik i cili mundëson bashkëveprimin e grupeve të ndryshme me interesa të përbashkëta”. Komplexet mentaliteti i nënçmimit të vlerës vetijake dhe fuqisë politike që marrin nga **elektorati, trupi votues** paraqiten si bariera të ngritura nga vetë autorët e kësaj politike.

2.Roli i shoqëror i partive politike në Republikën e Maqedonisë shiquar nga këndvështrimi i tyre

Përkufizimi i partive politike është ngushtë i lidhur me statusin, funksionin dhe rolin e tyre në shoqëri. Sikurse çdo dukuri shoqërore, edhe partitë politike janë objekt inetruesimi dhe hulumtimi nga qarqet e ndryshme shkencore, si rezultat nga ky debat paraqitet një larmani në përkufizimin e partive politike në shoqëri. Partitë politike janë grupe të organizuara, të cilat kanë qëllimet e veta dhe në formë të përhershme i rregullojnë raportet në mes të anëtarve, duke i përcaktuar metodat e punës dhe vendosjen e raporteve me rrethin tyre.⁴¹ Sipas karakteristikave të ndryshme që ka çdo parti politike veçmas, përcaktohet edhe funksioni i saj në shoqëri, duke marrë parasysh kushtet dhe rrethanat e fushveprimit. Artikulimi i vetëdijes dhe i vullnetit politik manifestohet nëpërmjet të antarsisë së partisë politike që në çdo moment të ketë gatishmëri politike që të shprehë, definojë ose të caktojë qëndrimin e partisë politike për disa çështje dhe i njëjti të jetë në shërbim të pranisë në kontekstin social. Ato realizojnë qëllimet e tyre përmes pjesëmarrjes në fushatat ektorale, paraqitjes së kandidatëve dhe platformave për qeverisje, si dhe vënia në funksion të këtij qëllimi të strukturës së tyre organizative, antarsinë dhe të gjithë potencialet njerzore, **matriale** dhe **informative**.⁴²

Roli kryesor i partive politike është përfaqsimi, formulimi i qëllimit, shqiptimi dhe grumbullimi i interesit, shoqërorizimi dhe mobilizimi, formulimi i politikave publike udhëheqja ose kritika e qeveris, mbajtja e lidhjeve në mes individit dhe pushtetit.⁴³ Partitë politike parqesin bashkimin e lirë të qytetarve me qëndrime të njëjta, të cilët, për zgjidhjen e problemeve politike bëjnë propozime programore dhe parqesin kandidatë për mandate në parlament dhe për poste qeveritare, me qëllim që pas zgjedhjeve të suksesshme të zbatojnë atje në praktikë programin e tyre.⁴⁴ Qëllimi politik i çdo partie politike është për të fituar sa më shumë mandate parlamentare në mënyrë që të sigurojë shumicën e mundëshme për të qeverisur. Partitë politike shfaqen si lidhje vullnetare e qytetarëve, që besojnë në programe dhe ide të përbashkëta dhe përmes këtij organizimi ndikojnë në formimin e vullnetit politik dhe synojnë të ndikojnë në përfaqsim të shoqërisë-popullit, motivojnë dhe mobilizojnë shoqërin tregojnë forcën e partisë, theksojnë çështjet e rëndësishme.⁴⁵ Partitë politike në rolin e tyre shoqëror e përfshijnë aktivitetin e tyre në të gjitha fushat e jetës publike duke vepruar si grupe publike, legjitime që veprojnë legalisht dhe përpiqen të rritin ndikimin e tyre duke tërhequr pas vetës sa më shumë

⁴¹ Jonuz Abdullahi Politika dhe politikat publike Tetovë 2010;77

⁴² Afrim Krasniqi Partitë politike dhe sistemet politike Tiranë 2008;38

⁴³ Andrew Heywood Politika Prishtinë 2008;233

⁴⁴ Hans –Helmuth KnÜtter “Demokratie” Informationen zur politischen Bildung, Neudruck 1992;165

⁴⁵ Afrim Krasniqi Historia, roli, organizimi, modelet, dhe tiparet e partive dhe sistemeve politike Tiranë 2008;40

qytetarë/votues . Procesi i formimit të vullnetit politik është i gjatë dhe kompleks,i lidhurë me shumë faktorë tjerë dhe që kërkojnë një sistem partish aktive, të organizuara dhe me aftësi konkurruese. Përcaktimi i partive për pjesmarrje të rregullt të zgjedhje me kandidatët dhe programet e tyre politike përmes këtij procesi partitë bëhen pjesë e përfaqsimi të vullnetit politikë të qytetarëve dhe alternativa e tyre shëndrrohet në alternativë legjitime me përgjegjshi përpara një elektorati të caktuar që e ka votuar. Ky kriter nuk i detyron partitë vetëm të fitojë me çdo kusht mandate parlamentare apo lokale,por e detyron atë të priret drejt konkurrimit me kandidatët e vet. Vlersimi i partive politike si bashkësi e lirë dhe e organizuar e qytetrëve-parimi i anëtarësimit është individual dhe ka për qëllim ruajtjen e raporteve midis partisë dhe komunitetit qytetar . Nëse anëtarët të partisë do të ishin të gjithë anëtarët e komunitetit, atëher nuk mund të flitej për sistem shumpartiak, por për shfaqjen më ekstereme të modelit parti e gjithë popullit. Ekzistenca e shumë partive politike nënkupton shpërndarjen e elektoratit midis shumë partive politike. Gara e partive për vende parlamentare dhe njësi vendore nënkupton faktin se numri i anëtarëve të partive politike është gjithënjë më i vogël sesa i votuesve, prandaj edhe në zgjedhje nuk ka asnjëherë pjesëmarrje 100% të votuesve.⁴⁶Ruajtja e një organizimi të lirë dhe aktiv i bën partitë më të afëta të luftojnë për të fituar mbështetjen e qytetarëve. Organizimi një nga synimet e edukimit politik, ose të paktën, e agjitpropit dhe indoktrinimit, është t'i bindë njerzit të identifikohen me organizata të veçanta dhe të punojnë për to. Organizimi në vetevet, është një veprimtari më specifike, që i bënë njerzit aktualisht të regjistrohen, të mbajnë kartën e antarsisë, të pranojnë një disiplinë, të paguajnë detyrimet e tyre dhe të mësojnë të veprojnë sipas një skenari që nuk e shkruajnë vetë.⁴⁷"Bashkimi na bën të fortë"që sipas partive politike pasqyron mazhoritarizmin e demokracisë që nxit shoqërizimin dhe kombinimin.⁴⁸ Çështja e mobilizimit demokratik nuk është të sulmosh zyrat e qeverisë dhe të marrësh pushtetin, por të demonstrosht forcën personale, forcën numerike dhe doktrinën bindëse, që janë të gjitha vendimtare për forcën popullore. Pra, marshimi ose parada, mitingjet e partisë, pllakatet dhe flamujt, thirrjet e pjesmarrësve, oratoria e udhëheqësve dhe duartrokitjet e zjarra janë pjesë e saj. Këtu nuk ka vend për përsiatje të qetë, sepse ai do t'i tregonte botës forcën e shqetsimit të këtyre njerzve, anagazhimit dhe solidariteti e tyre të zjarrtë, vendosmërinë për të arritur një rezultat të caktuar politik. Partitë politike duan që të paraqiten përpara opinionit publik, se ato zhvillojnë aktivitete legal dhe të jenë transparente përpara qytetarve –partitë që refuzojnë jetën publike dhe veprojnë në ilegalitet nuk mund të quhen më të tilla,

⁴⁶ Afrim Krasniqi Partitë politike dhe sistemet politike Tiranë 2008;39

⁴⁷ Michael Walzer Politika dhe Pasioni drejtë një Liberalizimi egalitar;119;120

⁴⁸ Michael Walzer Politika dhe Pasioni drejtë një liberalizimi më egalitar;120

që rrezikon jetë e drejtuesve të saj.⁴⁹ Qëllimi i tyre është të japin një mesazh, herë më të përgjithshëm për bashkëqytetarët, herë më të hollësishëm për një elitë të mbyllur, mesazhi është i tillë; Ja ku jemi, kjo është ajo që besojmë se duhet bërë dhe nuk e besojmë rastisist, nuk është një opinion sondazhesh, nuk është një gjë që e mendojmë sot dhe mund të mos e mendojmë nesër, ne do të vazhdojmë të realizojm atë që premtojmë, dhe nëse ju doni të vazhdoni me politikën e zakonshme, është më mirë të mendoni kur votoni, partitë politike kanë për qëllim të bindin shoqërinë se ky qëndrim është më i mirë se çdo alternativ tjetër.⁵⁰ Pjesëmarrja në fushatë duke e par se politika e përzgjedhur është ajo që plotëson numrin më të madh të interesave shoqëror ose më mirë që plotëson pikërisht ato interesa që qëndrojnë politikisht, partitë politike imagjinojnë që të argumentojnë se si t'i shërbejnë të mirës së përgjithshme mbi dhe përtej të gjitha interesave të veçanta, duke marr parasysh detyrimin që duhet t'u shërbehet edhe interesave të veçanta. Partitë politike, subjektet politike janë udhëheqës që mbajnë barrën e zhvillimit të fushatës, që kërkojnë votat e bashkëqytetarëve të tyre duke bërë premtime, duke u përpjekur të duken të besueshëm dhe të tregojnë se kundërshtarët janë të pabesueshëm. Duke e par votimin si të rëndësishm gjatë proceseve zgjedhore (fushatave zgjedhore) dhe se qytetarët dëgjojnë argumentete që jepen nga kandidatët të ndryshëm dhe platformat e partive dhe se ata mendojnë për pasojat e fitorës së këtij apo atij kandidati jo vetëm për vetën e tyre por edhe grupet e ndryshme që u përkasin dhe për gjithë vendin, partitë politike nëpërmjet mobilizimit të pasioneve dhe interesave detyron shoqërinë të mendojë çfarë është varfëria? çfarë është korrupsioni? çfarë është shfrytëzimi i mjeteve parave nga taksapaguesit? (vetëm përshkak të mobilizimit të shoqërisë).⁵¹ Prandaj një kandidatë që premtonte të ulë papunësin mund të tërheqë interesimin e nxituar të personit që është pa punë, që frikësohen nga papunsia. Në fakt ky është një rezultat i rëndësishëm dhe plotësisht i ligjshëm i karizmës së tij, që i bën partitë politike të zbulojnë se sa njerëz kanë këto interesa të veçanta dhe t'u japin" përparsi të madhe. Nga kjo që u tha në përgjithsi mbi rolin e shoqëror të partive politike rrjedh se partitë politike edhe në Republikën e Maqedonisë janë grupe shoqërore të cilat e arsyetojnë ekzistencën e tyre nëpërmjet luftës së përhershme politike për marrjen dhe ushtrimin e pushtetit shtetëror dhe në këtë kontekst, realizimin e pikësynimeve kryesore të parashikuara në dokumentetet partiake, para së gjithash në statut program, platformë politike etj. Për të ushtruar me sukses këtë rol të rëndësishëm shoqëror, ato kanë nevojë për mbështetje të gjërë qytetare. Në këtë aspekt partitë politike luajnë me sukses rolin e një instrumenti që siguron një komunikim të domosdoshëm ndërmjet

⁴⁹ Afrim Krasniqi Historia e roli, organizimi, modelet dhe tiparet e partive dhe sistemeve politike Tiranë 2008 ;40

⁵⁰ Michael Walzer To ward a more egalitarian liberalism Copyright by Michael Walzer, Politika dhe pasioni drejt një liberalizimi më egalitar përktheu Merita Kociu (Pino) Tiranë 2005;122

⁵¹ Po aty Michel Walzer Politika dhe pasioni drejt një liberalizimi më egalitar;127

aparatis të pushtetit publik dhe shoqërisë, qytetarve, ose thënë ndryshe, shtetit dhe shoqërisë civile. Partitë politike luajnë rol shumë herë kompleks sesa kaq, ato gjejnë lidhjen e përbashkët ndërmjet interesave të shumta, duke u bashkuar interesat më të gjërë dhe radhitjen e tyre sipas prioriteteve. Me qenë se zgjedhjet kanë rëndësi të veçant për çdo parti politike –subjektet politike që marrin pjesë në garat zgjedhore, kapjen e votuesve, motoja e partive politike është që me më shumë votues merr frym më lehtë dhe zakonisht jetojnë në “ethet zgjedhore” aq më shumë qoftë se merret parasysh edhe dukuria e zgjedhjeve të parakohëshme, partitë politike me qëllim përfitimit të elektoratit më të gjërë, përpilojnë programe zgjedhore heterogjene duke përfshirë në to çështje të ndryshme me interes për shoqërinë. Pra si pikënisje apo aktivitet bazë i partive politike është artikulimi dhe grupimi i interesave të ndryshme shoqërore, duke iu dhënë atyre formën e kërkesave politike.⁵² Duke kërkuar pushtetin përmes zgjedhjeve qofshin parlamentare, presidenciale, vendore-lokale rolin shoqëror e shohin si të rëndësishëm mundohen të shkundojnë iniferencën qytetare, si dhe nxitja e vetë partive politike, nxit kandidatët për hartimin e platformave konkrete të zhvillimit, si dhe forcimin e sistemit shumëpartiak. Zgjedhjet e viteve të fundit në Republikën e Maqedonisë u përqëndruan më shumë në betejën e premtimeve konkrete, në strategjinë e reformave dhe zhvillimit të shtetit, në problemet e infrastrukturës, zhvillimin e rrugëve rajonale e lokale, integrimi në strukturat euroatlantike e BE, hapjen e vendeve të reja të punës, zhvillimin kulturor, investimin në shtetë etj.⁵³ Partitë politike në Republikën e Maqedonisë, në prag të fushatave zgjedhore angazhohen në ambient social kur popullata në masë të madhe i përshkruhet papunsia izolimi, zhvillimi i dobët ekonomik, zhvillimi i dobët infrastrukturor i zonave rurale, pozicionet në qeverisje dhe përpjekjet që partia e tyre të hyjë në qeveri atëherë është *conditio sine qua non*⁵⁴ mos rrugdalje e qytetarve nga kjo gjendje e zakonshme mosprania –mosekzistimi i ndonjë partie tjetër angazhon partitë politike që të shkojnë ti vizitojnë këtë zonë të prekura nga problemet e lart përmendura dhe i shtyn nën ombrellën e tyre partiake. Kandidatët që përpiqen të shpjegojnë sesi pozicioni i tyre mbi një çështje të caktuar është në përputhje me pozicionin e votuesve kanë prijen të fitojnë më shumë mbështetje sesa kandidatët që nuk angazhohen në një gjë të tillë.⁵⁵ Në bilancin e punës së partive politike të pozitës krahas aspekteve kritike të tyre (nga ana e partive të opozitës, dhe qytetarëve shoqëria) partitë të pozitës duke e parë se arrijtjet e tyre

⁵² Etem Aziri Partitë politike zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore Tetovë 2015;329

⁵³ Analiza nga platformat e partive politike në R.M. VMRO-DPMNE, SDSM, PDSH dhe BDI, të shfaqura gjatë periudhave zgjedhore (2006, 2008, 2014, 2016)

⁵⁴ Shteti i së drejtës dhe reformat në Administratën publike Rasti i Maqedonisë, përmbledhje kumtesash shkencore, redaktorë :Etem Aziri, Jonuz Abdullahi, Ali Pajazit, Memet Memeti, Tetovë 2008

⁵⁵ Hyrje në Psikologji politike Matha-Cottam Beth-Dieftz-Uhler- Elena M. Mastors-Thomas Prefston Tiranë, Qershor 2009;145

zën vend të rëndësishëm, nxitin nënshkrimin e marrveshjeve për zgjidhje politike konsensuale të krizave politike, për hirë të interesave elektorale dhe politike, ato mundohen të bëhen urë lidhëse aktive midis problemeve të qytetarve dhe institucioneve politike, dhe se pa këto arritje do të ishte e pamundur që shoqëria, institucionet dhe debati politik të arrinin nivelet të **emancipimit dhe të demokratizimit**.⁵⁶ Pjesë e rëndësishme e partive politike janë fushatat elektorale edhe atë harmonizimi i mitingjeve publike me fjalime të zjarra politike, me takime në bazë apo daljet në debatet televizive. Të gjithë kandidatët hartojnë dhe shpërndajnë mijëra kopje të fletpalosjeve të tyre si dhe mbushin sheshet publike me portretin e tyre, ku shënohet edhe slogani i tij elektorale. Në fazën finale të fushatës është thelbësore drejtimi i një mesazhi besnik dhe konfidencial të partisë dhe të kandidatëve të saj për deputetë, përmes të cilit ata i drejtohen çdo qytetari me kërkesën për ta votuar, duke i përmendur premtimet e tij kryesore dhe duke i dhënë detaje për ditën e votimit, vendin e votimit, numërin e tij në listën emërore dhe vendin e kandidatit në listën e votimit. Partitë politike ju drejtohen masës me fjalët më të mira gjatë fushatave zgjedhore me të vetmin qëllim se ata po angazhohen drejt përmisimit të gjendjes shtetërore. “Edhe ne e dimë se një ëndërr nuk bëhet realitet me magji, me fjalë boshe, por që një ëndërr të realizohet, duhet djersë, punë e rëndë e lodhëshme dhe vendosmëri, vendosmëri dhe përkushtimi, për të arritur sukses, Të arrihet sukses për të mirën qytetare dhe shtetin”.⁵⁷ Në prag të zgjedhjeve partitë politike në R.M u drejtohen masave të gjëra me fjalët të ëmbla, plot premtime duke prezantuar plane nga platformat e programet e tyre politike, ekonomike dhe ide të mëdha për një të ardhme më të mirë në shtet barazi politike dhe qytetare, shtete shumetnik dhe shoqëri qytetare, demokraci konsensuale, bashkëqeverisje, përfaqsim i drejtë dhe adekuat, përdorimi zyrtar i gjuhës “shqipe”, menaxhim i drejtë dhe transparent me financat publike, rend dhe sundim të ligjit, zhvillim lokal dhe rajonal i balansuar,⁵⁸ me mundësi të njetë për të gjithë qytetarët, punë të jashtme dhe integritet evropian, reforma në teknologjinë informative dhe administratë publike, ministria e jashtme në shërbim të qytetarve, vend për paqë siguri dhe drejtësi mbrojtje dhe siguri për çdo qytetar, turizëm, kultur, artë resurse njerzore dhe kohezion shoqëror, politikë sociale, kulturë, rini dhe sport, media dhe shoqëri civile.⁵⁹ Partitë e pozitës në Maqedoni zakonisht shoqërinë informon për sukseset e tyre në qeverisje fillojnë nga pikat e forta “të tyre. Punuam, të arrim deri diku, punuamë mbi bazë të programit, realizuamë prej tij sa më shpejt atë që mundem. Premtojmë dhe realizojmë, punojmë t’ju

⁵⁶ Afrim Krasniqi Partitë politike Tiranë 2006;289

⁵⁷ Mahi Nesimi Dhunimi i vullnetit zgjedhjet parlamentare 2008, Tetovë 2009 ;69

⁵⁸ Platforma e Bashkimi Demokrtatik për Integritet ,Platforma 2020 Programi zgjedhor,zgjedhjet parlamentare 2016”Bashkë vendosim”

⁵⁹ Platforma e VMRO-DPMNE -së, Realno programa na VMRO-DPMNE 2017-2020 Rabota,sigurnost,napredok “Za tebe za Makedonija “ faqe198;254;282;294;306;430

dëshmojmë qytetarëve se jemi të vetëdijshëm dhe e dim se jemi në pushtet për qytetarët, dëgjojmë zërin e popullit, do të jemi qeveri e popullit dhe qeveri e shtetit qeveri e cila kujdeset dhe e cila ndihmon sa mundet. Dy mandate punuam me elan të madh, me dëshirë, me motiv, me mendim të pastër, me nder përkushtimi dhe përgjegjsi ditë e natë pa u ndalur. Punuam të vetëdijshëm se atë që kemi premtuar, patjetër e kemi që ta realizojmë, me mendim dhe besim se atë që e flasim gjatë fushatës mitingje, në takime me qytetarët, duke i shikuar në sy "patjetër" e kemi ta realizojmë, punuam në arsimim me një numër të madh masash, të cilat duhet të përmisojnë cilsin e arsimimit dhe të procesit arsimor të vetëdijshëm se dituria është fuqi dhe influencë, që askush nuk mund të na e marrë.⁶⁰ Vendosëm një varg reformash në shëndetsi aty ku me vite kan ngecur punët dhe ka një numër të madh problemesh, prap se prap ne fort u angazhuam dhe vendosëm një varg reformash dhe masash të cilat shëndetsi duhet ta bëjnë më cilësore dhe të sjellin kushte më të mira për pacientët. Kujdes të veçant i dhamë dhe i përkushtuam zhvillimit të shoqërisë informative, procesit të kompjuterizmit shkollor, instalimi i kompjuterëve nga shkolla në shkollë transportit telekomunikacionit.⁶¹ Punuam një pjesë të decentralizimit, në aplikimin e Marveshjesë Kornizë të Ohërit duke mbajtur llogari për bashkësit etnike, të shqipëtarve, turqëve romëve, vllehëve, sërbeve, boshnjakëve, për ardhëmërinë e tyre në R.Maqedonisë. Partitë politike të opozitës në Republikën e Maqedonisë për një periudhë të caktuar kohore të paktën katër vjeçare, iu del si detyrë të ndjekin veprimtarinë e pozitës politike, të kontrollojnë aktivitetet e saj dhe kohë pas kohe të luajnë rol kritik ndaj politikave të qeverisë, me tendencë që të bindin opinionin publik, shoqërinë t'ju japin votëbesimin në zgjedhjet e radhës, përpjekja e tyre për të arritur në pushtet, gjithë fuqin e tyre politik përqëndron tek shoqëria, duke ndërmarr aktivitete të ndryshme edukative dhe informative për shoqërinë edhe atë duke filluar nga lëshimet dhe keqpërdorimet e partive të pozitës gjatë qeverisjes, kërkojnë votat e bashkëqytetarve të tyre duke bërë premtime, përpjekjen të duken të besushëm dhe të tregojnë se oponentët janë të pabesueshëm. Të nderuar qytetarë neve na duhet një mandat i ri që të mund më shpejt t'i sjellim reformat dhe më shpejt t'i sjellim ligjet, të cilat duhet të sjellin jetesë më të mirë për qytetarët, sistemin e taksave, ndryshime, zvoglimin e papunsisë-varfërisë, premtojmë dhe do të realizojmë 64.000 vende të reja të punës, shëndet publik kualitativ, shërbime cilësor për të gjithë qytetarët, qeverisje transparente, energji të re për në Nato e BE, paga të larta për të punsuarit, investime në shtet në dobi të qytetarve të cilët do të ndihmojnë në arritjen më të shpejtë të standardeve të anëtarëve të Bashkimit Evropian, me shumicë të fuqishme, me kushte më të mira për punë me parlament i cili do të

⁶⁰ Mahi Nesimi Dhunimi i vullnetit zgjedhjet parlamentare 2008, Tetovë 2009;71;72,

⁶¹ Po aty ,Luftojmë për mëngjesin e ri për shkak se ardhëmi fillon tani zgjedhjet parlamentare 2008;73

debatojë, i cili do të jetë përfaqësues i vullnetit të qytetarëve dhe përfaqësues i shtyllë e demokracisë.⁶² Shumë dëshprime ka duruar ky popull në vitet e kaluara, shumë mashtrime, shumë demagogji, intriga politike, skenarë, lojra, shumë ngjarje të pa pastra, tranzicioni i keq e tej i zgjatur dhe kriminel, papunsia e madhe, kriza politike, financiare-ekonomike, sigurie. Ne dojmë ta ndryshojmë, të tregojmë se mund të na besoni dëshirojmë ti ndryshojmë stereotipet për politikanët se shumë premtojnë pak punojnë se vetëm flasin dhe shumë kënaqen. Fuqimisht do të hymë në luftë kundër kriminalitetit, dhe korrupsionit, të vetëdijshëm se tërë e keqja për mospajtimin e deri tanishëm të shtetit tonë vjen pikërisht nga ky problem që ka keqeverisë kjo parti në pushtet, për shkak të faktit se shumë politikanë, ministra, drejtorë, funksionar, zyrtarë dhe të tjerë kanë keqpërdorur pozitën dhe ligjet, do të hymë me zero tolerancë për korrupsionin, luftë me secilin që merret me korrupsion dhe kriminalitet pa dallime të përkatsisë partiake apo etnike, angazhim për strategjinë e integrimeve euroatlantike, amnisti fiskale për popullatën shqiptare vendimëmarje konsensuale, përmisimi i statusit shqiptar, tashmë është e sigurt se nuk ka gjasa që shqiptarët zhduken nga këto hapsiara, ashtu si imagjinojnë disa politikanë, është e sigurt se shqipëtarët nuk do të heqin dorë nga kërkesa që të jenë të barabartë në shoqëri, nga kërkesa që sistemi t'u ofrojë oportunitete të njëta të gjithë qytetarëve.⁶³ Politikën sociale do të jenë në qendër të vëmendjes të programit tonë zgjedhor. Këto parti shkojnë aq larg sa që "ndërmarin "edhe aktivitete të ndryshme për edukimin ideopolitik të qytetarëve dhe antarsis së gjërë, që shoqëria e aftë dhe ideopolitike të "edukuar" të mund të marrë në duart e veta fatin e saj, nga ana tjetër me ndihmën e mekanizmave partiak, krijojnë opinionin se "fati i shoqërisë është në duart e partisë që qeverisë dhe se partia e udhëheqja e saj janë të pagabueshme". Praktika plurale në Maqedoni reklamojnë me të madhe barazi të madhe të qytetarëve e sidomos garantimin e të drejtave të pakicave kombëtare në vende ku bashkësit e vogla etnike kanë një numër joshës të votave, me të vetmin qëllim që të fitojnë përkrahjen politike të tyre. **Emancipimin e trupit votues** -të shoqërisë, partitë politike e shohin si çështje parësore në mendjet e tyre, kjo është një punë e lodhshme, por zakonisht jep rezultate afatgjata.⁶⁴

⁶² Platforma e SDSM-së ,zgjedhjet parlamentare 2016,Platforma na Social Demokratski Sojuz na Makedonija Promena za podobar zhivot "Imam plan za zhivot vo Makedonija" faqe 7;13;17

⁶³Platforma e PDSH-së për periudhën 2016-2020, Ecim drejt(zgjedhjet parlamentare 2016)faqe22;14

⁶⁴ Etem Aziri Partitë politike,zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore Tetovë 2015;414

3. Interesimi (mos interesimi) i elitave partiake për informim sa më të drejtë të qytetarve dhe antarsisë së gjërë mbi proceset e politikbërjes

Media kryen funksionin e pushtetit të katërt pas atij ekzekutiv, legjislativ dhe juridik, në demokracinë e sotme qytetarët i shprehin mendimet e shqetsimet e tyre në forma nga më të ndryshmet dhe media është institucioni më i preferuar dhe i larmishëm që mundëson këtë, mediat përcjellin informacion dhe mendime.⁶⁵ Partitë politike dhe mediat kanë një raport të veçantë, pasi ekzistenca, veprimtaria dhe konkurenca e partive politike nuk mund të imagjinohet pa median. Informojnë qytetarët, ndihmojnë në formimin e opinionit publik, imponojnë agjenda politike dhe marrin pjesë direkte në vendimmarrjen e politike. Pushteti i tyre vjen në rritje, ndërkohë që e tillë është edhe tendenca e partive politike dhe aktorëve të tjerë publikë e shoqërorë për të krijuar marrëdhënie të afërta bashkëpunimi me pushtetin mediatik.⁶⁶ Funksioni bazë i medias është informimi i qytetarëve dhe krijimi përmes informimit të opinionit publik. Në një shoqëri demokratike mediat kontrollojnë punën e qeverisë, ndikojnë në rritjen e transparencës së vendimmarrjes dhe aktivitetit të saj, monitorojnë zbatimin e ligjit dhe janë shprehje e mendimit dhe opinioneve qytetare ndaj pushtetit politik. Mediat nxisin pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrje, ndikojnë në rritjen e interesit të qytetarëve për shtetin dhe komunitetin, duke kryer kështu një funksion edukues për ligjin, etikën dhe komunikimin. Komunikimi politik është një proces që ka të bëjë me transmetimin e informatave mes politikanëve, mediave të lajmeve dhe publikut, procesi operon prej lartë poshtë, do të thotë prej institucioneve qeveritare e deri te qytetarët, ndërsa në horizontalisht përfshin vepruesit politik, dhe anasjelltas nga opinioni publik e deri te autoritetet, qëllimi i komunikimit politik është shënuar si bindje, dhe qëllimi i kësaj bindje është audiencia. Për partitë politike funksioni i lartëpërmendur varet kryesisht nga aftësia e tyre për të komunikuar me votuesit dhe ata persona që do t'i legjitimizojnë ata, funksioni komunikues-transmetim të urdhërave, shpjegimeve dhe informatave nga organet e qeverisë tek qytetari.⁶⁷ Deri vonë e drejta e votës i takonte një elite me numër të kufizuar dhe komunikimi që përdorej ishte ai interpersonal, por tani kur e drejta i takon masave të gjëra të njerëzve edhe komunikimi bëhet me anë të mas –mediave, ka shumë strategji dhe taktika komunikimi që janë zhvilluar kohëve të fundit. Partitë politike masin suksesin e tyre jo në profit, por në numër të votuesve, si dhe shpërndarjes së fuqisë, marketingu politik ngërthen parime të

⁶⁵ Kaval-Mellbye-Tranoy Politikk Og Makt, Politika dhe demokracia përktheu Ermir Pulaha Onufri Tiranë 2006;105

⁶⁶ Afrim Krasniqi Historia roli organizim i modelet dhe tiparet e partive dhe sistemeve politike Tiranë 2008;79;80;81

⁶⁷ Sipas Guy Hermet, marrë nga Rolf Frankerberger, Patricia Graf: Elections, Democratic Regression and Transitions to Autocracy: Lessons from Russia and Venezuela”, në Gero Erdmann (Ed), Marianne Kneuer (Ed): Regression of Democracy, VS Verlag 2011, 205

aplikuara edhe nga prodhuesit e prodhimeve dhe shërbimeve.⁶⁸ Politikat e posaçme mund të përdoren si reklamim i mesazheve, theksim të pikave të veçanta të shitjes së partisë. Media është e rëndësishme për procesin politik, përfundimisht, si transmetues i mesazhve nga qytetarët deri te liderët politik. Në mbulimin e anketave për opinione publike, media mund të konsiderohet se prezanton mendimin e publikut që merr statusin e diçka real e për të kuptuar dhe vlerësuar situatën politike, shpesh në kuptimin kritikave dhe tërheqjes së vëmendjes së politikanëve (elitave politike). Në këtë mënyrë mendimet e qytetarëve komunikohen shpesh me vëzhgime të sjelljes së partisë. Poashtu politikat mund të kontribuojnë në debate të përgjithëshme, ndonjëherë madje të zgjedhura edhe nga partitë tjera. Në këto mënyra të ndryshme, së bashku me shënimet e partisë në qeveri, kualitetet, sjellja e njerëzve të partisë dhe prezantimi i tyre përmes mediave, politikat partiake formojnë pjesë të kaleidoskopit të përshtypjeve që së bashku formojnë imazhin e përgjithëshëm të partisë në mendjen e elektoratit.⁶⁹ Spotet televizive janë pjesë thelbësore e fushatës së edukimit zgjedhor, ky element luan rolin më aktiv për të komunikuar me gjithë votuesit që kanë të drejtën e votës, duke krijuar mundësi që jo vetëm të informohen në lidhje me zgjedhjet që do të zhvillohen, por t'u bëhet thirrje për të marrë pjesë në votime, por mbi të gjitha për t'u krijuar mundësinë që të njohin mënyrën e rregullt të votimit në tërësi. Tani emisionet televizive janë përplot debate publike, në cilën pjesëmarrësit e publikut sillen në një vend për të diskutuar çështjet më të rëndësishme politike dhe të shfaqin mendimin e tyre për ta. Problemi kyç në deklarimin e thelbit të lidershit është identifikimi i relacionit **liderë-qytetar**, deri më tani janë bërë përpjekje të shumta që analizohet kundërtënia e këtij relacioni por, tani për tani pa ndonjë sukses të veçantë. Lidhshmëria midis liderëve dhe qytetarëve në shoqërinë demokratike është: liderët ndikojnë me vendimet e tyre ndaj zgjedhësve (pra udhëheqin), por gjithashtu edhe u përgjigjen preferencave të zgjedhësve (pra janë të udhëhequr).⁷⁰ Partitë politike janë përgjegjëse për strukturën e funksionimit të qeverisë, me anëtarët e tyre ato i plotësojnë pozitat udhëheqëse. Qeveria dhe administrata e saj ushtron kompetenca të përditëshme në shërbim të qytetarëve, por fakti që në qeveri dhe në postet drejtuese të administratës delegohen anëtarët të partive politike fituese në zgjedhjet, do të thotë se vetë partitë marrin përgjegjësi në ushtrimin e funksionit të qeverisjes dhe të shërbimit ndaj qytetarëve. Ato kanë potencial për të qeverisur, përdorimin programin e tyre politik për të fituar votat e zgjedhësve.⁷¹ Në të gjitha rrethanat partitë drejtohen nga personat të caktuar, të cilët në rastin e fitores elektorale marrin përgjegjësi për drejtimin e ekzekutivit dhe të jetë parlamentare. Si pjesë e parlamentit

⁶⁸ Veton Latifi Politikologjia Tetovë 2008;470

⁶⁹ Veton Latifi Politikologjia Tetovë 2008;381

⁷⁰ Veton Latifi Lider shipi politik Tetovë 2009;31

⁷¹ Afrim Krasniqi Partitë politike dhe sistemet politike Tiranë 2008;49

partitë marrin pjesë aktive në përmbushjen e funksioneve bazë siç janë hartimi i ligjeve, përfaqsimi i interesave, kontrolli i qeverisjes. Informimi i drejtë dhe i gjërë, cilsor, i shpejtë dhe efikas ka një rëndësi të veçantë për funksionimin e shoqërisë, informimi gjithë përfshirës i vërtet dhe në kohë është një nga parakushtet më të rëndësishme të demokracisë bashkëkohore, pa sistem të informimit as që do të mund të funksionon shoqëri demokratike. Përmes sistemit të informimit qytetarve u mundësohet të kenë qasje si ushtrojnë elitat politike pozicionet-pushtetin e legjitimuar nga ana e tyre – votuesve.⁷²Opinion i gjërë politik është shprehje e vetëdijes kolektive të një shoqërie demokratike në lidhje me ndonjë ndodhi, çështje të rëndësishme politike ose ndodhi tjetër, pra mund të bëhet fjalë për ndonjë vendim politik konkret. Në formimin e opinionit publik ndikon faktori “partitë politike”, sa më i shprehur që është roli i opinionit publik në kornizat e sistemit politik, aq më këmbëngulëse janë tendecat e elitës udhëheqëse politike, që ta kenë nën kontroll dhe ta shfrytëzojnë për qëllimet e veta, gjë e cila nuk është e lehtë, sidomos kur opinion i publik krijohet në mënyrë spontane dhe nga revolti ndaj një aktiviteti të pamatur të përfaqësuesit legjitim të tij –elitës udhëheqëse politike.⁷³

E drejta qytetarëve për të marrë pjesë drejtëpërdrejt në proceset e vendimarrjes parashihet në më tepër dispozita të Kushtetutës së R.Maqedonisë. Liria e informimit është një nga të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit e përcaktuar me Kushtetutën e Maqedonisë (neni 16)dhe qytetarve u garantohej qasje në marrjen e informacioneve. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë iu siguron qytetarve të drejtën e qeverisjes nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur “elitave politike”që ata nëpërmejt pjesëmarrjes ndikojnë në aprovimin e vendimeve me karakter publik, të rëndësishme për opinionin, vendime të cilat kanë ndikim në jetën e tyre dhe të qytetarve.⁷⁴Që të përfshihen qytetarët në proceset e krijimit të politikave dhe sjelljeve e vendimeve është shumë e rëndësishme që të informohen mirë për gjendjen dhe aktivitetet e vetëqeverisjes lokale. Përfshirja, patjetër duhet të ketë për qëllim të jep kontribut në zgjidhjet cilësore, të arrihet ndryshim i caktuar ose të veprohet në përmisimin e ndonjë gjendjeje konkrete.⁷⁵Qytetarët në zgjedhjet e lira i zgjedhin përfaqësuesit e tyre në pushtetin lokal, që ata më tutje të vendosin dhe të veprojnë në emër dhe në interes të qytetarëve që i kanë votuar. Kjo nuk i përjashton nga mundësia që ato të informohen, konsultohen dhe të përfshihen drejtëpërdrejt në

⁷² Etem Aziri Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë Formimi,sfidat dhe prespektivat e zhvillimit demokratik Tetovë 2012;31

⁷³ Etem Aziri Sistemet politike Tetovë 2012;43

⁷⁴ Përfaqsimi dhe Pjesëmarrja Politike në Maqedon, Instituti për Demokraci dhe Zhvillim Tetovë 2010;72

⁷⁵ Venco Popovski,Ivan Stefanoski,Marijana Sokolovska,Darko Aleksov dhe Rosana Alekoska me mbështetje të mirë të mr.Sllavica Biljarska,prof.dr. Mirjana Borota,prof.dr.Zoran Shapuriq dhe Pece Mirçeski Pjesëmarrja qytetare në proceset e krijimit të politikave dhe sjelljen e vendimeve në vetëqeverisjen lokale udhëzues për qytetarët shtypur në Shkup 2011

proceset e vendimmarjes. Këto informacione të përmendura sipas Statusit konsiderohen të karakterit “publik”, që do të thotë se për këto çështje qytetarët mund të kërkojnë informacione më të detajuara.⁷⁶ Ligji për qasje të lirë në marrjen e informatave të karakterit publik u mundëson qytetarëve të pyesin dhe të marrin informata pa asnjë frikë nga ndonjë pasojë eventuale mbi ta. Me parashtrimin e kërkesave, qytetarët kontrollojnë pushtetin lokal dhe kështu parandalojnë korrupsionin dhe keqpërdorimin, dhe së bashku me mediat luftojnë për lirinë e plotë, informacione cilësore dhe në këtë mënyrë të rrisin cilësinë e jetës dhe të kontribuojnë në zhvillimin e demokracisë. Politikat gjithashtu janë vegla komunikimi brenda partisë, ato munden të jenë politikisht **edukative** në dy drejtime. Liderët e partive mund të përdorin politikat për t’i mësuar anëtarët për fushatën dhe mesazhet ditore të politikës; anëtarët mund t’i sinjalizojnë leadershipit çka mendojnë dhe besojnë, veçanërisht në përgjigje të iniciativave të leadershipi. Politikanët e moderuar në R.Maqedonisë më së shpeshti janë të fokusuar në nxitjen e instikteve grupore-antipatisë idealeve të përbashkëta, respektivisht pranimin të një lloji të caktuar të sjelljes psikologjike dhe gradacionit të efekteve me qëllim që qytetarët të sillet nga pozita e mosdijes drejt dijenisë për veprimin. Gjatë kësaj, imponohet që t’i përballë etapat e ndryshimit të informacioni, njohuria, kuptimi, pa pasur gradacion në shkallën e informimit të opinionit për marrëdhëniet e vërteta dhe rol në subjektet eaktuara politike në strukturimin, udhëheqjen dhe vendim-marrjen në nivel lokal dhe kombëtar. Me ndikim të madh në profilizimin e subjekteve politike është edhe shkalla e objektivitetit të përgjithshëm mediatik dhe mosanimin ndaj aktivitetit politik, sikurse edhe të vepruarit të elitave politike, gjatë kësaj evidente është edhe politizimi i mediave të caktuara të shtypit dhe elektronike, me zgjerimin mediatik të një profili të caktuar ideologjik të politikanëve edhe atë përshkak të interesave të caktuara personale ose profesionale të personaliteteve të veçantë që e krijojnë politikën redaktuese gjithashtu mediave të veçanta.⁷⁷ Tash është konfirmuar në masë dukshme, trupi votues dhe qytetarët e Maqedonisë nuk i kanë shenjat e participimit aktiv, të rregullt efikas politik, kjo do të thotë se në strukturën tonë politike dhe të jetësës (proceset e sundimit)krijohet, apo është krijuar një model i ndarjes së fuqisë politike në të cilën qytetarët, edhe pse kushtetues – politikisht janë baza dhe përbërsi thelbësor i sistemit të vendosje nuk posedojnë apo përdorin pjesën kryesore të fuqisë politike. Siç është përmendur më herët, realizohet një modelë i fuqisë, në të cilën përkundër përcaktimeve për fuqinë më të rëndësishme të qytetarëve dhe zgjedhësve në politikë, po madje edhe kornizat e mekanizmave funksionues kushtetues –politik për shembull zgjedhjet demokratike, kontroll i pushtetit, ndarja e pushtetit, garantim dhe mbrojtje e të drejtave politike të njeriut, në jetën politike dhe në sundim-

⁷⁶ Përfaqsimi dhe pjesëmarrja politike në Maqedoni, Instituti për demokraci dhe zhvillim Tetovë 2010 ;80

⁷⁷ Përfaqsimi dhe pjesëmarrja politike në Maqedoni, Institui për demokraci dhe zhvillim Tetovë 2010 ;139

mbisundon ndonjë elitë politike.⁷⁸Në qoftë se hedhim një shikim ne dokumentet e tyre partiake, veçanarisht statutet e partive politike, shumica prej tyre proklamojnë barazinë e antarsisë, qytetarve- se antarët e tyre janë të barabartë në krijimin e vullnetit politik,ashtu edhe në krijimin e politikës partiake dhe matrializimin ose jetësimin e saj, pa marr parasysh nëse i takonë bërthamës partiake, apo ndonjë organi të partisë ose janë antarë të thjeshtë. Ç'është e vërtete,statuti i këtyre partive përcakton mekanizmat e formimit të politikës partiake dhe në shikim të parë me të vërtet krijohet përshtypje se qytetarët dhe antarsia e gjërë ka rol dominues në të gjitha sferat e në të gjitha nivelet e organizimit partiak.⁷⁹Statuti i Lidhjes Social Demokrateve të Maqedonisë proklamon se qytetarë, gëzon të drejtën e patjetërsueshme të marrë pjesë në ndërtimin dhe zbatimin, informimin e politikës partiake⁸⁰.Në Statutin e Partisë Demokratike Shqipëtare veç tjerash thuhet se anëtar i kësaj partie dhe qytetarët ka të drejtë në mënyrë të barabartë të marrë pjesë në aktivitet e partisë dhe të informohet për aktivitet e saj.⁸¹Po të njëjtat të drejta i parasheh edhe Statuti i VMRO-DPMNE, të njetat të drejta i parsheh edhe statuti i partisë politike Bashkimi Demokratik për Integrim-BDI. Normativisht, të gjithë partitë politike përmes dokumenteve partiake krijojnë përshtypje se ngrenë lart pozitën e antarit të thjeshtë të partisë dhe frymen kolektive në procesin e vendimmarrjes, duke krijuar opinion jo të saktë se bërthama partiake dhe udhëheqja shprehin në formën e insitucionalizuar vullnetin e antarsisë së gjërë. Elitat politike në Maqedoni shpesh i shmangen parimeve të tyre fillestare të përcaktuara në statutin partiak, duke devijuar nga interesat primare dhe qenësore të etniteteve që përfaqsojnë, merrën me çështje tjera që nuk përputhen me premtimet e dhëna në fushatat zgjedhore. Ndonse partive politike në pushtet - elitave politike ju rritet pushteti i udhëheqjes, anëtarisë së gjërë dhe qytetarëve dukshem ju zvoglohet mundësia e kontrollit dhe informimit të punës nga ana e tyre. Edhe pse normativisht qytetarëve dhe antarsisë së gjërë ju sigurohen pjesëmarrje e barabartë në procesin e vendimë marrjes, në praktikë situata paraqitet ndryshe. Pozita qytetare dhe anëtarisë së gjërë,mundësia e tij për të qenë të barabartë në proceset e vendimmarrjes, nuk është favorizuese nga ana e partive politike në, shumicës i imponohet vullneti i pakicës, masës i imponohet vullneti i elitës, zakonisht qytetarët dhe anëtarësia e gjërë e përjetojnë partinë në bazë të politikës që ajo lançonë, nëpërmjet organizimit të njerëzve që gjenden në krye të partisë dmth funksionarve të lartë partiak e sidomos liderit partiak.⁸²Megjithatë jo çdo herë sistemi i informimit vepron lirshëm dhe jo çdo herë ai i shërben gjithë qytetarve, ndodhë që sistemet

⁷⁸ Përfaqësimi dhe pjesëmarrja politike në Maqedoni ,Instituti për Demokraci dhe Zhvillim Tetovë 2010;59

⁷⁹ Statutet e partive politike LSDM,PDSH,VMRO DPMNE dhe BDI

⁸⁰ Statuti i partisë politike LSDM-së

⁸¹ Statusi i partisë politike PDSH-së

⁸² Etem Aziri Partitë politike zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore Tetovë 2015;228

informimit është nën kontrollin e plot të partive politike dhe liderve partiak, kirijimi i pozitivave monopoliste pamundëson depërtimin e informacioneve deri te opinioni më i gjërë politik⁸³, megjithëate praktika e veprimit të partive politike ofron dëshmi të mjaftueshme duke përfshirë edhe partitë politike që veprojnë në Maqedoni të cilat janë të prekura nga tendenca e oligarkive partiake, nuk janë të interesuar për njerëz të informuar, politikisht të formuar, profesionalisht të përgaditura e sidomos për ata që në segmente të veçanta janë mbi nivelin e elitës partiake në parti politike.⁸⁴

Partitë politike në Maqedoni shpesh herë nuk janë të interesuar për zgjerim të kapaciteteve politikbërëse, por thjeshtë për sigurim të fitorës në zgjedhjet, edhe pse fitorja bie ndesh me principet demokratike. Në praktikën e veprimit të partive politike me qëllim apo "pa qëllim" informacioni nuk funksionon siç duhet, këtë e bëjnë me qëllimin e vetëm që qytetarët, anatarsia e gjërë që të mos kenë kohë të mjaftueshme që të jenë aktiv, të marrin qëndrim kritik ose të formojnë qëndrimë të vetin, që të rezultoj ndryshe nga ai që imponojnë elitat partiake, duke u nisur nga shumica e iniciativave që merr qeverija, ngjarje me veprime kundër produktive, diskriminuese, akuzave, shfrytëzimi jo racional i buxhetit shtetëror, projektve të panevojshme jo produktive që varfërojnë qytetarin e rëndomt, kur bota e mbërthyer me krizën financiare po i kursen mjetet edhe për ndërtimin e fabrikave, kjo nomenklaturë politike po derdhet pa kursyer para të taksapaguesve, në mesin e të cilave edhe të atyre shqiptar që kanë marrë tatëpjetën në shkallën e varfërisë dhe borxhit publik, që sipas disa statistikave, vlera e kredive të qytetarve që nuk janë në gjendje ti kthejnë ato përfshin një shumë të lart të parave.⁸⁵ Politika ditor, largimi nga rruga eurointegritimeve që n'çdo fushat zgjedhore në takime me qytetarët e proklamoni në programin politik çdo kandidat kur del në skenë garuese, Strategjinë për Integritime "Euroatlanitike", "implementimi" i plotë i Marrëveshjes së Ohërit, lidert partiak fillojnë nga kjo pikë e programit të tyre propaganduese e sidomos liderët shqipëtarë "ndryshimi i statusit jo të barbartë politiko-juridik", lidert partiak nuk janë të interesuar ta informojnë qytetarin antarsin e gjërë për politiken e tyre stagnuese, ngritë pushtetin e tij në mënyrë artificiale, duke luajtur me ndjenjen kombëtare të votuesit, ndjellë frikën dhe nuk tregon dritën në skaj të tunelit. Një pjesë e popullit nuk është edukuar se si mund të jetojë si e gjithë bota normale, kjo sjellje e popullit i konvenon pushtetit lidereve partiak në Maqedoni sepse nuk trazon fare nga fronti që e ka pushtuar me votën e premtimve ndaj njerëzve qytetarve, mandej nuk kërkon që dikushë ta lavdërojë për punën që e bën, sepse di vetë

⁸³ Etem Aziri Sistemi politik Tetovë 2012;41;42

⁸⁴ Etem Aziri Partitë politike zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore, Tetovë;2015;241

⁸⁵ Ismail Arslani Përthyerje politike në tranzicion Tetovë 2013;242

të lavdrohet duke shpenzuar për marketing politik parat të majme të takaspaguesve.⁸⁶ Liderët partiak në Republikën e Maqedonisë për një situat të ndërlikuar shoqërore, politike, ekonomike, ndërnacionale ose ndërjetare, kur është shfaqur në opinion sjellin **informata të dorës së dytë**, me këtë dëshiron të tërheq vëmendjen opinionit nga proceset aktuale problematike në shoqëri, sikurse edhe ngjarjeve, me marginalizimin dhe pikësimin e tyre politik në projektimin e çështjeve të ndjeshme për qytetarët dhe antarsinë e gjërë.⁸⁷ Dimenzionin komgnitiv shkon drejt formimit të mendimit publik që do t'i konfirmojë qëllimet e proklamuar respektivisht do të krijojë qëndrim pozitiv ndaj mendimit të shprehur politik, aksionit ose vendimëmarjes politike, qëllimi është të nxirret nga pozita konkrete social, që të mos krijohet ndjenj e situatës së destabilizuar, që të mundet ai të jetë i vendosur nën ndikimin e qytetarve dhe antarsis së gjërë. "Konfrontimet" të bartësve të politikës shtetërore të këtij vendi me të gjithë qytetarët, që janë shëndrruar në instrumentin e oportunitetit të mbijetesës së pushtetmbajtësve dhe mekanizëm përafrimi me pjesën më të madhe të elektoratit me bindje të lajthitur se" kjo qeveri është e denjë dhe forcë që mund t'sfidojë edhe fuqitë e mëdha.⁸⁸ Lideri partiak i VMRO-DPMNE-së pretendon të tregojë forcën e pushtetit të vetë që ka në intres të vetin mos humbjet e pushteti që varet nga BDI-ja dhe pjesëmarrja e saj në qeveri, kjo nuk bëhet përshkak të synimeve për ndërtimin e një shteti multietnik me të drejta të barabarta, por për shkak të pazarëve dhe interesave politike e partiake, për këtë partitë politike maqedonase me epitete kombëtar diskursi i tashëm politik ndaj shqiptarëve fare nuk ka të bëjë me përmisimin e realitetit multietnik në Maqedoni, por ngrihet në nivelin e instrumentit politik për pazare politike. Kjo është e qartë për faktin se gjatë gjithë kohës së veprimit të saj ka ngritur imazhin e partisë në saje të rezistencës ndaj implementimit të Marveshjes së Ohërit dhe plotësimin e kërkesave të shqipëtarve, ndonjë në praktikë" nuk është gjithaqë e tillë, dhe se këto vite gjatë mandatit që ka pas partija tij ka shënuar progres në punsim, zhvillim kulturor, se shumica e buxhetit shtetror është shpenzuar për projekte kulturore, për të është shumë mos të zhvillojë përceptimin për një Maqedoni multietnik dhe kulturore, për fakti që konsideron se ky dëmton imazhin që sjell suksese në skenën politike të një lideri politik. Në kontekstin, lideri i BDI-së nëpërmjet disa mediave elektronike, dërgoi mesazhe të qarta te popullata e gjërë "se vonesa e zgjidhjes së çështjes së emrit, si kusht për NATO-BE, shkaktojë paknaqsi..." ky nuk ishte një kërcnim i drejtëpërdrejt i liderit të BDI-së ndaj partnerit të vet qeveritar, por si një reagim logjik për situatën e vështirë në të cilën gjend BDI-ja por edhe vetë lideri shqiptari, si peng të politikës qeveritare në procesin integruar, ndonjë nuk e thot në mënyrë të hapur pozita e liderit partiak është shumë problematike në qeveri,

⁸⁶ Ismail Arslani Përthyrje politike në tranzicion Tetovë 2013;244

⁸⁷ Përfaqsimi dhe pjesëmarrja politike në Maqedoni Instituti për Demokraci dhe Zhvillim, Tetovë 2010 ;133

⁸⁸ Ismail Arslani Përthyrje politike në tranzicion Tetovë 2013;283

ballafaqohet me një partner që është kundër kërkesave të parashikuara në Marrveshjen e Ohërit dhe nuk ka agjendë evropiane⁸⁹, në deklarata e tij për mos implemmentimin e plotë Marrveshjes së Ohërit çdo herë qytetarët gjejnë përgjigje se lideri dhe partia e tij në pushtet janë më tepër të fokusuar tek kjo pikë dhe se ajo po vëzhgohet vazhdimisht nga ana e tyre, që po arrin të realizohet hap pas hapi. Me këto deklarata Lideri i partisë në fjalë dëshiron “t’i qetsojë opinionin e gjërë shqiptar -votuesit nga veprimet e tendosura të kësaj qeverie”, në opinion gjithënjë më shumë po hidhet teza edhe për euroksenofobi, me qëllim që tek qytetarët të bëhet një “shpërlarje mentale”. Partitë politike opozitare në Maqedoni kërkonin rrëzimin e kësaj qeverie me mjete demokratike se kjo qeveri nuk ka kapacitet për të shëruar pesimizmin në rritje të shoqërisë, e cila fare nuk ka vesh për kërkesat e të gjithë qytetarëve, sepse përkujdeset vetëm për ushtarët e vet partiakë, që ata të jenë të kënaqur nga kjo situatë dhe knaqësinë e tyre të reflektojnë tek të gjithë të tjerët se në Maqedoni po rrjedh “qumësht me mjaltë”.⁹⁰ Partitë politike dhe lidert partiak të opozites në Maqedoni kur janë në opozit, insistojnë të ndërtojnë raporte të përafërta ndërmjet antarësisë së gjërë dhe udhëheqjes, kjo duhet të kuptuar si fenomen normal, pasi gjatë kohës kur partia politike ndodhët në opozitë, udhëheqja partiake nuk ndjen nevojën e diferencimit të saj nga masa. Megjithëate, çdo anëtar i partive politike, por trupi zgjedhor në përgjithësi, e kanë të qartë dallimin në mes deklarativës dhe të realizueshmes teorisë(dokumenteve partiake)dhe praktikës, tek këto parti politike. S’ka dyshim se një pjesë e mirë e indikatorve jo të mirë zhvillues të shtetit, janë rezultat i menaxhimit të dobët të proceseve politike, pikërisht për shkak të interesave partiak, lideret partiak që në princip i rënojnë elementete e përgjegjësisë profesionale në qeverisje.⁹¹ Prej cilit do kënd vërohet, politika është serioze dhe shumë e vështirë, kërkon koshiençë të lartë dhe përgjegjësi për hapat që bëjnë për peshën e veprimit që bëjnë dhe pasojat që mund të lindin. Kërkon nuhatjen e momentit dhe rrethanave kur bëhet veprimi dhe deklarimi, posaçërisht **deklarimi publik**. Të gjithë këto veçori karakteristike bëhen edhe më të theksuara varsisht nga niveli i funksionit politik ose shtetrorë që ushtrohet.

⁸⁹ Ismail Arslani Përthyrje politike dhe tranzicion Tetovë 2013;285

⁹⁰ Ismail Arslani Përthyrje politike në tranzicion Tetovë 2013;250

⁹¹ Shteti i së drejtës dhe reformat në administratën publike rasti Maqedoni përmbledhje kumtesash shkencore;Etem Aziri,Jonuz Abdullahi,Ali Pajaziti,Memet Memeti Tetovë 2008;120

4. Angazhimi i partive politike në Republikën e Maqedonisë për ndërtimin e kulturave politike tek qytetarët dhe antarsisa e gjërë partiake

Vetë koncepti kulturë mbetet mjaft i përgjithësuar dhe i kuptuar në mënyra të ndryshme, dikush kulturën e kupton si mënyrë jetese të përcaktuar nga rrethi shoqëror, dikush si tërësi komplekse që përfshin atë që mendojmë, që punojmë e që kemi si anëtarë të shoqërisë, dikush kulturën e mendon si sistem vlerash, e dikush tjetër si proces të socializimit e të sjelljes të tipizuar tek individ, dikush kulturën e pa si strukturë të komunikimit simbolik, e të tjerët si proces dhe rezultat të humanizmit të njeriut. Sidoqoftë kultura politike përfaqson një pjesë vendimtare, në mos kryesoren të një shoqërie, sepse ajo rezulton në lidhshmëri me jetën në komunitet, organizimin dhe qeverisjen, komunikimin, madje edhe shtetformimin dhe patriotizmin konstitucionalist, që nënkupton dashuri ndaj atdheut respektin për ligjin, drejtësinë si paanshmëri, barazinë e shanseve dhe konkurrencën e lirë.⁹² Kultura politike është pjesë e kulturës së përgjithshme të shoqërisë dhe përfaqson tërësinë e vlerave themelore, ndjenjat, njohuritë, qëndrimet dhe bindjet brenda të cilave vepron sistemi politik i vendit, duke i dhënë formën dhe përmbajtjen procesit politik (Denis Kovanagh).⁹³ Meqense kultura politike ka të bëjë me qytetarin, por ajo multiplifikohet dhe fuqizohet në modelin e liderëve politikë do të thoja se kultura politike përcaktohet si dimension subjektiv i sistemit politik, kurse fushë dimensionit ku mund të hulumtohet ajo ,përfaqsojnë faktorët si dija, vlerat, ndjenjat dhe mendimet në lidhje me sjelljen politike dhe ndodhitë në një bashkësi politike (Almond).

- Kultura politike ka të bëjë me orientimet subjektive politike në kuadër të një shoqërie ;
- Pjesë përbërse të kulturës politike janë elementet kognitivë dhe vlersues;
- Përmbajtja e kulturës politike është rezultat i socializimit në fëmijëri, i edukimit, ndikimit të medias, përjetimit nga jeta e të rriturve dhe faktorëve që përbëjnë pushtetin, ekonominë dhe shoqërinë.
- Kultura politike ndikon në strukturën e pushtetit dhe politikës dhe rezultatet e saj.
- Si virtyte që i përgjigjen idealit të qytetarit të mirë, përkatsisht virtytet e kulturës politike apo veçoritë e kulturës politike liberale-demokratike, Glaston përmend :
 - Virtyte të përgjithshme (respekti ndaj ligjit, lojaliteti)
 - Virtyte sociale (pavarsia, transparenca, apo të qenit të hapur)

⁹² Përfaqsimi dhe pjesëmarrja politike në Maqedoni, Instituti për demokraci dhe zhvillim Tetovë 2010;105

⁹³ Jonuz Abdullai Politika dhe politikat publike Tetovë 2010;113

- Virtyte politike (aftësia për të respektuar të drejtat e njerëzve të tjerë;afësia për të vlersuar ata që drejton shtetin;gatishmëria për pjesmarrje në debate publike të bashkësisë).

Në lidhje me relatat politikë-kulturë, sot konkurrojnë dy koncepte themelore univerzalizmi i cili përfaqëson platformën kulturore të konceptit politik të demokracisë, sipas të cilit ka disa tema dhe probleme themelore rreth të cilave duhet të ketë një konsensus politik në lidhje me dinjitetin njerëzor, lirinë dhe të drejtat themelore dhe mbi këtë koncept kulturoro-politik sot po ndërtohet globalizimi, si koncept edhe politikë edhe kulturor, i cili me gjithë kundërshtimet, po bëhet koncept dominues dhe i cili problemin e kulturës politike e sheh si problem të edukimit.⁹⁴Mbetet të kuptojmë në ç'mënyrë autonomia dhe dispozita për të menduar janë kompatible me adaptimin në jetën e një komuniteti të caktuar politik. Nuk është njësoj si të votosh për një pushtetar përshkak të karizmës së personalitetit të tij, apo për shkak se të duket interesant për arsye të zhvillimit ekonomik. Po ashtu nuk është njësoj si të votosh një qeveri për arsye morale, apo të zgjedhësh projektet politike të një partie. Kultura politike nënkupton një togfjalësh kompleks, por e thjeshtëzuar ajo është sensibilitet për lirinë, dinjitetin njerëzor dhe qeverisjen e përgjegjshme. Kultura erdhi si vijim i përpjekjeve për faktorizuar botën shpirtërore të njerëzve në shpjegimin e politikës. Kultura politike nxjerr në pah një lloj pavarësie të kulturës nga faktorët ekonomikë dhe rolin e kulturës për rendin politik dhe zhvillimin ekonomik. Kultura politike në vendet e tranzicionit duhet analizuar në disa aspekte, sidomos në procesin e reformës dhe realizimit të të drejtave nacionale, ku luan një rol shumë të rëndësishëm, kjo fletë për një argument shumë bindës se sa më shumë që demokracia të jetë e thelluar në një shoqëri, po kaq e ndryshuar është edhe kultura politike.Në kulturën politike të shoqërive në shtetet multietnike mund të ndikojnë edhe ndasitë etnike. Parimi etnik është i pranishëm edhe në skenën politike të Maqedonisë, e cila shpesh shkakton ngërçe politike duke prekur interesat kombëtare, e kjo bie në kundërshtim me gjitha vlerat e Bashkimit Evropian, kryesisht me të drejtat e njeriut, ketu lipset krijimi i një vullnetit politik për të ndryshuar marrëdhëniet e pushtetit në krijimin e barzisë kombëtare, fetare dhe gjinore. Para se gjithash, kjo arrihet me pjesëmarrjen politike të etnitete kombëtare, siç kemi rastin me R. Maqedonisë, pastaj përfshirjen e pakicave nacionale, sigurinë qytetare, procesin e integritetit evropian dhe demokratizimin e përgjithshëm të shoqërisë, si dhe zhvillimin e institucioneve demokratike. Rendi demokratik nënkupton pluralizëm politik dhe shoqëror, demokartizimi si një proces që përkon me historinë moderne politike, përfshin krijimin, kultivimin dhe zhvillimin e rendit

⁹⁴ Kadri Metaj Kultura politike dhe Demokracia Tetovë 2010;105

demokratik në shoqëritë moderne. Vala e demokratizimit ngërthen në vete tërsin e një tranzicion nga regjimet kohore. Kur flasim për Maqedoninë, atëherë duhet pranuar se tranzicioni shpeshherë ka ecur në drejtim të kundër, gjatë gjithë këtyre periudhave, duke e ndjekur pardigmën e hershme të tranzicionit kanë rënë në të ashtuquajturat zona gri politike që do të thotë se ballfaqohet me deficit të madh demokratik, i cili përfshin përfaqsim të ulët të interesave të qytetarve, pak politik pjesëmarrje jashtë zgjedhjeve, shkelje të ligjit nga ana e zyrtarëve të lart, nivel të ulët të besimit publik, në institucionet shtetore dhe ecuri e dobët institucionale e vazhdueshme. Maqedonia edhe më tej është vend i mediave të varura politikisht, kjo vlerohet edhe nga organizata amerikane "Freedom House". E thënë thjeshtë,sa më shumë që qeveria influencon mbi transmetuesit publikë,ose ndikon në emërimin e drejtorëve,aq më shumë ndjehet nevoja për rregulla, për objektivitet dhe barazi. Partitë e opozitës bëjnë thirrje në mënyrë sistematike për vendosjen e rregullave strikte në lidhje me përfaqsimin objektiv. Këto rregulla ndoshta edhe nuk do të duheshin nëse partitë në pushtet nuk do të ushtronin aq shumë kontroll mbi transmetuesit publikë. Ndryshimet që u bënë si rezultat i tranzicionit të filluar, inciojn dhe tendenca të tjera negative të zhvillimit, siç është zhvillimi joadekuat gjeografik dhe rritja e dallimeve sociale ndërmjet qytetarëve në Maqedoni, që mundësuan rritjen e nivelit të pasigurisë sociale në vend. Pamvarsisht nga përpjekjet për të ruajtur një balancë deri diku jo diskriminuese për menaxhim të diversitetit, ka akoma mangësi në kompetencën qytetare dhe kapitalin shoqëror, vërehet një nivel i ulët i pjesëmarrjes qytetare efektive dhe besim politik, që bën të nevojshëm vazhdimin e zbatimit të politikave të diversitetit.

Partitë politike si një bashkim vullnetar politik i qytetarëve në një organizatë të përherëshme të krijuar e përcaktuar politikën e shtetit me formësimin e vullnetit politik të qytetarëve, zgjedhjen e kandidatëve për funksione publike dhe formulimin e programeve politike, si dhe veprimtarive të tjera, janë të domosdoshme për sistemet demokratike. Roli i partive politike në demokraci,ose në sistemin e qeverisjes, do të gjente një shpjegim etabulues dhe më konciz duke u bazuar në purkufizimin e Max Weberit, i cili jo rastësisht në definicionin e tij për partitë politike thotë se ato "janë fëmijët e demokracisë dhe të votimit të përgjithëshëm". Në demokracin e Sartori-t populli luan rolin qeverisës vetëm në zgjedhje. Qëllimi i zgjedhjeve, për më tepër, nuk është nxisë pjesëmarrjen popullore, por të përzgjedhë udhëheqsit më të specializuar, dhe Sartori përmend skemën e J.S.Mill-it për votim pluralist nga më të mirëarsimuarit. Nëse udhëheqsit e tillë mund të grupohen bashkë si elitë që përpiket me vediaje të mburojë opinionin publik, ky, për Sartori-n, do të ishte një zhvillim i mirëpritur. Duke e mbështetur qëndrimin e tij rezultatet e studimeve për sjelljen

votuese, Sartori argumenton se mesatarisht votuesi është pak informuar, jo i ditur dhe shpesh i paintresuar. Opinionet e tij nuk janë të tijat, por të ngjizuara nga klasa, antarsia e grupit dhe familja. Opinioni publik asnjëherë nuk krijonë ide; ai influencohet përpara se të arrijë të influencojë. Ndaj është një justifikim i mirë për një elitë cilësore, të formojë dhe të edukojë opinionin publik, sidomos kur elita është në konkurim me elitat tjera, jo se opinionin publik edhe atëherë do të mundë ta peshojë informacionin alternativ dhe këshillimin.⁹⁵

Zgjedhjet shpesh konsiderohen si zemra e procesit politik, zgjedhjet shihen si asgjë më pak se demokracia në praktikë dhe janë mjet përmes të cilit qytetarët mund të kontrollojnë qeverinë. Zgjedhjet mund të jenë në rregull dhe shumë të mira, por ato mund të kenë pak kuptim për njerzit nëse ekzistojnë vështirësi votimi ose nëse, tek e fundit, vota e tyre nuk ka ndonjë ndikim në mënyrën se si qeveriset një popull.⁹⁶ Vullneti i popullit i shprehur lirisht e ndershëmërisht nëpërmjet zgjedhjeve periodike e të vërteta, përbën bazën e autoritetit dhe legjitimitetit të të gjitha qeverive. Për rrjedhojë, shtetet pjesmarrëse zotohen të respektojnë të drejtën e shtetasve të tyre të marrin pjesë në qeverisjen e vendit, qoftë drejtëpërdrejt, qoftë nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht prej tyre përmes proceseve të ndershme elktorale.⁹⁷ Për të formuar parapëlqimin e qytetarve, zgjedhjet duhet të mbështeten në parime demokratike, duke ju ofruar votuesve zgjedhje të lira, të ndershme e kredibile, si parime themelore të zgjedhjeve demokratike janë: e drejta e zgjedhjes së përgjithshme, e drejta e barabartë e votës, zgjedhjet e lira dhe të drejtëpërdrejta, votimi i fshehtë, zgjedhjet shumë partiake, shtypi i lirë,⁹⁸ Lirinë e fjalës dhe mediave, lirinë e tubimeve për të zhvilluar fushatë zgjedhore, lirinë e qasjes ndaj elktoratit për të përcjellur dhe pranuar porosi politike dhe zgjedhore, sigurojnë që ligji dhe politika publike të bëjnë të mundur që fushata politike të zhvillohet në një atmosferë të lirë e të ndershme, gjatë së cilës as veprimi administrativ, as dhuna apo kërcnimi nuk duhet t'i ndalojë partitë dhe kandidatët të prezantojnë lirishëm pikëpamjet dhe vlerat e tyre, ose votuesit që të mësojnë si dhe ta hedhin votën e tyre pa pasur frikë, një shkollim bashkëkohor për program trajnues për votuesin, mundësi të barabartë për t'u regjistruar si votues dhe për të zgjedhur, liria e qasjes ndaj vëzhguesve partiak, vëzhguesve zgjedhor ndërkombëtar dhe vëzhguesve zgjedhor të tjerë nga vendi në vendvotime, liria nga kërcnimi, rryshfeti dhe shtypja, e drejta e votuesit të flas mbi çështjen politike, të parashtrojë pyetje dhe të sfidojë, liri dhe qasje në

⁹⁵ Sartori, Democratic Theory, Wayne State University Press Detroit; 1962; 75-77

⁹⁶ The international IDEA Handbook of Electoral System Design (manual internacional IDEA për hartimin e sistemeve elktorale) ;10

⁹⁷ Veton Latifi Konceptet e Demokracisë ;133;134

⁹⁸ Arsim Bajrami Teoria dhe praktika parlamentare Shkup 2002;174

procesin zgjedhor.⁹⁹ Në demokraci populli realizon sovranitetin e vetë përmes votave të tij, të cilat janë shprehje e vullnetit të tij.(Montesquieu),kësaj teze i shkon përshtat edhe thënie e M.Prelot 1963 sipas të cilit populli konsolidohet në zgjedhje. Legjitimiteti dhe stabiliteti politik në debatin politik modern, zakonisht kuptohet më pak si detyrim moral dhe më tepër si sjellje dhe besim politik. Kultura politike kuptohet si orientim i njerëzve ndaj objekteve politike siç janë partitë qeveritë, kushtetuta, të shprehurit në besim , simbole dhe vlerë.

Përderisa partitë politike paraqesin çelësin e ndërtimit dhe forcimit të demokracisë, atëherë pesha e zgjedhësve –votuesve doemos të vlersohet si faktor kyç dhe si mekanizëm më i fuqishëm dhe i vetëm i ruajtjes së vlerave themelore të demokracisë. Ndërlidhja e këtillë dhe kaq e madhe ndërmjet këtyre katër faktorëve:parti politike zgjedhje, popull-qytetar, pushtet, imponon nevojën për sigurimin e kushteve maksimalisht demokratike gjatë momentit të shfaqjes së vullnetit të popullit.¹⁰⁰Votimi paraqet fazën finale të zgjedhjeve,në të cilën trupi votues elktoral deklaron për zgjedhjen e organeve përfaqësues, zgjedhja e cila bëhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë, me votim të fshehtë dhe me pjesëmarrje të të gjithë qytetarëve me të drejtë zgjedhore, të cilët në momentin e votimit janë të evidentuar në listat e votimit-zgjedhore.¹⁰¹Votimi në fakt, paraqet momentin dhe aktin më të lartë të lirisë, akti i votimit është një akt madhor, sepse sublimon dy ndjenja shpirtërore të njeriut, në atë çast puqet dy faza të një jete: e kaluara dhe e ardhmja. Aty ndodh shprehja e vullnetit të qytetarëve dhe bëhet përcaktimi për bartjen e vullnetit nga individi –votues, tek individi, ose subjekti politik-realizues. Delegimi ose bartja, transferimi i vullnetit politik është piedestali i sistemit demokratik.¹⁰²Karakteristik në Republikën e Maqedonisë është ndarja e votuesve në lloje grupimesh: në bazë etnike, me votim të maqedonasve për subjekte zgjedhore maqedonas, dhe votim i shqiptarve, për subjekte garuese shqiptare, në baza ideologjike është votim më tepër i karakterit propagandistik, por fare pak përmbajtësor dhe me ndonjë veçuri tepër të vogël i karakterizon subjektet politike maqedonase. Ndarje tjetër etnike nuk ekziston, përshkak se pjesëtarët e popujve tjerë që banojnë në Maqedoni përbëjnë vetëm 9.59% të popullsisë dhe i karkaterizon një numër i madh partish politike në etnitetet e tyre (sërbët kanë dy parti, turqit tri, romëtgjashhtë, boshnjakët dy, dhevlllehët dy partipolitike). Në”pamundësi “për të siguruar përfaqësues të tyre këto parti tradicionalisht i bashkangjiten ndonjërit subjekt politik maqedonas për

⁹⁹ Veton Latifi Konceptet e Demokracisë Tetovë 2009;131;

¹⁰⁰ Mahi Nesimi Dhunimi i vullnetit Zgjedhjet parlamentare 2008 Tetovë 2009;14

¹⁰¹ Arsim Bajrami Teoria dhe praktika parlamentare Shkup 2002;184

¹⁰² Mahi Nesimi Dhunimi i vullnetit zgjedhjet parlamentare 2008 Tetovë 2009;14 ;15

të cilin mendojnë se do të përmbush kërkesat e tyre. Ndarja e votuesve në taborë etnikë, si dhe gjeografia populative e Maqedonisë, ka sjellë vlersime dhe konstatime të ndryshme lidhur me kapacitetet demokratike të rajoneve ose etnivateve të caktuara. Zgjedhjet si formë dhe votim si akt bazik i ndërtimit të vertikales së pushtetit në Republikën e Maqedonisë kanë kaluar nëpër faza dhe forma të nduarnduarta me ç'rast kanë shkaktuar probleme të caktuara në shoqëri, duke u nisur nga ajo se organizimet e ndryshme të subjekteve politike po edhe të individëve, gjatë procesit të barjes së vullnetit politik janë manifestuar me dukuri të pahijëshme, manipulime e abuzime të pa pranueshme e të dëmshme për ndërtimin e një shoqërie të shëndosh, gjatë historisë në vazhdimsi është bërë korigjimi i mangësive të detektuara dhe të regjistruara. Çështja e pjesëmarrjes së qytetarëve në demokraci është një nga çështjet kyçe të dimensionit të të drejtave të njeriut në demokraci, e drejta për pjesëmarrje është në zemër të së drejtës njerëzore dhe është bazament i parimeve, vizioneve dhe vlerave të demokracisë objektive. Çështja e pjesëmarrjes zakonisht shihet nga dy aspekte: nga aspekti i mospërfshirjes së të gjitha segmenteve të qytetarëve në proceset demokratike kryesisht në votime, pra çështja e përjashtimit nga e drejta e pjesëmarrjes, përkatësisht votimit.¹⁰³ Numëri i partive politike që marrin pjesë në zgjedhje është shumë i lartë i pakrahasueshëm me tranzicione të tjera dhe vende tradicionalisht demokratike. Partitë që marrin pjesë në zgjedhje janë të paqëndrueshme-ato shpesh formohen, shpërbëhen, krijojnë koalicione të pazakonta, kanë organizim dhe raport të brendshëm jo demokratik. Në këto konstatime fshihet edhe shenjat e më shpesh të partiokratizmit të supozuar, mbisundimit të partive në jetën politike.¹⁰⁴ Respektivisht qytetarët e Republikës së Maqedonisë nuk janë mjaft të informuar, intresuar dhe të motivuar për pjesëmarrje zgjedhore, me siguri për faktin se ndiejnë se pjesëmarrja e tyre ose fitorja e ndonjë partie nuk ndikon shumë në ndryshimin e kushteve të jetesë së tyre dhe pozitës. Megjithatë, numri i madh i partive dhe kandidatëve, si dhe të vepruarit e antarsisë partiake madje edhe mbështetja elektorale e partive është në masë të madhe rezultat i partiokratizmit ndërsa vetvetiu nxit këtë partiokratizëm; respektivisht përmes fitores së ndonjëre partie ose kandidati në zgjedhje, mund të zgjidhen shumë probleme me të cilat ballafaqohet individ-i votuesi ose grupi i tij (familja, lokaliteti, ndërrmarja, grupi etnik etj) siç janë punsimi, arsismimi, marrëveshja për pazare, shmangia e tatimeve, mbrojtje gjyqësore dhe shumë të tjera.¹⁰⁵ Participimi varet nga statusi social-ekonomik i njerëzve dhe ndikon drejtëpërdrejt në përgjegjësin e të zgjedhurve. Respektivisht është e sigurt se shtresat e larta ka përfshirje më të lartë të personave me arsim më

¹⁰³ Veton Latifi Konceptet e demokracisë Tetovë 2009;111

¹⁰⁴ Përfaqsim dhe pjesëmarrja politike në Maqedoni, Instituti për Demokraci dhe Zhvillim Tetovë 2010 ;55;56

¹⁰⁵ Po aty, Dimitar Mirecev Skena politike e Maqedonisë 1990-2010 ndërmjet participizmit dhe elitizmit;55,56,57

të ulët, ndërsa te shtersat e mesme apo më të ulët, përfshirje më të lartë të personave me arsimim më të ulët. Politika dhe arsimimi janë kanale të dukshme të hierarkisë sociale dhe promovimit, shtresat janë kryesisht të mbyllura dhe politikisht të partikuluara. Kjo ndikon shumë në specifikat e jetës politike dhe të participimit, në pluralizëm partiak, kulturë politike, të shprehjes së etno-politikës, të vetëdijes dhe mendimit publik, të mungesë së vetëdijes qytetare dhe orientimit. Numri i madh i popullatës më pak të arsimuar dhe kualifikuar në trupin zgjedhor, ndikon që ai trup në segmente të mëdha të jetë i painformuar për axhendat zgjedhore dhe e orientuar për partitë apo kandidatët, të jetë më pak i motivuar për pjesëmarrje në zgjedhje dhe më pak i interesuar për rezultatin zgjedhor. Anketat parazgjedhore të ne tregojnë se një pjesë e mirë e zgjedhësve kanë qenë të papërcaktuar politikisht apo partiakisht deri para zgjedhjeve.¹⁰⁶ Në vendet me tradita të hershme pluralo-partiake përcaktimi i votuesve nuk është thjesht çështje rutine, por para se gjithash proces i cili varet nga niveli i kultures politike të masave të gjëra, traditës zgjedhore, fuqisë mobilizuese të partive politik, platformave të tyre zgjedhore. Zgjedhjet e para parlamentare pluraliste ishin një efouri e madhe dhe një shpresë e zgjedhësve se me pjesëmarrje masive do të ndërtojnë një të ardhme më mirë, dalja në zgjedhje përfëshinte 84,8% të votuesve, në zgjedhjet e dyta të radhës pjesëmarrja ra 77,3% në zgjedhjet tjera 66,4% në zgjedhjet viti 1998 përfshinte votues edhe atë vetëm 66,4%, vitin 2002 pjesëmarrja ishte 58,7% zgjedhjet parlamentare 2002 edhe keto zgjedhje janë zhvilluar në atmosferë të konflikteve ndëretnike nuk a ka munguar akuza reciproke e manipulimit me votat, mbushja e kutive dhe akuzave tjera të kësaj natyre që ka motivuar qytetari të mos shpreh interes për të votuar në zgjedhjet e radhës këtë e dëshmo % pjesmarja e votuesve prej 58,7%,- në zgjedhjet e vitit 2006 poa ashtu shënoi një rënie të trupit votues në 56,6%. Zgjedhjet parlamentare të 2008 u zhvilluan me shumë incidente, të drejtë vote kishin 1779116 votues, por në zgjedhje kanë dalë 1031632-57,99% zgjedhës të regjistruar, zgjedhjet e parakohshme të 1 qershorit nuk ofruan votuesve progres, për shkak të dështimit nga disa palë që merrnin pjesë në zgjedhje dhe autoriteteve përkatse për të parandaluar aktet e dhunshme kryesisht në zonat me shumicë shqiptare, duke përfshir zbatimin e kufizuar dhe selektiv të ligjeve, përpjekjet për ta penguar procesin zgjedhor në orët e mëngjesit gjatë ditës të votimit, pamundësuan shumë qytetarë në shumë vende të shprehin lirisht vullnetin e tyre, gjithashtu mungesa e raportimit analitik e kufizoi rolin e mediave në informimin e votuesve për garën

¹⁰⁶ Përfaqsimi dhe pjesëmarrja politike në Maqedoni Instituti për Zhvillim dhe Demokraci Tetovë 2010,54;55(Dimitar Mirecev ,Skena politike e Maqedonisë 1990-2010 ndërmjet participizmit dhe elitizmit)

zgjedhore¹⁰⁷. Pastaj në zgjedhjet lokale dhe presidenciale të vitit 2009 dalja në qendra të votimit nga qytetarët ka shënuar edhe më tej rënie kjo dëshmon me pjesmarjen e tyre 43,3%,¹⁰⁸. Rënia e numrit të zgjedhësve lidhet me zhgënjimin e elektoratit nga partitë politike dhe pafuqia e tyre e përsëritur për mbajtjen e permtimeve të mëparshme, poashtu një arsye tjetër e rënies së numërit të trupit votues është burokracia e sistemit elektorale, procedurat e shumta teknike të regjistrimit e votimit, vështirësitë në identifikimin e të gjithë qytetarëve me të drejtë vote kudo ata ndodhën, problemet e korrupsionit politik.

Zgjedhjet parakohshme parlamentare(1 qershor 2008) fushat zgjedhore me plotë incidente dhe friksimt votuesve në zona me shumicë shqiptare

Periodha zyrtare e fushatës zgjedhore filloi me 11 maj dhe mbaroi në mesnatë më 30 maj, duke pasur 24 orë të periudhës së heshtjes parazgjedhore, dy kualicionet kryesore maqedonase VMRO-DPMNE dhe kualicioni “Dielli” i LSDM-së si dhe dy partitë politike shqiptare PDSH dhe BDI organizuan fushatë aktive dhe të dukshme në shumtën e rajoneve, duke përdorur afishe, billborde dhe reklama të paguara.¹⁰⁹ Një numër i madh i tubimeve u mbajtën në 4 lista kryesore të kandidatëve gjatë fushatës, me dhjetëra mijëra mbështetës që morën në pjesën më të madhe. Ambienti i sigurisë gjatë periudhës së fushatës ndryshonte dukshëm në mes rajonëve kryesisht me shqiptarë etnik dhe pjesës tjetër të vendit. Përderisa vetëm disa incidente u raportuan në pjesën më të madhe të vendit një numër i konsiderueshëm i akteve të dhunës dhe frikësimit u raportuan në rajone kryesisht shqiptarë etnik, policia nuk u përgjigjë incidenteve të tilla ose nuk orvatej të parandalojë incidentet të mëtejshme, duke krijuar atmosferë mosndëshkimit. Për realizimin e këtyre zgjedhjeve u angazhua misioni OSBE-së/ODHIR-it aktiviteti i saj përfshinte sundimin e ligjit, mbështetjen të legjisllacionit, trajnime për zbatimin e ligjeve, vëzhgoj raportin dhe ndjekjen e përgjegjshis ndaj krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja, si dhe aktivitete edukative për respektimin dhe mirkuptimin reciprok, udhëheqje demokratike dhe të drejtën e lëvizjes së lirë dhe barazisë gjinore kjo struktur zbatoj një numër të madh të programeve të planifikuara për asistencë gjatë vitit, me qëllim të zhvillimit të strukturave demokratike¹¹⁰. Gjatë periudhës deri në zgjedhje OSBE/ODHIR, mori një numër të madh raporte gjithsej 19 raporte pesë kidnapime të mbështetësve të BDI-së dhe dy sulme ndaj shtëpive të mbështetësve të BDI-së, një sulmë ndaj zyrës së PDSH-së dhe 6 incidete me të shtëna armësh. Përveç kësaj kishte

¹⁰⁷ Mahi Nesim Dhunimi i vullnetit zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2008 ,Tetovë 2009,214;215;218

¹⁰⁸ Përfaqsimi dhe Pjesëmarrja Politike në Maqedoni, Instituti për Demokraci dhe Zhvillim Tetovë 2010;43

¹¹⁰ Mahi Nesimi Dhunimi i vullnetit, zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2008 ,Tetovë, 2009 205;206

raporte të shumta për makinat të cilat kalojnë nëpër fshatra vonë gjatë natës me burra të armatosur si dhe thashethëmsh se shqiptarët nga Kosova ilegalisht e kalojnë kufirin me qëllim që të krijojnë probleme gjatë ditës së zgjedhjeve, edhe pse këto supozime nuk i vërtetuan, ato ndikuan në rritjen e tensionit.¹¹¹ Sipas konsultimeve dhe konstatimeve të OSBE-së me shumë bashkëbisedues dhe zyrtarë qeveritarë, problemi i sigurisë në rajonet kryesisht shqiptar etnik rrjedh nga politizimi i niveleve të larta të policisë. Gjithashtu përdorimi i burimeve qeveritare për aktivitete partiake luajtën rolin të rëndësishëm në debate publike, fushata e dukshme që reklamoni suksesin e politikave të qeverisë përpara se të fillojë fushata zgjedhore, nxitën kritika publike, pas ankesave nga palët e përfshirë në zgjedhjet dhe bashkësis ndërkombëtare këto fushata u ndërpreu nga Qeveria. Përderisa reklamat e paguara për sukseset e Qeverisë u ndërpreu, programet e Qeverisë të cilat ofronin kontroll mjekësorë falas në vendet publike, punsime të stafit punës dhe hapja e qendrave shëndetësore nëpër fshatra vazhduan gjatë gjithë periudhës së fushatës. Televizioni konsiderohet si burim kryesor i informatave, transmetuesit publik ndanë kohë transmetimi për gjithë parashtruesit e listave të kandidatëve. Shumica e partive politike dhe kualicioneve e shfrytëzuan këtë mundësi të prezantojnë pikëpamjet e tyre dhe platformat zgjedhore. Misioni për vëzhgimin e zgjedhjeve MVZ-ja e OSBE/ODIHR bëri vëzhgim e mediave duke përdorur analizat kualitative dhe kuantitative të gjashtë kanaleve televizive, në përgjithësi mediat ju a siguruan partive politike kryesore dhe kualicioneve mundësin e prezantimit të platformave dhe mendimeve të tyre gjatë pjesës së parë të lajmeve, por mungesa e raportimit analitik e kufizoi rolin e mediave në informimin e votuesve për garën zgjedhore.¹¹² Prej 30 prill e deri në fillimin e periudhës së fushatës zyrtare, MTV-1 e cila mbulonte 26% të mbulimit pozitiv të kualicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja përdoreja kualicioni Diell mori 20% të mbulimit neutral. Kjo nuk ndryshoi me fillimin zyrtar të fushatës koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE mori 24% të mbulimit pozitiv, përderisa koalicioni Dielli mori 19% të mbulimit, më shumë neutral por me ton pozitiv. MTV-1 përkushtoi një sasi të konsiderueshme të mbulimit të aktiviteteve të autoriteteve. Të dyja partitë shqiptare PDSH, dhe BDI u trajtuan barabartë dhe secila prej tyre mori 8% të mbulimit. MTV-1 beri një program zgjedhor të veçant i cili ishte i balancuar në mbulimin e dy kualicioneve kryesore maqedonase; secila prej tyre mori rreth 34% të mbulimit pozitiv. Kanali televiziv MTV-2 i cili transmeton në gjuhën shqipe, ishte më i njëanshëm në mbulimin dhe qartë ishte në favor të PDSH-së, përpara se të fillonte fushata kanali ndau 21% mbulim pozitiv të aktiviteteve të PDSH-së, përderisa BDI-ja mori 9% më tepër me ton negativ. Gjatë fushatës zyrtare favorizimi i PDSH-së u rrit, MTV-2 ndau 42% të mbulimit të

¹¹¹ Mahi Nesimi Dhunimi i vullnetit zgjedhjet e parakoshme parlamentare 2008, Tetovë 2009; 216

¹¹² Po aty Misioni vëzhgues OSBE-ODIHR për mediumet (MTV-1, MTV-2, A1, Kanal 5, Alsat-M); 217

aktiviteteve të PDSH-së, më shumë ton pozitiv, përderisa BDI-ja mori 19% më shumë mbulim negativ dhe neutral. Trend i ngjajshëm u vërejt në programet speciale zgjedhore të tij. Ekzistonin dallime të dukshme në mbulimin e fushatës nga ana e transmetuesve privat të cilët u vëzhguan nga Misioni vëzhgues i zgjedhjeve/ MVZ-ja, e OSBE/ODIHR-it. Gjatë fushatës zyrtare, A1 dhe Kanali 5 ofruan për shikuesit e tyre mbulim të balansuar të partive politike më të mëdha. TV Sitel, megjithatë, ishte qartë i anshëm në favor të koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja që morri rreth 34% të mbulimit pozitiv. Në të kundërtën koalicioni Dieli mori rreth 34% të mbulimit negativ. Dhe disa herë neutral. TV Alsat-M u fokusua më shumë në aktivitetet e partive etnike shqiptare, duke favorizuar pak më shumë BDI-në. Gjatë periudhës së fushatës zyrtare, BDI-ja mori 27% kurse PDSH-ja 25%. Mediat e shkruara që u vëzhguan nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it prezantuan një sërë pikëpamjesh. Përderisa Vreme, Dnevnik dhe Utrinski Vesnik, siguronin mbulim që favorizonte koalicionin Dieli, Vecer-i dukshëm favorizonte koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE –ja, dhe e kritikonte ashpër koalicionin Dieli. Një trend i ngjajshëm u vëzhgua tek mediat në gjuhën shqipe, koha që favorizonte PDSH-në dhe Lajm që favorizonte BDI-në. Dita e zgjedhjeve më 1 Qershor u njëllos nga incidentet të dhunëshme dhe frikësimit në zonat me shumicë shqiptare. Ndonëse gjendja e sigurisë në këto zona u stabilizua gjatë tërë rrjedhës së ditës ,incidentet e mëngjesit të hershëm lanë një person për vdekje dhe të tjerë të plagosur. Fatkeqësia ndodhi në fshatin Harçinë, ku policia u përfshi në një incident të armatosur me kriminelët, MVE –ja e OSBE/ODIHR-it pranoi raportin e grupit kriminale që kishte hyrë në Haraçinë një natë përpara ditës së zgjedhjeve. Edhe pse nuk pati aksidente të tjera të rënda, u bë e ditur edhe për shumë raste të tjera të dhunës dhe të frikësimit në ditën e zgjedhjeve. Në këto zgjedhje u shënuan 19 raste të frikësimit, nga të cilët 14 raste ndodhën në zonat me shumicë shqiptare, shumica prej tyre ishin kundër antarve të këshillave zgjedhore, si në Berovë (vendvotimi nr2890) ku u sulmu kryetari i këshillit zgjedhor, mbyllja një orë pas fillimit zyrtar të votimit (Banjicë të epërme, vendvotimet 0515,0516,kutit e votimit ishin të vjedhura nga personat e armatosur si dhe të gjithë antarët e këshillit zgjedhor u përjashtuan nga vend votimet), mbyllja e dy vend votimeve në Gostivar (0507,0508)votimi u pengua nga persona të panjohur, të cilët i mbushën kutit e votimit, u vodhë materiali i këshillit zgjedhor, në Saraj një vend votim nuk u hap nga shkakut se gjysma e fletvotimeve ishin të zhdukur një natë më parë.¹¹³ Votimi i hershëm u zhvillua më 31 maj, një ditë para zgjedhjeve, për banorët dhe të zhvendosurit e brendshëm. Në të njëjtën ditë, votimi mobil u zhvillua për pacientët e shtrirë në spital dhe ato në shtëpi. Këshilli zgjedhor nuk kishte ofruar kushte adekuate për fshehtësinë e procesit të votimit të hershëm, ndryshimi në mes zonave të votimit ishte po ashtu i dukshëm në proporcion me

¹¹³ Mahi Nesimi Dhunimi i vullnetit zgjedhjet të parakohshme parlamentare 2008 ,Tetovë 2009 ,205

votim familjar, votimi familjar ishte njëra nga parregullsit e vërejtura në shkallë të gjërë nga vëzhguesit në ditën e zgjedhjeve, te votimi familjar u vërejt një dallim i dukshëm etnik, ku vëzhguesit e raportuan për votim familjar në 34% të vendvotimeve të vëzhguara në zonat e banuara kryesisht shqiptarë etnik dhe 12% të zonave të tjera. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan 30 raste në cilat kishte treguar parregullsi evident të mbushjes së kutive, të cilat, në përjashtim prej dyve, të gjitha ndodhën në zonat me shumicë shqiptare, sipas këtij raportit mbushja e kutive ka ndodhur edhe nga antarët e këshillit zgjedhor, në Likovë të Kumanovës, vëzhguesit e MNVZ-së arritën në vendvotim rrethë mesditës, drynjët e kutive ishin thyer dhe afërsisht 90% e votuesve gjoja se kishin votuar.¹¹⁴ Njoftimet identike në listat e votuesve u pranuan nga 3% e vendvotimeve të vëzhguara, këto zgjedhje u maifestuan me prezenc të madhe të personave të paaturizuar në vendvotime edhe atë 16% në zona shqiptare dhe 6% të zonave tjera, psh. në vendvotimet me komunën e Likovës, aktivistë të PDSH-së u panë duke ndërhyrë në proces dhe duke i udhëzuar anëtarët e KZ-së dhe votuesit. MNVZ-ja vëzhgoi numërimin në 111 vendvotime numërimi u vlersua si i keq, 12 raste nuk arriten të përputhen me rezultatet në komunën e Bogovinës përfaqësuesit i autorizuar i PDSH-së u pa duke i futur duart në listat e votimit dhe duke shqyer fletvotimet për t'u siguruar që numërimi të përputhen me numrin e paraparë, disa vendvotime u mbyllën herët, përpara se të arrihen vëzhguesit, në mënyrë që votimi mos të shihet. Në Svinare e epërme të Shkupit, rezultatet nuk shpallën në vendvotim ndërsa KZ-ja nuk u gjetë nga vëzhguesit e MNVZ-së, të cilët kishin ardhur për numrimin e votave, KZ-ja mbrrin në KKZ, me dy orë vonesë, me rezultate të cilat tregonin një dalje prej 93% të votuesve të gjitha në favor të PDSH. Të vetmet raporte mbi një aktivitet të qëllimëshëm të mashtrimit ishin nga KKZ-ja e Tetovës, vëzhguesit e MNVZ-së vërejtën se pesë vendvotime tregonin 90 deri në 100% dalje të votuesve në zgjedhje dhe se KZ-të dilnin me protokolle të panëshkruara dhe pranoheshin nga KKZ-ja. Pas shqyrtimi të gjitha ngjarjeve të dhunshme, rezultatet paraprake treguan se VMRO-DPMNE kishte fituar bindëshm, kryetari i partisë Nikolla Gruevski, bëri të ditur se partia e tij do të fillojë bisedimet për koalicionin vetëm pasi të ishin zhvilluar zgjedhjet demokratike në tërë vendin, ai poashtu siguroi se rivotimi do të mbahen në gjitha zonat e prekura nga incidentet e dhunshme.¹¹⁵ Në deklaratat e tyre post-zgjedhore, të dy partitë shqipëtare vazhdimisht akuzuan njëra tjetër se kishin vjedhur votat dhe se kishin përdorur dhunë me 5 qershor BDI-ja protestoi në mënyrë paqësore kundër dhunës në zgjedhje, PDSH-ja aplikoi retorikë të fuqishme ndërsa me deklaratën e saj paralajmëroi se “kasaphana politike” të cilën BDI-ja e “mbijetoj” gjatë 1 qershorit do të vazhdonte gjatë rivotimeve me 15 qershor dhe se BDI-ja do të mposhtej

¹¹⁴ Mahi Nesimi Dhunimi i vullnetit zgjedhjet e parkohëshme parlamentare 2008, Tetovë 2009; 226

¹¹⁵ Mahi Nesimi Dhunimi i vullnetit zgjedhjet e parkohëshme parlamentare 2008, Tetovë 2009; 229

bindëshëm. Si rezultat i parregullsive me kërkes dhe shqyrtimi të rezultateve të arritura KSHZ-ja anuloi 187 vendvotimeve përshkak të aktiviteteve të pahishme: protokolle të paskata ose të panënshkruara, listat e votuesve përmbajnë dëshmi për votim në vend të diku tjetër, apo numrim i fletvotimeve nuk është i barbartë me numrin e votuesve të cilët kishin votuar, u caktua data për rivotim.¹¹⁶ Një deklaratë për opinionin publik me 13 qershor kryeministri Gruevski tha se rivotimi me 15 qershor do të sigurohet me forca policore, nga njësit speciale të policisë, si dhe do të mbështetet edhe nga helikopterët. "Nëse dikush ende mendon se në mënyrë të njëte, të fiton vota, dua të theksoj se parregullsitë përsëri do të rivotohen në ato vendvotime, ata nuk do të arrijnë rezultatin e dëshirua. Rivotimi për zgjedhjet e parkohëshme parlamentar 15 qershor 2008, u mbajtë në gjithësej 187 vendvotime, për 161,874 votues, kryesisht në zonat me shumicë shqiptare në vend, sipas Ministrisë së punëve të brendshme gjysma e forcës policore prej 10,000 individëve ishte stacionuar për të siguruar një ambient pa dhunë, megjithatë në disa vendvotime policia nuk pengoi numrin e madh të aktivistëve të partive politike për t'u mbledhur rreth tyre dhe për të krijuar një atmosferë kërcnuese për votuesit dhe zyrtarët e zgjedhjeve. Votimi u vlersua si përgjithësisht i mirë 91% të rasteve, ky ishte rezultat pozitiv në krahasim me 20% të raporteve negative nga e njeta zonë më 1 qershor, sidoqoft 9% të vërejtjeve kanë qenë negativ tregon se ka pasur një sërë problemesh dhe parregullsisht gjatë procesit zgjedhor për shembull, materialet zgjedhore ishin vjedhur nga dy vendvotime në Tetovë, përpara se ato të hapen, gabimet procedurale që u vërejtën nënkuptojnë edhe mos kontrollimin, nga këshillat zgjedhor, të sprejit në gishtin e votuesit sapo të mbërrinin në vendvotim (17% të rasteve të vërejtura), si dhe mos spërkatja me sprej të votuesit pasi ta kenë marrë fletëvotimin, kishte votim familjarë ku në shumtën e rasteve burrat hynin në vendvotime me një grup grash dhe i udhëzonin ato gjatë tërë procesit të votimit, prezenca e personave të pautorizuar në vendvotime, kryesisht aktivistë partiakë ishte përsëri e konsiderueshme (23%).¹¹⁷ Gjatë fushatës u përdoren edhe reklama nëpër media, lajmrime politike dhe fjalime politike, kjo ofroi qytetarve burime të shumëllojshme për t'u njoftuar me programet e kandidatëve nga ana transmetuesve publik, megjithatë ishin në favor të partive politike qeveritare, fushata reklamuse ishte e hapur nga autoritetet pak kohë para fushatës zyrtare që i reklamonte sukseset e iniciativave si dhe programet e tyre që siguronin shërbime speciale për qytetarët gjatë periudhës së fushatës. Megjithatë mungesa e raportimit analitik e kufizoi rolin e mediave në informimin e votuesve për garën zgjedhore që u zhvillua, votuesit nuk arritën të kenë informacione të sakta mbi përqindjen e nevojshme për mbështetjen që ua dhanë partive politike gjatë këtyre garave zgjedhore të

¹¹⁶ Mahi Nesimi Dhunimi i vullnetit Zgjedhjet e parkoshme parlamentare 2008 Tetovë 2009 ;230

¹¹⁷ Mahi Nesim Dhumimi i vullnetit zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2008,Tetovë 2009;231;232

votimit dhe rivotimit. Votuesit nuk arritën të shprehën lirshëm vullnetin e tyre politik nga përpjekjet e organizuara për ta penguar procesin zgjedhor në orët e mëngjesit gjatë ditës të votimit, pamundësuan shumë qytetarve arrijën në qendrat e votimit, përfshirë edhe në zona rurale të shprehin lirshëm vullnetin e tyre, si rezultat i kësaj dhe pas shqyrtimit të hollësishme të ankesave nga ana e Komisionit Shtetror Zgjedhor (KSHZ), zgjedhjet me 15 qershor u përsëritën, kjo mundësi edhe pse ju dha votuesve pjesëmarrsit të prekur nga parregullsit serioze që ndodhën më 1 qershor që shprehen vullnetin e tyre politik në një ambient më të sigurt dhe përgjithsisht më të qetë me prezenc të forcave policore brenda përreth votimit, frika për të votuar mbetet e dukshme gjatë ditës së rivotimit kjo frikë u mbjell në kokën e votuesve nga parregullsia që mund të ndodhin përsëri në ditën e rivotimit, lira e qytetarit dhe e drejta e tij mund të bëhet viktim përsëri nga partitë politike që mund të ushtrohet përsëri dhunë për hakmarrje, nga numri i madh i incidentëve të dhunshme para dhe gjatë periudhës zyrtare të fushatës. Përgjegjësit mbi azhurnimin dhe mirëmbajtjen e listave të votuesve në këtë periudhë të zgjedhjeve e mbante Ministria e drejtësisë e cila bënte azhurnimin e informatave të siguruar nga Ministria e punëve të brendshme dy herë në vitë dhe të dhënave nga autoritet të tjera. Asnjëherë më parë nuk është bërë ndonjë kontroll i hollësishëm, si rezultat i migracionit dhe emigracionit të brendshëm, disa rajone të vendit kishin më shumë emra në lista sesa banorë që ngre çështjen e cilësisë së listave. Lista e votuesve përmbanin një numër votuesish prej 1779,116, rritja prej 2% nga 2006-ta kjo listë mbeti e pandryshuar. Gjatë ditës së votimit, votuesve potencial nuk u është lejuar të votojnë në 8% të vendvotimeve që janë vëzhguar nga MVZ-ja dhe OSBE/ODIHR-it sepse nuk kanë qenë në listën e votimeve, numëri i votuesve të refuzuar u rrit gjatë rivotimit në 14%.¹¹⁸ Grancia e fshehtësisë së votës është një kusht i rëndësishëm dhe i nevojshëm në çdo zgjedhje demokratike.¹¹⁹ Te votimi familjar u vërejt një dallim i dukshëm etnik për votim familjar në 34%, të vendvotimeve në zonat kryesisht nga shqiptarë etnik dhe 12% zona tjera, burri në një familje i drejton gratë gjatë votimit por kishte raste kur ai votonte në vend të tyre, kjo dukuri vazhdoi ta dobësojë të drejtën e gruas për të hedhur votën e saj të fshehtë, sipas të dhënave kjo gjë ndodhte në zonat rurale të thella, kishte raste edhe kur kryefamiljari dikton se si duhet të votojë gjithë se cili në familje. Pjesëmarrsit në zgjedhje e 1 qershorit arritën të shfaqin pakënaqësi për autoritetet përkatëse për shqyrtimin e rastit me vdekjen e një personi në Harçinë dhe të plagosurve tjerë aktet e tilla mbetën të pa shqyrtuara nga ana e autoriteteve përgjegjëse lokale dhe nacionale që kontribuan në krijimin e një kulture të mosëndëshkimit gjatë zgjedhjeve të 1 qershorit 2008, dhe pse Ministria e punëve të brendshme në fillim ngurroi t'i marrë

¹¹⁸ Mahi Nesimi Dhunimi i vullnetit zgjedhje e parkohshme parlamantare 2008 ,Tetovë 2009; 214;231

¹¹⁹ Arsim Bajrami Teoria dhe praktika parlamentare Shkup 2002;175

përgjegjshi individët të përfshirë në manipulimet e ditës së zgjedhjeve, u mundua ta kontrolloj situatën e sigurisë gjatë rivotimeve të 15 qershorit dhe siguroi një situatë përgjithsisht më të qetë.

Partitë politike në Maqedoni brenda këtyre viteve të pluralizmit nuk kanë qenë të ndjeshëm aq sa duhet për ndjenjat e trupit zgjedhor qytetarit-antarsis së gjërë për të drejtat dhe obligimet e tij si vlera demokratike, kana arritur të shfaqin nivelin e ulët të funksionit komunikues transmetime dhe shpjegim të zbehtë jo frytdhënës nga ana e tyre deri te qytetari, krijimin e iluzionit tek masa-votuesit se ato nuk kanë ndikim mbi procesin e vendimë marrjes gjithsesi, komunikimi dhe transparenca gjatë procesit të politikbërjes, si dhe informimi i ndërsjellët nuk shihet si prioritar nga ana partive politike elitave politike në R.M, elitat politike mbar energjinë e tyre "pasive" të informimit e qojnë drejt edukimit të mbrapshtë. Të gjitha partitë politike dhe liderët politik në R.M, proklamojnë mbi demokraci, edhe ate me gojen plotë por praktika e tyre dëshmon se shpesh ndodh e kundërt, përmbushja e interesave të ngusht të tyre në dëm të së mirës publike, krijimi i situates aritificiale të ndarje klasore, etnike, kulturore, mendimet dhe vlersimet e gabuar tendencioze, nënçmuese dhe apolitike, në dëm të etniteteve. Praktika pluralo politike e Republikës së Maqedonisë, ofron shembull mjaft ne këtë drejtim, mjafton të përmendim fushveprimin e partive politike te dy anve pales maqedonase dhe shqiptare që gati çdo fushat zgjedhore, hapsir të madhe i kushtojn krijimit të një klime të shprehur kundër shqiptare-kundër-maqedonase vetem që të fitohet bekimi i zgjedhësve maqedonas dhe shqipëtar. Partitë politike në Republikën e Maqedonisë përdorin strategji të tejkaluara gjatë fushatave elektorale dhe janë të prirura të shfrytëzojnë gjendjen momentale emocionale dhe nivelin e ulët të kulturës politike të qytetarëve me të drejtë vote. Gjatë fushveprimit zgjedhor partitë politike shpeshherë janë të paskrupullta dhe i zhvlersojnë normat e demokracis, ato zakonisht shfaqen(shiten)si përfaqshues dhe mbrojtës të interesave të gjërë shoqërore dhe kombëtare.¹²⁰ Hapësirën më të përshtatshme e gjejnë në kundërthëniet etnike-kombëtare, kulturore dhe konfesionale mirpo kjo gjë duhet të kuptohet si normale kur është në pyetje niveli i organizimit politik të partive politike në Republikën e Maqedonisë, përdorimi i propagandës së flliqur që zakonisht si mjet kryesor të veprimit e kan etiketimin e partive dhe kundërshtarve, nënçmimin, delevimin, fyerjet, dhe në të shumtën e rastve imponimin e kompleksit të frikës ndaj qytetarve dhe antarsisë së gjërë. Partitë politike brenda këtyre viteve në pluralizëm politik nuk janë të ndjeshëm aq sa duhet për ndjenjat e trupit zgjedhor, për të drejtat, dhe obligimet e tij si vlera të demokracisë, tregon dukshm se as sheti as partitë nuk po arrin tja siguron kushtet qytetarit të shprehë vullnetin politikë sipas bindjes së tij, nga ana tjetër partitë politike po

¹²⁰ Etem Aziri Partitë politike zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore Tetovë 2015;409

tentojn me çdo kusht të marrë votën qytetare, duke përdorur mjete të palejueshme, duke shkelur rënd dinjitetin e atyre në emer të të cilëve garojnë në skenën politike. Problemi qëndron ende te vështirësi i ndryshimit të mendësisë dhe filozofisë së të menduarit të elitave politike në Republikën e Maqedonisë, nëse duhet të zgjedhin apo të angazhohen për alternativat më të lodhshme që jep rezultate afatgjata dhe alternatives më të lehtë që jep rezultate të menjëhershme, partitë politike në Republikën e Maqedonisë po përcaktohen për të dytën “alternativa që jep rezultat të menjherëshme.” Partitë politike në vend që të “mësojnë trupin zgjedhor” të dalë në votim dhe të shfrytëzojë të drejtën e votës, kanë zgjedhur rrugën më të shkurtër dhe më të lehtë, duke frikësuar votuesit që ai të mendoj seriozisht nëse duhet të votojë ose jo, kjo dëshmon se partitë politike nuk investojn fuqishëm në ngritjen e nivelit të kulturës politike tek qytetari dhe antarsia e gjërë, që jep rezultate afatgjata.¹²¹ Partitë politike shqiptare “ ngritë vetëdije politike “qytetarin dhe antarsin e gjërë duke e bindur” me motive të sinqerta “se organizimi politiko partiak i shqiptarve është alternativ e veteme që qon drejtë homogjenitetit kombëtar dhe përparimit të çështjes shqiptare si në Maqedoni ashtu edhe më gjërë, pavarisht angazhimit të tyre me kalimin e kohës gjithçka u zbeh zgjedhësit/votuesit po e mësojnë alfabetin e partive politike funksionimin e partive politike me gjitha përparsist dhe mangësit që i mbërthejnë në vete, partitë politike ngritën vetëdije politike tek qytetari se sot më tepër partitë politike në Maqedoni luajnë rolin e enteve për punsim se fati dhe prespektiva e shumë qytetarve profesionalisht shumë të përgaditur varet nga vullneti i bosave lokal-lidërve partiak”,¹²² në shoqërin tonë konkursi për punsime bëhet plotësisht sipas rregullave, por zgjedhja nga ana e organeve shtetërore është sipas listave që japin partitë që janë në pushtet, të cilët në shumtën e rasteve edhe pse nuk posedojnë kurrfar vlerash morale dhe shoqërore, por me gjithatë janë të dashur për oligarkitë partiake për arsye tashmë të njohura.¹²³ Kultura e sotme politike në Republikën e Maqedonisë ka mungesë të elementit pjesëmarrës-një dukuri e forëmësuar nga vala e tretë e tranzicionit që përjeton qytetari dhe antarsia e gjërë e rajonit vërehet një nivel i ulët i pjesëmarrjes qytetare efektive dhe besimit politik. Ky veprim i partive politik tashmë është bërë imperativ i domosdoshëm, sepse të gjitha të dhënat flasin për pjesëmarrje shumë të vogël të shqiptarve në zgjedhje. Disa imazhe kryesore negative që vështirësojnë edhe më tepër përfaqsimin politik dhe që duket se motivojnë ngritjen e apatisë politike të vendeve të rajonit ballkanik në tranzicion përfëshirë edhe Republikën e Maqedonisë, janë imazhe që në fakt e karakterizojnë skenën partiake politike me:

¹²¹ Etem Aziri Partitë politike zgjedhjet dhe sitemet zgjedhore Tetovë 2015;414

¹²² Po aty; 233

¹²³ Shteti i së drejtës dhe reformat në administratën publike rasti Maqedoni përmbledhje kumtesash Tetovë 2008

- Nivel jo i kënaqshëm i kulturës politike
- Komunikim edukim, informimi i zbehur politik me qytetarët
- Papërgjegjsia politike
- Roli centralist në procesin vendim-marrjes
- Oligarkitë e lidërshipeve partiake, shqiptare, maqedonas

S'ka dyshim se kultura luan rol në edukimin e gjykimit politik, sepse ajo mëson qytetarët të gjykojnë, kultura politike në Republikën e Maqedonisë, ndonjëherë vihet edhe në pikëpyetje përshkak të papërgjegjësis dhe menxhimit të dobët me votën qytetare, kokfortësisë inatëve, dhe smirës së tejskajshme të liderëve politikë, që e bën të pamundur zhvillimin e konsensusit të interesave politike dhe që rezulton me **deficit të kulturës politike qytetare aq të nevojshme për demokraci**. Por këto nuk janë sfidat e vetëme, ekzistojnë edhe një sërë problemesh dhe sfidash tjera të lidhura edhe me problemet e skenës partiak që edukon qytetarin dhe antarsin e gjërë me mos besim për pjesëmarrje politike.¹²⁴

- Mungesës së ofertës së mirrëfilltë dhe përkatëse politike nga partitë politike në qeveri dhe opozitë, me premtime të njeta gati çdo fushat zgjedhore me, të njetat pika referuse për opinionin publik.
- Shenjat e banalizimit të marrjes me politik (duke propozuar dhe përfaqësuar opsione politike nëpërmjet përfaqësuesve jo të duhur dhe pa shkathtësi të theksuar për tu marrë me politik, duket që nga qendra politike të vendimëmarrjes dhe rekrutimit të përfaqësuesve politik tentohet që të venitet entuziazmi i bërthamës shoqërore me vlera të mirrfillta në shoqëri që potencialisht do të mund të aktivizohej politikisht).
- Partitë politike janë fokusuar në çështjet ditore nga historia e afërt dhe para zgjedhjeve bëjnë garë nga një segment më radikal elektoratit.
- Vërejtja e trupit votues-qytetarve tek partitë politike se karakterizohen me probleme të shumta, mungesa e lidërshit dhe vullnetit politik.
- Apatia e përgjithshme e votuesve dhe zhgënjimi mbi drejtuesit zgjedhor të mëparshëm dhe aktual, të bindur se vota e tyre sdo të sjellë ndryshim në gjendjen ekzistuese që e kanë vendosur shtetin në krizë të thellë politike, ekonomike, financiare, e sigurie të qytetarit.
- Mungesa e besimit të kandidatët nga shkaku i zhgënjimit të mosmbajtjes së premtimeve nga drejtuesi zgjedhor dhe pak ndryshime apo përmisim në jetën e tyre si rezultat i proceseve politik.

¹²⁴ Veton Latifi Politikologjia Tetovë 2008;350

3.Shpalosje e rezultateve të një hulumtimi kuantitativ me qytetarët e komunes së Likovës


Përshkrim i studimit të bërë nëpërmes anketës

Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë, që të hulumtohet dhe konstatohet roli informativ dhe edukativ i partive politike, shikuar nga këndëvështrimi i qytetarëve, gjatë këtij hulumtimi arrita të realizoj anket me 300 persona, përfshirë grup mosha të ndryshme. Zgjodha këtë metodë hulumtimi-pra anketën duke ju dhënë mundësi qytetarëve të kësaj komune (Likovës) të shprehin mendimet e tyre se si dhe sa kanë arritur të trajnohen, informohen –edukohen gjatë proceseve zgjedhore. Të anketuarit gjatë këtij hulumtimi ishin kryesisht qytetarë të komunës së Likovës, përfshirë fashatrat për rreth të kësaj komune, duke përfshirë grup mosha të ndryshme, struktura të ndryshme arsimore e të anketuarve dhe me status të ndryshëm të punës .

Në anket jam munduar që të paraqesë pyetje sa më të qarta dhe më të kapshme që qytetarët të përgjigjen më lehtë pyetjeve të parashtruara lidhur me trajnimet informative dhe edukative, edhe ate duke filluar me pyetje, A keni pasur të qartë se si duhet të votoni? Sa keni njohuri rreth sistemit zgjedhor dhe legjislacionit zgjedhor të R.Maqedonisë? Keni pasur rast të informoheni paraprakisht rreth procesit të votimit deri tani nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve? Nëse po, nga kush jeni të informuar rreth procesit të votimit? Akeni pasur rast të ndiqëni ndonjë trajnim rreth procesit të votimit? Nëse po, nga kush jeni trajnuar rreth procesit të votimit? Sa keni arritur të informoheni dhe edukoheni rreth procesit të votimit? Si e vlerësoni trajnimin e kryer (kuptohet nëse keni marrë pjesë)? Si e vlerësoni materialet e leksioneve mbi trajnimin e kryer? Aka mundur që ky trajnim t'u përgadisë dhe t'u udhëzojë procedurave të votimit? Saktësia e listatave të votimit në R.Maqedonisë ka qenë problem historik, prandaj ja vlente të përfshiheshte kjo pyetje në anket-pyetësor, se a kishte shqetësime nga personat e anketuar lidhur me përfshirjen e tyre në listen e votimit, edhe ate, A ishi të përfshirë në listën e votimit gjatë proceseve zgjedhore? A mendoni se dhe ju jeni pjesë e procesve politike? Si dhe A mendoni se do të ishte e dobishme që të ndiqët një model sistematik i informimit të përhershëm të votuesve?


Gjatë këtij hulumtimi arrita për secilën pyetje të lartëpërmendur të gjej nivel të konsiderueshëm të përgjigjeve sa partitë politik kryejn funksion informues dhe edukues me qytetarët e kësaj komune të cilat në vijim do ti paraqes në mënyrë detale .

Graf.3.1.Struktura gjinore e të anketuarve




Nga grafikoni 3.1.kuptojmë pjesëmarrjen e gjinive që kanë marrë pjesë në këtë anketim qëllimi apo tentimi ka qenë që të arrijë një numër përafësisht të barabartë të dy gjinive në mënyrë që të arrijë te rezultatet me cilsiore lidhur me atë se sa ata edukohen dhe informohen gjatë proceseve zgjedhore, pasi që nga kjo përqindje fillon burimi informativ i këtij hulumtimi,mbi rolin e partive politike në informimin dhe edukimin e votuesve. Nga ky hulumtim arrita të përfshijë këtë struktur gjinore edhe atë 58% e të anketuarve ishin të gjinisë mashkullore, përqindja tjetër ishte e gjinisë femërore edhe atë me 42%. Vlefshmëria e informimit dhe edukimit të tyre pritet të pasqyrohet nëpërmjet këtij hulumtimi ku në vijim do të paraqesim në mënyrë detale edhe moshat e të anketuarve, strukturën arsimore të tyre si dhe statusin e punës .

Graf.3.2.Struktura moshore e të anketuarve



Nga grafikoni 3.2 kemi të paraqitur strukturën moshore e të personave të anketuar të dy gjinive, gjinisë mashkullore dhe gjinisë femërore, reth 22% e pjesëmarrësve ishin të moshës 18-25 vjec, rreth 39% e të anketuarve i takonin moshës 25-40 vjec që përfshinte numërin më të madh të pjesëmarrjes në anketim, 27% përfshin grupmoshën 40-60 vjec si dhe reth 12% mbi moshën 60 vjec.


Graf.3.3.Struktuara arsimore e të anketuarve



Gjatë këtij hulumtimi përmes anketës, arrita të parqesë këtë strukturë arsimore e të anketuarve, me shkollë fillore, shkollë të mesme, fakultet dhe student, në grafikoni 3.3. kemi parqitur struktur arsimore e të anketuarve, edhe ate me shkollë fillore 27% persona të anketuar në këtë grup të anketuarve ishin të përfshirë edhe gra amvise, me shkollë të mesme 32%, me fakultete 18% në këtë grup të anketuarve


ishin të përfshirë një pjesë e personave me status pune edhe, në komunën e Likovës, në institucione edukative arsimore –shkolla fillore, dhe në shkollë të mesme, si dhe student 23%.

Graf.3.4 .Statusi i punës i të anketuarve




Grafikoni 3.4.paraqet strukture e statusit të punës të personave që kanë marrë pjesë në anketim ,me status pune ishin 31% në këtë grupe të anketuarve ishin të përfshirë të punësuar në komunë,shkolla, si dhe persona tjerë të cilët kishin siguruar një vend pune,i pa punë 46% në këtë grup të anketuarve ishin të përfshirë edhe persona të cilët kishin të mbaruar fakultete të ndryshme por ishin të papunë, dhe 23% e të anketuarve student,të cilët ishin në vite të ndryshme të studimeve.

Graf3.5 A keni pasur të qartë se si duhet të votoni?




Pyetjes së parë që ju nënshtuan të anketuarit, rreth informimit dhe edukimit zgjedhor, ishte se, A keni pasur të qartë se si duhet të votoni? Në grafikun 3.5 shohim qartë nivelin e përgjigjeve të anketuarve edhe atë me po, jo dhe aspak. Po 50% e të anketuarve kishin pasur të qartë se si duhet të votonin, 32% e të anketuarve janë përgjigjës me Jo, 17% e të anketuarve janë përgjigjur me Aspak.

Graf.3.6.Sa keni njohuri rreth sistemit zgjedhor dhe legjislacionit zgjedhor të R.Maqedonisë?




Struktura e parqitur me lartë tregon përgjigje të ndryshme të anketuarve në lidhje me pyetjen se, Sa keni njohuri rreth sistemit zgjedhor dhe legjislacionit zgjedhor në R.Maqedonisë? Shkëlqyeshëm 18% e të anketuarve kishin njohuri rreth sistemit zgjedhor dhe legjislacionit zgjedhor të R. Maqedonisë, Mirë 42% e të anketuarve kishin njohuri rreth legjislacionit zgjedhor të R.Maqedonisë, Mjaftueshëm 17% e personave të anketuar kishin njohuri rreth sistemit zgjedhor dhe legjislacionit zgjedhor të R.M si dhe 23% e të anketuarve nuk kishin aspak njohuri mbi sistemin zgjedhor dhe legjislacionin zgjedhor të R.M.

Graf.3.7.Keni pasur rast të informoheni paraprakisht rreth procesit të votimit deri tani nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve?




Në grafikonin 3.7 Kemi të paraqitur strukturën e përgjigjeve e të anketuarve gjatë këtij hulumtimi, në lidhje me pyetjen e lartpërmendur, keni pasur rast të informoheni parprakisht rreth procesit të votimit nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve? 28% e të anketuarve janë përgjigjur me Po që kanë pasur rast të informohen rreth procesit të votimit, 39% me Jo janë përgjigjur, që nuk kanë pasur rast të informohen rreth procesit të votimit nga KSHZ-ja, si dhe personat e anketuar që nuk kishin përgjigje rreth asaj se a keni pasur rast të informohen rreth procesit të votimit nga KSHZ-ja, Nuk kam përgjigje 33% e të anketuarve .

Graf.3.8 Nëse po nga kush jeni informuar rreth procesit të votimi?




Paraqitja grafike 3.8 tregon strukturën e përgjigjeve të personave të anketuar gjatë hulumtimit se nga kush kanë qenë të informuar gjatë procesit të votimit, nga media apo Komisioni Zgjedhor Komunal pjesa më e madhe e përgjigjeve ishte e mediave edhe atë 70% e të anketuarve janë përgjigjur se më tepër informohen nga media, kurse 30% nga Komisioni Zgjedhor Komunal që ishin të informuar rreth procesit të votimit.

Graf.3.9 Akeni pasur rast të ndiqëni ndonjë trajnim rreth procesit të votimit?




Struktura e paraqitur e këtij grafikoni më lartë 3.9 tregon përgjigjet e të anketuarve se a kanë pasur ndonjë trajnim rreth procesit të votimit? përgjigjët e personave të përfshirë në anketim ishin 20% me Po se kanë pasur rast të ndiqënin trajnim rreth procesit të votimit, 45% me Jo nuk kanë pasur rast të ndiqënin ndonjë trajnim rreth procesit të votimit dhe pjesa tjetër e të anketuarve nuk kanë pasur përgjigje rreth kësaj pyetje, Nuk kam përgjigje 35% e të anketuarve.

Graf.3.10.Nëse po,nga kush jeni trajnuar rreth procesit të votimit?




Struktura e parqitur e këtij grafikoni më lartë 3.10 tregon trajnimin e të anketuarve gjatë procesit zgjedhor-votimit, 21% e të anketuarve kishin përgjigje se kanë arritur të trajnohen nga Partitë politike, 32% e të anketuarve nga Komisioni Komunal Zgjedhor, dhe nga tjetër burim (p.sh. media) 47%.

Graf.3.11.Sa keni arritur të informoheni dhe edukoheni rreth procesit të votimit?




Në grafikun e parqitur 3.11 kemi strukturën e përgjigjeve të anketuarve në lidhje me pyetjen, Sa keni arritur të informoheni dhe edukoheni rreth procesit të votimit? Vërehet një nivel i ulët i informimit dhe edukimit zgjedhor në bazë të hulumtimit të opinionit publik të anketuarve, 18% kishin përgjigje se shkëlqyeshëm kanë qenë të informuar dhe edukuar, 24% mirë, mjaftueshëm 20%, pjesa më e madhe e të anketuarve u përgjigjen aspak edhe atë me 38%.

Graf.3.12.Si e vlersoni trajnimin e kryer (kuptohet nëse keni marrë pjesë)?




Grafikoni 3.12 paraqet strukturon e përgjigjeve e të anketarve,se si i vlersojn trajnimin e kryer, (nese kanë marrë pjesë në trajnim)? Niveli i qëndrueshëm i të kuptarit të grafikut 3.12, tregon qartë se 15% shkëlqyeshëm e vlersojn trajnimin e kryer, mirë 29%,mjaftueshëm 14% e të anketuarve, aspak 19% pjesa më e madhe e të anketuarve nuk kishin përgjigje mbi trajnimin e kryer edhe ate 37%.

Graf.3.13. Si i vlersoni materialet e leksioneve mbi trajnimin e kryer?




Struktura e paraqiturë e grafikonit 3.13 tregon përgjigjet e të anketuarve se si i vlersojnë materialet e leksioneve mbi trajnimet e kryera, shkëlqyeshëm 13%, mirë 27%, mjaftueshëm 12%, aspak 17% si dhe 31% nuk kanë përgjigje.

Graf.3.14. A ka mundur që ky trajnim t’u përgadisë dhe t’u udhëzojë procedurave të votimit?




Struktura e grafikonit të paraqitur më lart 3.14 tregon strukturën e përgjigjeve të anketuarve gjatë këtij hulumtimi se sa ka mundur ky trajnim të përgadisë dhe të udhëzojë të këta persona. Të anketuarit gjatë procedurave të votimit, përgjigjet e të anketuarve ishin, tërsisht po 14% e të anketuarve, deri diku 25% e të anketuarve, as po as jo 17% e të anketuarve, aspak 20% e të anketuarve si dhe pa përgjigje 24% e anketuarëve.

Graf.3.14.A ishi të përfshirë në listën e votimit gjatë proceseve zgjedhore?




Saktësia e listave të votimit ka qenë historikisht problem në R.Maqedonisë, grafikoni 3.15 paraqet strukturën e përgjigjeve e të anketuarve lidhur me pyetjen se ai ishi të përfshirë në listën e votimit, 50% e të anketuarve kishin përgjigje Po, por kishte shqetsime lidhur me përfshirjen e tyre në listën e votimit 32% e të anketuarve Jo nuk ishin të përfshirë në listën e votimit, si dhe 18% Nuk kam përgjigje.

Graf.3.16.A mendon se dhe ju jeni pjesë e proceseve politike



Në strukturën grafikonit 3.16. kemi paraqitur niveli e konsiderueshëm të përgjigjeve në bazë të anketaurve që lidhet edhe edhe me nivelin e kultures politike të votuesve, a mendoni se dhe ju jeni pjesë e proceseve politike ? 20% Po, 14% Jo, As po as jo 26% , Aspak 12% dhe 28% nuk kam përgjigje.

Graf.3.17.A mendoni se do të ishte e dobishme që të ndiqet një model sistematik i informimit të përhershëm?



Grafikoni më lartë parqet strukturën e përgjigjeve e të anketuarve në lidhje me pyetjen, A mendoni se do të ishte e dobishme që të ndiqet një model sistematik i informimit të përhershëm? grafikoni 3.17 paraqet se 54% e të anketuarve ishin që të ndiqet një model sistematik i informimit Po, 12% e të anketuarve Jo të cilët mendoni se media ishte mjet i përhershëm informues i mjaftueshme, si dhe nuk kam përgjigje 34%.

Përfundime

Nga shqyrtimi empirik i këtij hulumtimi rezultoi një nivel i konsiderueshëm i të kuptarit, të rolit të partive politike në informimin dhe edukimin e votuesve, këtë nivel të kuptuarit arritëm ta gjejm nga përgjigjet e personat që kishin marrë pjesë në anketim lidhur me informimin dhe edukimin e tyre nga ana e partive politike. Bazuar në përgjigjet e pjesëmarrësve në anketim për pyetjet dhe Çështjet e ngritura mund të nxjerrim disa konkluzione lidhur me informimin dhe edukimin e tyre gjatë proceseve zgjedhor, duke vërejtur edhe disa mangësi në informacion. Në pyetjen e përfshirë në anket, a keni pasur të qartë se si duhet të votoni, rezultuan përgjigje të ndryshme nga personat e anketuar, një pjesë e personave të përfshirë në anketim, kishin pasur të qartë se si duhet të votohet, e dinin se për kë do të votonin, gjithashtu ata theksuan se kishin arritur të informohen nga media, këtë e elaboroi më së miri numri i konsiderueshëm i përgjigjeve, nga kush jeni informuar rreth procedurave të votimit? si dhe Nga kush jeni trajnuar rreth procesit të votimit? por kishte persona të cilët nuk kanë pasur të qart se si duhet të votohet, në segmente të mëdha ishin të painformuar për axhendat zgjedhore dhe kandidatët, në këtë grup bënë pjesë personat me status arsimor të ulët, si dhe të grupmoshës mbi 60 vjet të dy gjinive. Kishte nivel jo të knaqshëm të përgjigjeve nga personat e përfshirë në hulumtim, mbi njohurit rreth sistemit zgjedhor dhe legjislacionit zgjedhor në R.M, gjithashtu nivel jo të kënaqshëm, lidhur me trajnimet, përfshirë materialet e leksioneve mbi trajnimet e kryera, se sa këto materiale kanë arritur ti përgadisnin apo ti udhëzojnë drejt procedurave të votimit. U vërejt nivel i ulët i kulturës politike, edhe ate nga pyetja A mendoni se dhe ju jeni pjesë e proceseve politike? këtë e dëshmoi dominimi i përgjigjeve me as po as jo, aspak, dhe nuk kam përgjigje. Kishte shqetsime nga një pjesë e personave të anketuar lidhur me përfshirjen e tyre në listat e votimit, edhe pse gëzonin të drejtën e votës, ishin të përjashtuar nga lista e votimit. Saktësia e listave të votimit ka qenë problem historik ende nuk ishte marrë një iniciativë e konsiderueshme për përmisuar listat e votimit ashtu edhe ndërgjegjshimin për të drejtë dhe përgjegjshin e qytetrëve me të drejtë vote për të verifikuar saktësinë e informacionit të së drejtës për të votuar. Mbi të gjitha si konkluzion mund të themi se pjesa më e madhe e personave me arsim fillorë dhe në moshë kanë qenë më pak të informuar dhe edukuar gjatë proceseve zgjedhore të dyve gjinive, ndërsa personat me arsim të mesëm, fakultet, si dhe student kishin informacione bazë mbi llojin, qëllimin dhe datën e zgjedhjeve, si dhe rreth procedurave të votimit, por edhe ata mendonin se do të ishte e dobishme që të ndiqet një model sistematik i informimit të përhershëm.

7. Bibliografia

- Etem Aziri. *Partitë politike, zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore*. UEJL, Tetovë, 2015
- Etem Aziri. *Sistemet politike*. Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2012
- Etem Aziri. *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë: Formimi, sfidat dhe perspektiva e zhvillimit demokratik*. Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë, 2012.
- Etem Aziri. *Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni*. Logos A, Shkup, 2004
- Etem Aziri. *Partitë politike dhe demokracia*. Logos A, Shkup, 2004
- Etem Aziri. *Sociologjia e partive politike*. SEE University, Tetovë, 2004
- Ante Fiamengo Bazat e sociologjisë së përgjithëshme Prishtinë 1984
- Fillet e Sociologjisë Prof.Dr.Ali Dida Prishtinë 1997
- Etem Aziri Sociologjia Tetovë 2007
- Andrew Heywood Politika Prishtinë 2008
- Radosh Smiljković; Stranke i politika Beograd 1976
- Vlladimir Goati Savremene političke partie Beograd 1984
- Radomir Llukij Političke stranke Beograd 1981
- Daniel Louis Seiler Partitë politike Tiranë 2000
- Mojsije Ostrogorski Demokratija i političke partie Beograd 1921
- Radomir Llukij Političke stranke Beograd 1981
- Ostrogorski, Mojsije: Demokratija i politicke partie, Beograd, 1921
- Zaganjori, Zhezairi Demokracia dhe shteti i së drejtës Tiranë 2002
- Hyrje në Psikologji politike Matha-Cottam Beth-Dieftz-Uhler- Elena M. Mastors-Thomas Prefston Tiranë 2009
- Hans –Helmuth KnÜtter “Demokratie” Informationen zur politischen Bildung, Neudruck 1992
- Politika dhe Politikat publike Jonuz Abdullahi Tetovë 2010
- Partitë politike në Shqipëri Afrim Krasniqi Tiranë 2006
- Partitë politike dhe sistemet politike Afrim Krasniqi Tiranë 2008

- Politics and Passion: Toward a more egalitarian liberalism Copyright 2005 by Michael Walzer (titulli origjinal) .Politika dhe Pasioni Michael Walzer drejt një liberalizimi egalitar përktheu Mertia Kociu (PINO), shtëpia botuese Dudaç Tiranë 2005
- POLITIK OG MAK, Kaval Mellbye TranØY (titulli origjinal, ky libër është dhuratë nga Qeveria Norvegjeze).Politika dhe Demokracia Kaval Mellbye TranØY, përktheu, Ermir Pulaha shtëpia botuese Tiranë Onufri 2006
- Konrad-Adenauer-Stiftung e.V., Snakt Augustin ,Handbuch fur Politisch Kommunikation Berlin 2010, Manual për komunikim politik, Një udhëzues nga Fondacioni Konard –Adenauer, përkthimi Fondacioni Civitas –Albania Tiranë 2010
- Platforma e BDI-Së 2017-2020 , Programi zgjedhor, zgjedhjet parlamentare 2016” Bashkë vendosim”
- Platforma e VMRO-DPMNE-së 2017-2020, Realno programa na VMRO-DPMNE 2017-2020 Rabota, sigurnost, napredok “Za tebe za Makedonija “
- Platforma e PDSH-së për periudhën 2016-2020, Ecim drejt (zgjedhjet parlamentare 2016)
- Platforma e SDSM-së 2017-2020, Social, Demokratski Sojuz na Makedonija Promena za podobar zhivot “Imam plan za zhivot vo Makedonija”
- Statutet e partive politike në R. Maqedonisë VMRO DPMNE, LSDM, PDSH, BDI
- Venco Popovski, Ivan Stefanoski, Marijana Sokolovska, Darko Aleksov dhe Rosana Alekoska me mbështetje të mirë të mr. Sllavica Biljarska, prof.dr. Mirjana Borota, prof.dr. Zoran Shapuriq dhe Pece Mirçeski Pjesëmarrja qytetare në proceset e krijimit të politikave dhe sjelljen e vendimeve në vetëqeverisjen lokale udhëzues për qytetarët shtypur në Shkup 2011
- Përthyrjet politike në tranzicion Ismail Arslani në Tetovë 2013
- Veton Latifi Lidërshipi politik Tetovë 2009
- Veton Latifi. Konceptete e demokracisë Instituti për Demokraci dhe Zhvillim Tetovë 2009
- Veton Latifi. Politikologjia, Instituti për Demokraci dhe Zhvillim- Shkup 2008
- Arsim Bajrami Teoria dhe Praktika Parlamentare, Flaka Redaksia e Botimeve Shkup 2002
- Mahi Nesimi Dhumimi i vullnetit Zgjedhjet parlamentare 2008 , Çabej Tetovë 2009
- Shteti i së Drejtës dhe Reformat në Administratën Publike rasti Maqedoni përmbledhje kumtesash shkencore Redaktorë : Etem Aziri, Jonuz Abdullahi, Ali Pajziti, Memet Memeti

- Sartori, Democratic Theory, Wayne State University Press Detroit; 1962
- The international IDEA Handbook of Electoral System Design (manual internacional IDEA për hartimin e sistemeve elktorale)
- Veton Latifi Përfaqsimi dhe pjesëmarja politike në Maqedoni- Instituti për Demokraci dhe Zhvillim 201012 G.Bingham Powell,Jr.Elections as Instruments of Democracy Majoritarian and Proportional Visions